

STUDIM KRAHASIMOR MBI SJELLJEN AGRESIVE TE
ADOLESHENTËT E GRUPMOSHËS 12-15 VJEÇ, NË ZONA
INDUSTRIALE DHE JOINDUSTRIALE NË QYTETIN E
ELBASANIT.

FLORA ZEQAJ (LAMÇJA)

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale, me profil Psikologji-Pedagogji, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. As. Dr. Voltisa Lama

Numri i fjalëve: 52.405

Tiranë, MARS 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj me përgjegjësi të plotë, se ky studim është realizuar nga ana ime dhe nuk është prezantuar asnjëherë, para një institucioni tjetër për vlerësim .Ky studim nuk është botuar i plotë , ose pjesë të veçanta të tij. Studimi nuk përmban materiale të shkruara nga person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Emri- Mbiemri: Flora ZEQAJ (LAMÇJA)

© Copyright, Flora Zeqaj (Lamcja)

Të gjitha të drejtat të rezervuara

2016

ABSTRAKTI

Studime të cilat analizojnë sjelljen agresive tek adoleshentët (Olweus, 2001; Skiba, 2000; Smith, 2003), kanë nisur të fokusohen që nga viti 1980. Këto sjellje përfshijnë agresion kundër pronës shkollore, kundër shokëve, bashkëmoshatarëve të tyre si dhe agresion ndaj mësuesve, prindërve (Astor, Pitner, Benbenishty, & Meyer, 2002; Herrero, Este'vez, dhe Musitu, 2006).

Ky studim ka si qëllim të eksplorojë, analizojë dhe krahasojë, nivelin e agresivitetit tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç, banues në zona industriale, përkundrejt atyre banues në zona joindustriale. Studimi u fokusua, në grumbullimin e analizimin e të dhënave, mbi faktorin social, mjedisin familjar dhe krahasimin e nivelit të sjelljeve agresive, tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona industriale, përkundrejt atyre banues në zona joindustriale. Në këtë studim u përfshinë 600 adoleshentë, nxënës të shkollave 9 vjeçare publike të grupmoshës 12-15 vjeç, ku 300 prej tyre janë banues në zonën e industriale dhe 300 te tjerë janë banues në zonën joindustriale të Elbasanit. Studimi u realizua në bazë të metodave sasiore. Të dhënat e këtij studimi dalin në konkluzion, se adoleshentët të cilët banojnë në zonën industriale, raportuan manifestim të sjelljeve agresive në një nivel më të lartë, në krahasim me adoleshentët të cilët banojnë në zonën joindustriale. Studimi arriti në përfundimin se dinamikat familjare, funksionimi i familjes si sistem, lidhjet e ngushta afektive mes anëtarëve në familje, bashkëveprimi ndërmjet tyre, përbëjnë faktorë të rëndësishëm në ndërtimin e sjelljeve, tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç. Nga studimi rezultoi gjithashtu, se gjinia mashkullore ishte më e predispozuar për të manifestuar sjellje agresive në krahasim me gjininë femërore. Ky studim provon në mënyrën e tij, se faktorët social e mjedisor, rrethanat në të cilat jetojmë, përbëjnë komponentë të rëndësishëm, në edukimin e sjelljeve njerëzore.

Fjalët kyçe: adoleshent, sjellje agresive, faktore social, eksosistem, ndotje industriale.

ABSTRACT

Studies which analyze aggressive behavior in adolescents (Olweus, 2001; Skiba, 2000; Smith, 2003), they have begun to focus since 1980. These behaviors include aggression against school property, against friends, their peers and aggression against teachers, parents (Astor, Pitner, Benbenishty, & Meyer, 2002; Herrero, Este'vez, and Musitu, 2006).

This study aims to explore, analyze and compare the level of aggressiveness in adolescents aged 12-15 years, living in industrial areas, as opposed to those residing in non-industrial areas. The study focused on gathering data analysis on social factors, family environment and comparing the level of aggressive behavior in adolescents aged 12-15 years, living in industrial areas, as opposed to those residing in non-industrial areas. In this study involved 600 adolescents, students from public schools to 9 years age group 12-15 years, where 300 of them are resident in the industrial area and 300 others domiciled in non-industrial area of Elbasan.

The study was conducted based on quantitative methods. The data from this study come to the conclusion that adolescents who reside in the industrial area, reported manifestation of aggressive behavior at a higher level, compared to teens who reside in the area joindustriale. Studimi concluded that family dynamics, family functioning as a system, strong affective ties between family members, the interaction between them, are important factors in building the behavior of adolescents aged 12-15 years. The study also showed that male gender was more likely to manifest aggressive behavior compared with the feminine.

This study proves in his way, that social and environmental factors, the circumstances in which we live, constitute an important component in the education of human behavior.

Keywords: adolescent, aggressive behavior, social factors, eksosistem, industrial pollution.

DEDIKIMI

*Këtë punim, ia dedikoj familjes sime,
bashkëshortit dhe dy djemve të mi.*

FALENDERIME

Studimet doktorale një sfidë sa e bukur, aq dhe e vështirë. Sfidë e cila kërkon punë , vullnet e këmbëngulje për të realizuar studime shkencore në plotësimin e detyrimeve doktorale.

Në këtë rrugëtim të gjatë, vlersësoj mbështetjen dhe kontributin e personave, të cilët i falenderoj që i kisha pranë, gjatë kryerjes së këtij kërkim shkencor.

Dëshiroj të shpreh falenderimet e mia të përzemërta, për udhëheqësen shkencore të këtij punimi Prof . Dr .Voltisa Lama . Falenderoj nga zemra të gjithë adoleshentët pjesëmarrës, Drejtorinë Arsimore Elbasan, shërbimin psiko-social të shkollave të pëzgjedhura për studim dhe Agjensinë Kombëtare të Mjedisit , për kontributin e tyre në mbledhjen e të dhënave për punën kërkimore të realizuar.

Falenderim dhe mirënjohje pafund familjes sime, bashkëshortit dhe dy djemve të mi , të cilët më mbështetën dhe më dhanë forcë, për të realizuar këtë studim. Ju falenderoj nga zemra !

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Abstrakt

Dedikim

Falenderime

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Vështrim i përgjithshëm i problemit.....	19
1.2 Prezantimi i problemit.....	21
1.3 Qëllimi i studimit dhe objektivat	23
1.4 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat	24
1.5 Kufizimet e studimit.....	25
1.6 Çështjet etike.....	26
1.7 Përkufizimi i koncepteve kryesore	27
1.8 Organizmi i studimit	30

KAPITULLI II: SHQYRTIM LITERATURE

2.1 Adoleshenca

2.1.1 Korniza konceptuale e zhvillimit në adoleshencë	31
2.1.2 Disa detyra që priten të përmbushen në adoleshencë	35

2.2 Agresiviteti

2.2.1 Korniza konceptuale e agresivitetit	37
2.2.2 Faktorët e riskut për manifestimin e sjelljeve agresive	38
2.2.3 Teoritë e agresivitetit	40
2.2.4 Modeli socio-kognitiv.....	42

2.3 Korniza teorike e studimit

2.3.1 Nocioni i zhvillimit dhe modeli bioekologjik	43
--	----

2.3.2 Modeli bioekologjik i zhvillimit të adoleshentit	45
2.3.3 Ndikimi i familjes si faktor risku në sjelljen agresive të adoleshentët	47
2.3.4 Ndikimi ekologjik si faktor risku në sjelljen agresive të adoleshentët	53
2.3.5 Një vështrim i përgjithshëm i marrëdhënies mjedis – individ – shëndet.....	56
2.3.6 Ndikimi i kimikateve dhe metaleve në shëndet	62
2.4 Një vështrim i përgjithshëm mbi legjislacionin evropian dhe legjislacioni shqiptar për çështjet mjedisore	66

KAPITULLI III: METODOLOGJIA

3.1 Kampioni dhe kampionimi	69
3.2 Instrumentat matës të studimit	74
3.2.1 Hartimi i pyetësorëve dhe përmbajtja e tyre	74
3.2.2 Besueshmëria e instrumentit	79
3.3 Dizajni i hulumtimit	80
3.4 Procedura për mbledhjen e të dhënave sasiore të studimit	81
3.5 Metodat e analizës së të dhënave statistikore	84

KAPITULLI IV: REZULTATET

4.1 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit fizik të adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona industriale në Elbasan	86
4.1.1 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit verbal të adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona industriale në Elbasan	88
4.1.2 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e zemërimit të adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona industriale në Elbasan	90
4.1.3 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e inatit, armiqësisë të adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona industriale në Elbasan	92
4.2 Rezultatet statistikore totale mbi nivelin e agresivitetit tek adoleshentët banues në zona industriale	93
4.3 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit fizik të adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona jo industriale në Elbasan	96

4.3.1 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit verbal te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona jo industriale në Elbasan	98
4.3.2 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e zemërimit te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona jo industriale në Elbasan	100
4.3.3 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e inatit, armiqësisë te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona jo industriale në Elbasan	102
4.4 Rezultatet statistikore totale mbi nivelin e agresivitetit tek adoleshentët banues në zona jo industriale	104
4.5 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona industriale versus atyre në zona joindustriale (krahasimi ndërmjet dy grupeve)	106
4.5.1 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona industriale krahasuar me ata të zonave joindustriale (krahasimi ndërmjet dy grupeve I specifikuar ne gjini)	107
4.6 Rezultatet statistikore totale mbi marrëdhënien familjare në zonën industriale përkundrejt asaj joindustriale	113
4.7 Rezultatet statistikore totale mbi lidhjen agresion –marrëdhënien familjare në zonën industriale përkundrejt asaj joindustriale	114
4.8 Rezultatet statistikore totale mbi ndotjen industriale në zonat e përfshira në studim	115

KAPITULLI V: DISKUTIMI

5.1 Diskutim mbi ndikimin e faktorit mjedis familjar në manifestimin e sjelljeve agresive nga adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec	117
5.2 Diskutim mbi ndikimin e faktorit ndotje industriale në manifestimin e sjelljeve agresive nga adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec	118

KAPITULLI VI: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

6.1 Përfundimet e studimit	120
6.2 Rekomandime të studimit	132
6.2.1 Rekomandime për studime të mëtejshme	133

SHTOJCA

PYETËSOR NR.1	134
----------------------------	------------

Rezultatet përshkruese për secilin nga pohimet e pyetësorit i cili mat marrëdhënien mes anëtarëve - Family Environment cale : Short Version	136
--	------------

PYETËSOR NR.2.....	163
---------------------------	------------

Rezultatet përshkruese për secilin nga pohimet e pyetësorit të agresivitetit Buss Perry tek kampioni ynë	167
---	------------

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA	221
---	------------

LISTA E TABELAVE DHE E DIAGRAMEVE

Tabela 1 . Shpërndarja e gjinisë në frekuenca dhe përqindje për nxënësit që banojnë në zona industriale .

Tabela 2 . Shpërndarja e gjinisë në frekuenca dhe përqindjes për nxënësit që banojnë në zona joindustriale .

Tabela 3. Rezultatet statistikore totale për adoleshentët banues në zona industriale .

Tabela 4 . Rezultatet statistikore totale për adoleshentët banues në zona joindustriale .

Tab.5. Reliability Statistics Shkalla e mjedisit familjar (Family environment scale, Moos, R. H., & Moos, B. S).

Tab . 6 Reliability Statistics Pyetësi i Agresionit (Buss Perry Aggression Questionnaire) .

Tab . 7 Rezultatet statistikore totale mbi marrëdhënien familjare në zona industriale .

Tab .8 Rezultatet statistikore totale mbi marrëdhënien familjare në zona jo industriale .

Tab . 9 Marrëdhënia midis marrëdhënieve familjare dhe ndotje industriale në manifestimin e sjelljeve agresive te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues zona industriale kundrejt atyre banues në zona joindustriale .

Tab . 10 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mungesën e kontrollit ndaj impusivitetit .

Tab .11 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për goditjen e një personi pas provokimit .

Tab.12 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për kundërpërgjigjen me goditje .

Tab.13 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për agresivitetin në nivel mesatar .

Tab.14 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mbrojtjen e të drejtave edhe me dhunë .

Tab.15 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për zgjidhjen e konflikteve me agresivitet .

Tab.16 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mospasjen e një arsye të mirë për të goditur dikë .

Tab.17 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për kërcënimin e njerëzve .

Tab.18 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për thyerjen e objekteve nga mërzitja .

Tab.19 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mos rënien dakord me miqtë.

Tab.20 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për konfliktet si pasojë e mungesës së bashkëpunimit/mirëkuptimit .

Tab.21 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për fyerjen .

Tab.22 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për dhënien e ndihmës .

Tab.23 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për njohjen nga të tjerët si tip jo social .

Tab.24 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për zemërimin .

Tab.25 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për shfaqjen e acarimit nga frustrimi .

Tab.26 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndjesinë e tensionimit .

Tab.27 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për të qenit i/e përmbajtur si person .

Tab.28 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për gjaknxehtësinë ndërmjet dy grupeve të studimit, zonë industriale dhe zonë jo industriale .

Tab.29 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nevrikosjen pa një arsye të mirë .

Tab.30 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për problemet me kontrollin e durimit .

Tab.31 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për zhgënjimin nga jeta .

Tab.32 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për skepticizmin ndaj të tjerëve.

Tab.33 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndjenjat e mërzitjes, zemërimit .

Tab.34 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për pohimin e pyetesorit: Shokët flasin keq për mua .

Tab.35 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për dyshimet ndaj personave miqësorë .

Tab.36 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndjesinë se të tjerët më tallin pas shpine .

Tab.37 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mendimet rreth sjelles së mirë të njerëzve .

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për agresivitetin fizik në zona industriale .

Grafiku 1.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për agresivitetin fizik në zona industriale e specifikuar ne gjini.

Grafiku 2. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin Verbal në zona industriale .

Grafiku 2.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin Verbal në zona industriale I specifikuar ne gjini .

Grafiku 3. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Zemërimin në zona industriale .

Grafiku 3.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Zemërimin në zona industriale e specifikuar ne gjini .

Grafiku 4. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Inatin /Armiqësinë në zona industriale .

Grafiku 4.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Inatin /Armiqësinë në zona industriale e specifikuar ne gjini .

Grafiku 5. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nivelin e agresivitetit në zona industriale.

Grafiku 5.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nivelin e agresivitetit në zona industriale e specifikuar ne gjini.

Grafiku 6. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin fizik në zona joindustriale .

Grafiku 6.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin fizik në zona joindustriale e specifikuar ne gjini .

Grafiku 7. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin verbal në zona joindustriale .

Grafiku 7.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin verbal në zona joindustriale I specifikuar ne gjini.

Grafiku 8. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Zemërimin në zona jo industriale .

Grafiku 8.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Zemërimin në zona jo industriale I specifikuar ne gjini .

Grafiku 9. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Armiqësinë në zona jo industriale .

Grafiku 9.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Armiqësinë në zona jo industriale i specifikuar ne gjini .

Grafiku 10. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nivelin e agresivitetit në zonë jo industriale .

Grafiku 10.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nivelin e agresivitetit në bazë të gjinisë femra/meshkuj në zonë jo industriale .

Grafiku . 11 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nivelin e ndotjes industriale për zonat e përfshira në studim .

Grafiku . 12 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për konfliktet në familje .

Grafiku .13 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mungesë e ofendimit mes antarëve .

Grafiku . 14 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për diskutimet rreth festave në familje .

Grafiku .15 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për marrëdhëniet më të mira me njerëzit jashtë familjes sesa me pjestarët e familjes .

Grafiku . 16 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndëshkimin për shkeljen e rregullave në familje .

Graf . 17 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndëshkimin për shkeljen e rregullave në familje .

Graf . 18 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mungesën e organizmit në familje .

Graf . 19 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për marrëdhëniet të ngushta .

Graf . 20 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për varësinë e antarëve të familjes në cdo gjë që bëjnë .

Graf . 21 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për rregullat në familje .

Graf . 22 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mungesën e realizimit të aktiviteteve në familje .

Graf . 23 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për përshtatjen ndaj ndryshimeve në familje .

Graf . 24 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për distancimin përballë problemeve në familje .

Graf .25 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për njohjen me rolin dhe detyrat në familje .

Graf . 26 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për shmangien e përgjegjësiave .

Graf . 27 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për varësinë ndaj antarëve të familjes .

Graf . 28 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mungesën e mbështetjes në familje .

Graf . 29 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndjekjen e rregullave në familje .

Graf .30 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për zgjidhjen e problemeve në familje .

Graf . 31 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Ndjenjat e fajit .

Graf . 32 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për modifikimin e vendimeve në familje .

Graf . 33 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mosnjohjen e rolit dhe detyrave në familje .

Graf . 34 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për marrëdhënie të mira komunikimi në familje .

Graf .35 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për shprehjen e dashurisë ndaj antarve .

Graf . 36 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për diskutimin e problemeve me qetësi .

Graf . 37 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për marrjen e përgjigjeve të sinqerta në familje .

Graf . 39 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për të kuptuarit e njëri-tjetrit në familje .

Graf . 40 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mungesën e kontrollit ndaj impulsivitetit .

Graf . 41 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për goditjen e një personi pas provokimit .

Graf .42 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për kundërpërgjigje me goditje .

Graf . 43 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për agresivitet në nivel mesatar .

Grafiku . 44 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mbrojtjen e të dhënave dhe me dhunë .

Graf . 45 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për zgjidhjen e konflikteve me agresivitet .

Graf . 46 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mospasjen e një arsye të mirë për të goditur dikë .

Graf . 47 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për kërcënimin e njerëzve

Graf . 48 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për thyerjen e objekteve nga mërzitja .

Graf . 49 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mos rënien dakord me miqtë .

Graf . 50 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për konflikte si pasojë e mungesës së bashkëpunimit / mirëkuptimit .

Graf . 51 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për fyerjen .

Graf . 52 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për dhënien e ndihmës .

Graf . 53 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për njohjen nga të tjerët si tip jo social .

Graf . 54 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për zemërimin .

Graf . 55 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për shfaqjen e acarimit nga frustrimi .

Graf . 56 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndjesinë e tensionimit .

Graf . 57 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për pohimin që mat pyetesori : Person i/e përmbajtur .

Grafiku . 58 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për gjaknxehtësinë ndërmjet dy grupeve të studimit .

Graf . 59 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nevrikosjen pa një arsye të mirë .

Graf . 60 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për problemet me kontrollin e durimit .

Graf . 61 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndjenjat e xhelozisë .

Graf . 62 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për zhgënjimin nga jeta .

Graf . 63 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për skeptikë ndaj të tjerëve .

Graf . 64 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndjenjat e mërzitjes , zemërimit .

Graf . 65 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për shokët flasin keq për mua .

Graf . 66 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për dyshimet ndaj personave miqësorë .

Graf . 67 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për ndjesinë se të tjerët më tallin pas shpine .

Graf . 68 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për mendimet rreth sjelles së mirë të njerëzve .

Lista e figurave

Fig . 1 Modeli i studimit .

Fig . 2 Modeli i hulumtimit .

Fig . 3 Ndotja industriale në qarkun Elbasan në vitin 2014-2015 .

Fig . 4 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nivelin e ndotjes në zonat industriale versus atyre joindustriale në studim sipas AKM(Agjensia Kombëtare e Mjedisit) .

Fig . 5 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitet në nivel shumë të ulët e specifikuar ne zone industriale –joindustriale sipas gjinise mashkullore (krahasim niveli ndermjet dy zonave te studimit) .

Fig . 6 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitet në nivel të ulët e specifikuar ne zone industriale –joindustriale sipas gjinise mashkullore (krahasim niveli ndermjet dy zonave te studimit) .

Fig . 7 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitet në nivel mesatar e specifikuar ne zone industriale –joindustriale sipas gjinise mashkullore (krahasim niveli ndermjet dy zonave te studimit) .

Fig . 8 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitet në nivel të lartë e specifikuar ne zone industriale –joindustriale sipas gjinise mashkullore (krahasim niveli ndermjet dy zonave te studimit) .

Fig . 9 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitet në nivel shumë të ulët e specifikuar ne zone industriale –joindustriale sipas gjinise femerore (krahasim niveli ndermjet dy zonave te studimit) .

Fig . 10 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitet në nivel të ulët e specifikuar ne zone industriale –joindustriale sipas gjinise femerore (krahasim niveli ndermjet dy zonave te studimit) .

Fig . 11 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitet në nivel mesatar e specifikuar ne zone industriale –joindustriale sipas gjinise femerore (krahasim niveli ndermjet dy zonave te studimit) .

Fig . 12 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitet në nivel të lartë e specifikuar ne zone industriale –joindustriale sipas gjinise femerore (krahasim niveli ndermjet dy zonave te studimit) .

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Vështrim i përgjithshëm i problemit

Adoleshenca karakterizohet nga ndryshime të ndjeshme e të shpejta të gjendjes fizike dhe emocionale, mendime dhe ide të pasistemuara, ndjeshmëri e lartë, momente rebelimi dhe përpjekje të njëpasnjëshme eksperimentimi. Adoleshenca njihet edhe si “koha e turbullimit dhe stresit” (Stanley Hall, 1916). Ajo ndeshet me disa probleme ,që kanë lidhje me seksin, vetëdijen, kontradiktat prindërore, kodet morale ose konformizmin ndaj normave sociale. Në këtë periudhë, zhvillohet ndjenja e identitetit, proces ky që ndeshet me kontradiktat midis aftësive, mundësive dhe dëshirave fizike, mendore dhe psikologjike e kufizimeve për të mos i realizuar ato. Adoleshenca është në kuptimin e vërtetë të fjalës, një tranzicion prej varësisë te pavarësia.

Shumë studime mbështesin tezën, se nuk ka stabilitet të moderuar të agresionit në kohën e adoleshencës (Olweus, 1979) dhe se 4/10 e individëve , kryejnë sjellje agresive në mënyrë kronike nga fëmijëria në adoleshencë (Broidy et al., 2003). Fatkeqësisht në statistikat kriminale (INSTAT) të dekadës së fundit në Shqipëri, rezulton se treguesi i krimeve të kryera nga adoleshentët, është një zë që duhet marrë në konsideratë. Mjaft prej tyre, i gjen të regjistruar në evidencat e vjedhjeve, përdoruesve të drogave, prishjes së rendit, marrëdhënieve seksuale me dhunë, apo me të mitur dhe deri tek vrasja e vetëvrasja.

Studimet e hershme, tregojnë se sjellja agresive në adoleshencë e ka origjinën jo vetëm në familje ,por edhe jashtë mjedisit familjar.

Dy komponentë të rëndësishëm, që ndikojnë në manifestimin e sjelljes agresive tek adoleshentët, janë ndikimi i mjedisit familjar, shkollor dhe ndikimi i komponentit ekologjik me të gjithë përbërësit e tij. (Brame, Nagin, & Tremblay, 2001; Broidy et al., 2003;)

Studimet e fokusuara tek ndikimi i familjes, në manifestimin e sjelljes agresive nga adoleshenti, arrijnë në konkluzionet, se konfliktet e vazhdueshme në familje, një klimë jo e qetë në mjedisin familjar, ndëshkimi i vazhdueshëm fizik mbi fëmijën nga prindi, mungesa e komunikimit, bashkepunimit dhe bashkëveprimit në familje , nxisin fëmijën në të qenit agresive, ndaj të tjerëve. (Alink, Mesman, Zeijl, Stolk, Juffer, Bakermans-Kranenburg, & Ijzendoorn, 2009; Tanaka, Raishevich, & Scarpa, 2010; Weiss, Dodge, Bates, & Pettit, 1992).

Pikërisht për këtë arsye, vendet e zhvilluara, i kushtojnë rëndësi të veçantë edukimit të adoleshentëve. Ata kane nevojë, për një mjedis familjarë e shoqëror social e miqësor, me

qëllim që të krijojnë identitetin e tyre të plotë. Sipas një studimi të publikuar në revistën *Societies*, (Bronfenbrenner, U. (2004). *Making Human Beings Human: Bioecological Perspectives on Human Development*), nëse një adoleshent godet të tjerët dhe nuk shkon mirë me shokët e tij, përveç faktorëve social, si disiplina në familje duhen kërkuar edhe shkaqe objektive apo subjektive në territorin ku jetojnë . Studimi që ka vëzhguar 1293 familje nga nëntë vende (Kina, Kolumbia, Italia, Jordania, Kenia, Filipinet, Suedia, Tajlanda dhe SHBA) tregon se fëmijët shfaqin sjellje agresive, nëse jetojnë pranë zonave industriale.

Vendi ynë vazhdon të përballë me problematika sociale e për këtë arsye, ndoshta çështjet mjedisore nuk kanë patur vëmendjen e duhur. Aktualisht në Shqipëri ekzistojnë zona të ndotura mjedisore, për të cilat nuk janë ndërmarrë aksione konkrete për trajtimin e tyre (UNEP, 2000). MMPAU identifikoi listën e parë të zonave të nxehta mjedisore, sipas studimit të UNEP në vitet 2000-12. Këto studime treguan, se shumë nga këto impiante industriale, përbënin rrezik serioz për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin përreth tyre. Gjithashtu ato përbënin rrezik jo vetëm për mjedisin në Shqipëri por edhe për gjithë rajonin e Ballkanit. Studime të mëtejshme pasuan në vitin 2008 nga UNDP mbi identifikimin e zonave me problematika mjedisore dhe rehabilitimin e tyre. Ky studim identifikoi edhe 36 zona të tjera. Problemet mjedisore nuk janë krijuar vetëm në këto vite të fundit, por ato i atribuohen në pjesën më të madhe të kaluarës, kryesisht si pasojë e zhvillimit të industrisë së rëndë (industria e rëndë pothuaj ka qënë e lokalizuar në të gjithë territorin e vendit para viteve 1990). Ndërsa në ditët e sotme aktivitete të tilla si prodhimi i çimentos, apo prodhimi i gëlqeres, industria e naftës, prodhimi i ziftit apo i çelikut, djegia e gomave, hedhja e mbeturinave pa kriter dhe mospërpunimi i tyre, janë shkaktarët kryesorë të ndotjes së mjedisit. Problematika më të mëdha shfaqen në ato qytete ku kontaminimi i zonës vazhdon si rezultat i aktiviteteve ekonomike private, siç është rasti i kompleksit metalurgjik në Elbasan (UNDP, 2008). Si dëmtuesi kryesor i mjedisit, por edhe me një impakt negativ në shëndetin e banorëve të vendosur në këto zona, përbëjnë një kërcënim serioz. Degradimi mjedisor , është një problem aktual në rritje që nuk lidhet vetëm me të shkuarën ,por edhe me abuzimet dhe keqpërdorimin e burimeve, me mungesën e standardeve dhe mosfunksionimin e institucioneve në nivel lokal dhe qendror. Nga analizimi i elementëve mjedisor, nuk mund të përjashtojmë edhe ato që lidhen me zhvillimet demografike. I parë në këtë këndvështrim, urbanizimi është faktor që sjell ndikime në mjedis për problematikën e re të panjohur më parë dhe për ndikimin që solli në komunitetet, të cilat u prekën më shumë nga këto zhvillime. Ndryshimet rrënjësore, që nisën në Shqipëri në vitet '90-të, nxitën një dinamikë demografike,

krejtësisht të ndryshme nga periudhat paraardhëse dhe që lidhet me dukurinë e migrimit të jashtëm dhe të brendshëm (INSTAT, 2007).

1.2 Prezantimi i problemit

Mjedisi dhe njeriu ndërveprojnë në mënyrë intensive, duke shkaktuar efekte të ndërsjellta tek njëri-tjetri. Kjo gjë vihet re më shumë në ditët e sotme, falë zhvillimit industrial, teknologjik, infrastrukturor, urbanizimit masiv, etj. Aktualisht, shumica e vendeve po përballen me një sërë problematikash të reja sociale, e mbi të gjitha shëndetësore, të shkaktuara nga dëmtimi i mjedisit, pasojat e të cilave ulin cilësinë e jetës së individit. Kjo, pasi vetë veprimtaritë dhe aktivitetet, që njerëzit kryejnë për të siguruar jetesën e përditshme në mënyrë të pashmangshme, ndikojnë drejtpërdrejtë në shëndetin e tyre. Njeriu mund të shkaktojë ndotjen përmes prodhimit, apo përmes konsumit, kur përdor energji, lëndë djegëse, kur prodhon mbeturina, apo keqpërdor burimet e tjera natyrore. Aktivitetet ekonomike kanë gjithashtu, ndikime të konsiderueshme në mjedis. Ato përdorin energjinë për makineritë, lëndët djegëse për transport, apo lëndën e parë për prodhim. Në përfundim të ciklit prodhues krijojnë mbetjet, të cilat duhet të përpunohen. Kështu pra, aktiviteti human (individual apo ekonomik), përveç se rrit mirëqenien tonë, sjell efekte të dëmshme, që nuk mbeten vetëm tek mjedisi. Këto efekte reflektohen në probleme shëndetësore (deri në vdekje të parakohshme), në probleme sociale si dhe në vetë cilësinë e jetës së njerëzve.

Qeniet njerëzore janë krejtësisht të varura nga burimet natyrore për plotësimin e nevojave të tyre bazë, gjë e cila në mënyrë të paevitueshme do të çojë në kriza dhe kolaps shoqëror (Dobson, 1991; Martell, 1994). Ky ndikim mund të sjellë dëmtime në botën natyrore, por nga ana tjetër mbart kosto sociale të cilat duhet të përballohen nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë, duke ndikuar më tej aktivitetin e tyre (Huby, 1998). Ky cikël është përshkruar me termat e një marrëdhënieje “presion - gjendje - reagim”. Aktiviteti njerëzor ushtron presion mbi mjedisin dhe ndryshon gjendjen e tij, përse i përket cilësisë dhe rezervave natyrore. Shoqëria reagon ndaj këtyre ndryshimeve, përmes politikave mjedisore, ekonomike dhe sektoriale, si dhe përmes ndryshimit të sjelljes, duke ndikuar kështu mbi presionin që ushtrojnë aktivitetet njerëzore. Përmbushja e këtij cikli kërkon impenjim shumëfaktorial, e mbi të gjitha ka një kosto të caktuar (Department of the Environment, 1996). Megjithatë, mund të thuhet se ka një rritje të ndërgjegjësimit dhe rritje të interesit të publikut për këto ndryshime dhe ndikime, edhe pse ka ende për të bërë. Pikë së pari, kjo lidhet me mungesën e konsensusit rreth mënyrës më të mire, për mbrojtjen e mjedisit, duke na lejuar në vazhdimësi zhvillimin ekonomik dhe social në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare. Pasojat e degradimit

mjedisor, nuk bien gjithmonë mbi ato pjesë të shoqërisë, që janë përgjegjësit dhe shkaktarët kryesor. Shpesh, njerëzit që vuajnë më shumë nga problemet mjedisore ,janë të ndryshëm nga ata, të cilët marrin përfitimet e aktiviteteve përkatëse. Problemi i dytë lidhet me faktin, se veprime të izoluar të individëve, shoqërive apo vendeve, jo gjithmonë kanë efekt mbi dëmet e shkaktuara. Problemi i tretë lidhet me faktin, se strukturat sociale të shoqërisë dhe organizimet e saj, i vendosin disa individë në pozita, ku nuk mund të ndërmarrin veprime, që do të çonin në kufizime të dëmtimit të mjedisit, edhe pse do të donin të kontribuonin në këtë çështje (Huby, Owen, Cinderby, 2007). Faktorët primar që ndikojnë shëndetin, lidhen me aksesin ndaj ujit të pijshëm dhe të shëndetshëm, cilësinë e ajrit, sigurinë në punë dhe aksidentet. Mjedisi llogaritet se shkakton një të tretën e totalit të sëmundshmërisë, për moshat 0-19 vjeç. Pështja e sëmundshmërisë e shkaktuar nga faktorë të njohur mjedisor, varion sipas vendeve (WHO, 2010).

Manifestimi i sjelljeve agresive, vihet re më shumë te adoleshentët, pasi vetë zhvillimi psikologjik i tyre, e favorizon nxjerrjen në pah me lehtësi të veprimeve të tilla. Adoleshenti është në kërkim të realizimit të vetes dhe të dëshirës së tij më të madhe, dëshirës për të qenë i admiruar, për të qenë në sytë e të tjerëve si “ai”, të jetë mbi të tjerët, të ndjehet i fortë e mbizotërues. Këto që sapo u cituan, janë elementët e parë ,që favorizojnë e nxisin manifestimin e sjelljeve agresive te adoleshentët ,por jo vetëm, pasi ndikojnë dhe një sërë faktorësh të tjerë, nëse do ti referohemi modelit Bioekologjik të Bronfenbrenner dhe Morris, 1998. Ky model, bazohet dhe mbështet në tezën ,se zhvillimi njerëzor ndikohet nga faktorë social dhe ekologjik. Bronfenbrenner dhe Morris, faktorët social dhe familjar i kategorizuan në Mikrosistem, ndërsa faktorët ekologjik, si ndotja industriale dhe gjithë faktoret e tjere te sistemit ekologjik.

Duke u bazuar në studimet e kryera në bazë të modelit Bioekologjik të Bronfenbrenner dhe Morris, 1998 si dhe nga konstatimet e mia, përmes vëzhgimeve subjektive gjatë eksperiencës sime disa vjeçare, në shkollën publike 9 vjeçare në zonë industriale, të ndërmarrë realizimin e këtij studimi.

Ky studim do të ndalet në eksplorimin dhe analizimin e faktorëve social dhe natyror, dhe krahasimin e manifestimit të sjelljeve agresive, tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç, në zona industriale dhe joindustriale ne qytetin e Elbasanit. Gjatë studimit do të analizojme faktorët social, specifikisht mjedisin familjar, nivelin e agresivitetit te grupet e adoleshentëve të marrë në studim përkatësisht banues në zona industriale përkundrejt atyre banues në zona joindustriale.

Fig.1 Modeli i studimit (Bronfenbrenner dhe Morris, 1998)-shqyrtuar faqe 36-42 të punimit



Nëse analizojmë të kaluarën tonë, sipas arketipeve të Jungut, vemë re se mbartim arketipe të së shkuarës, arketipe të shoqërisë agresive, e cila shumë marrëdhënie njerëzore me të tjerët i ka vënë në bazë të frikës ,që buron nga agresiviteti dhe sundimi i tjetrit. Nuk janë vetëm këto predispozita ,që e shtyjnë adoleshentin të manifestojë sjellje agresive ,ka edhe komponente të tjerë, të cilët ndërthuren dhe formojnë në geshtalt sjelljen agresive.

1.3 Qëllimet dhe objektivat e studimit

- Të eksplorojë, analizojë dhe të krahasojë nivelin e agresivitetit, tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç, banues në zona industriale, përkundrejt atyre banues në zona joindustriale.
- Të evidentojë dhe të analizoje faktorin social, mjedisin familjar, në funksion të analizes rreth manifestimit të sjelljeve agresive, tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç, banues në zona industriale, përkundrejt atyre banues në zona joindustriale.

Për të përmbushur qëllimet e studimit do të ndiqen objektivat e mëposhtme:

- Të studiohet e të analizohet rreth faktorëve familjar (marrëdhënie familjare, komunikim emocional etj), tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç ,banues në zona industriale, krahasuar me ata te zonave joinindustriale.
- Të përcaktohet niveli i agresivitetit, tek adoleshentët banues në zona industriale ,krahasuar me adoleshentët e zonave joinindustriale.
- Të përcaktohet niveli i agresivitetit sipas gjinisë ,tek adoleshentët banues në zona industriale ,krahasuar me adoleshentët që banojnë në zona joinindustriale.

1.4 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Pyetje kërkimore I

- A ka dallim në nivelin e agresionit te adoleshentët e moshës 12-15 vjeç, që jetojnë në zona industriale, krahasuar me adoleshentët që banojnë në zona joinindustriale ?

Hipoteza I e studimit

- Adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona industriale, manifestojnë sjellje agresive në nivel më të lartë, përkundrejt adoleshentëve banues në zona joinindustriale.

Pyetja kërkimore II

- A ka dallim marrëdhënia familjare dhe funksioni i saj në zona industriale, përkundrejt asaj në zona joinindustriale?

Hipoteza II e studimit

- Marrëdhënia familjare dhe funksioni i saj në zonën industriale, nuk ka ndryshim të dukshëm nga marrëdhënia familjare në zonën joinindustriale.

1.5 Kufizimet e studimit

Para se të përgjithësojmë gjetjet e këtij studimi, duhen marrë në konsideratë kufizimet e tij të cilat janë:

-Studimi është përqëndruar vetëm në institucionet publike, shkollat 9- vjeçare në qytetin e Elbasanit, që frekuentojnë nxënës që janë banues në zona industriale dhe joindustriale të përcaktuara në studim, duke lënë jashtë fokusit të kërkimit, pjesën tjetër të nxënësve që frekuentojnë shkollat publike dhe jopublike 9 vjeçare dhe për këtë arsye, nuk mund të bëhen përgjithësime vetëm për kampionin e studiuar. Janë përfshirë nxënës të moshës 12-15 vjec. Studimi i kryer nuk ka përmasat për t'u përgjithësuar edhe në raste të tjera, kjo për shkak, sepse kampioni është i qëllimshëm.

- Përgjigjet e nxënësve mund të jenë ndikuar nga dëshira apo kërkesa e tyre, për të pasur një prezantim sa më të mirë të vetes dhe familjes së tyre, duke bërë kështu që të dhënat të mos jenë shumë të plota ,duke shfaqur në këtë mënyrë efektin Hawthorne (është termi teknik për tendencën ,që kanë njerëzit për të ndryshuar sjelljen e tyre, kur ata e dinë ata janë nën vëzhgim). Për të mënjeluar këtë, jam munduar të qartësoj disa herë qëllimin e studimit ,duke theksuar rëndësinë e origjinalitetit të pohimeve të nxënësve dhe ruajtjen e anonimatit të tyre.

- Në këtë studim u përdorën vetëm instrumente matës të natyrës vetë-raportuese e kjo përbën një tjetër kufizim, ku supozohet se subjektet që kanë bërë këtë vetë-raportim të jenë përgjigjur me sinqeritet.

-Një nga kufizimet e studimit ka patur të bëjë edhe me vështirësitë shumë të mëdha, për gjetjen e literaturës nga autorë shqiptar,por edhe të huaj të përshtatshme për këtë studim. Nga kërkimi i literaturës në gjuhën shqipe, është konstatuar se ka një mungesë në titujt që i përkasin ndikimit të komponentit ekologjik dhe atij social, në manifestimin e sjelljes agresive te adoleshentët. Ky studim mund të jetë i replikueshëm dhe i diskutueshëm në përballje me studime të tjera më të detajuara, më përfaqësuese dhe më autentike. Mungesa e studimeve në këtë drejtim, sjell pamundësinë e krahasimit dhe përballjes së gjetjeve për të bërë një analizë të evoluimit të fenomenit.

1.6 Çështjet etike

Konsideratat etike të cilat janë patur parasysh për këtë studim, nuk ndryshojnë nga konsideratat etike të studimeve të tjera, për të patur sigurinë që të gjitha standartet etike të realizoheshin në mënyrën e duhur. Gjatë gjithë procesit, janë ndërmarrë disa hapa. Fillimisht është kontaktuar me Drejtorinë Arsimore Rajonale Elbasan dhe i është shpjeguar qëllimi i realizimit të studimit në vija të përgjithshme, si dhe ruajtja e konfidencialitetit dhe anonimatit përsa i përket nxënësve, që do të ishin pjesëmarrës në të. U krijua një database me të gjithë nxënësit e grupmoshës 12-15 vjeç, që ishin banues në zonat industriale Bradashesh, Vidhas, Letan dhe Katund i Ri dhe në zonat jo-industriale Labinot Fushë, Labinot Mal, Sericë, Shpat dhe Xibrakë, që frekuentonin shkollat 9 vjeçare publike në qytetin e Elbasanit . Në këtë mënyrë u përzgjedh një kampion prej 600 personash të grupmoshës 12-15 vjeç. Gjithashtu për realizimin e këtij studimi, u kontaktua dhe me AKM –Agjensia Kombëtare e Mjedisit dhe i është shpjeguar qëllimi i realizimit të studimit, në vija të përgjithshme si dhe, se ky studim do të realizohej për qëllime akademike. Agjensia Kombëtare e Mjedisit na mundësoi statistikën dhe raportin vlerësues, të kryer në zonat industriale në Elbasan të vitit 2015, pasi raporti dhe vlerësimi për vitin 2016 ishte në proces. Për realizimin e studimit u respektuan çështjet etike të cilat lidhen me:

a) Lejen e informuar të subjektit

Subjektet (nxënësit e grupmoshës 12-15 vjeç, banues në zona industriale/joindustriale në Elbasan), fillimisht u informuan për studimin, dhe pasi pranuan pjesëmarrjen në parim, u informuan në mënyrë të detajuar në lidhje me qëllimin, kushtet dhe metodën e studimit që do të përdorej, si dhe ku konsistonte ndihma e tyre. Pjesëmarrësve që në fillim, i është bërë e qartë natyra vullnetare e pjesëmarrjes në studim dhe se mund të tërhiqeshin nga studimi, nëse nuk kishin dëshirë të merrnin pjesë në të, pa administruar ende instrumentat me ta. Nuk kishte asnjë rast që nuk pranoi të ishte pjesë e studimit.

b) Konfidencialiteti Personave që morën pjesë në studim, iu bë e ditur, se të dhënat e mbledhura prej tyre do të përdoreshin vetëm për qëllime studimi, dhe se do të respektohej parimi i anonimitetit dhe konfidencialitetit.

Shmangia e mashtrimit, deklarimi i të dhënave

Subjekteve të përfshirë në këtë studim, iu bë e ditur qëllimi i vërtetë i studimit, pa përdorur qëllime të dyfishta, si dhe u njohën me faktin se rezultatet që do të dilnin nga ky studim, do

të përdorëshin vetëm për qëllime studimore ,duke qenë të disponueshme pranë Universitetin Europian të Tiranës në departamentin e Pedagogji-Psikologjisë.

Respektimi i këtyre parimeve etike, u bë një nga çështjet më të rëndësishme të këtij studimi në sigurimin e gjetjeve.

1.7 Përkufizimi i koncepteve kryesore

Përkufizimi i koncepteve kryesore të përdorura në këtë studim, po përshkruhet si mëposhtë:

Adoleshenca - është një fazë e zhvillimit fizik dhe mendor të njeriut, zakonisht e renditur ndërmjet fazës së fëmijërisë dhe pjekurisë. Sipas fazave të Erik Erikson të zhvillimit njerëzor (Onyehalu, A. 1981), për shembull, një i rritur i ri ,është në përgjithësi një person në mes të moshës 20 dhe 22 vjec, ndërsa një adoleshent, është një person në mes të moshës 13 dhe 19 vjec. Studiuesit nuk kanë rënë dakord mbi një përkufizim të saktë të periudhës së adoleshencës.

Kuptimi i plotë i adoleshencës në shoqërinë e sotme, mundësohet nga njohuritë që rrjedhin nga fushat e psikologjisë, biologji, histori, sociologji,edukim, dhe antropologji. Brenda të gjithave nga këto perspektiva, është e sigurt të themi, se adoleshenca është parë si një tranzicion ndërmjet varësisë dhe pavarësisë.

Agresiviteti - si koncept është i vështirë për t'u përkufizuar. Ai përdoret dhe keqpërdoret gjerësisht (Scott 1975). Për njeriun e thjeshtë, agresive mund të jetë sjellja e një tregtari që mbyll njëanshmërisht një marrëveshje ,ose sjellje e një vjedhësi banke, në veprim ose akti i luftës se një kombi. Njerëzit vazhdojnë të debatojnë, rreth agresiviteti. Psh: dikush mund të vrasë një insekt, një kafshë ose një person tjetër. Ne mund të t'i gërthasim dikujt, ose mund ta mbajnë inatin brenda. Më qellim që ta kuptojmë agresivitetin në kontekst të sjelljes njerëzore, psikologët japin përkufizime të ndryshme. Psikologu social Robert Baron (1983), e përkufizon agresivitetin si një sjelleje ,që synon të dëmtojë një anëtar tjetër të të njëjtit lloj. Ky përkufizim, përjashton agresivitetin midis llojeve (gjuetinë), agresivitetin e rastësishëm dhe agresivitetin njerëzor, që do të thotë, të studiosh atë sjellje, që synon dëmtimin e një njeriu tjetër. Sjellja agresive, mund të marrë forma të shumta. Ajo mund të jetë sjellje fizike, si sulmi me grushta ose me arme, sjellje verbale, e tillë si kërcënimet, ajo mund të jetë një veprim i tërthortë, si shkatërrim i pronës së armikut, ose dëmtimi i njerëzve të dashur për të.

Agresiviteti është sjellje, por ai shoqërohet me emocion (zemërim) dhe ndikohet nga emocionet. Roger Johnson (1972), vuri në dukje ,se agresiviteti është një koncept me shumë përmasa ,dhe ku ndikojnë shumë faktorë. Studiues të ndryshëm, i kanë studiuar marrëdhëniet

midis agresiviteti dhe faktorë të tilla si trashëgimia, seksi, territori, ekologjia, fiziologjia, zhvillimet, te mësuarit dhe organizmi social.

Familja-(lat. *familia*, nga *famulus* – rob shtëpie, shërbëtor) është njësi shoqërore më e vogël, e përbërë nga dy ose më shumë persona, të cilët kanë midis tyre lidhje martesore, gjaku ose birësimi; që jetojnë në të njëjtin mjedis, për një kohë relativisht të gjatë, kanë marrëdhënie kulturore dhe ekonomike të përbashkëta si dhe përkujdesen për njëri-tjetrin .

Sipas nenit 16:3 të Deklaratës të Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut "Familja është njësi bazë grupore e shoqërisë dhe i jepet mbrojtje nga shoqëria dhe shteti".Ekzistojnë shumë përkufizime për familjen, si nga sociologë ,ashtu edhe nga antropologë të vendeve të ndryshme. Sipas antropologut George Murdock, familja është "një grup social që karakterizohet nga mendimi praktik, bashkëpunimi ekonomik dhe riprodhimi. Ajo përfshin të rritur të cfarëdolloj seksi, (femër&mashkull,mashkull&mashkull,femër&femër etj) ku të dy duhet të mbajnë një lidhje të miratuar nga shoqëria dhe një ose më shumë fëmijë, të vetin ose të adoptuar (birësuar), nga të rriturit që bashkëjetojnë seksualisht.”.

Zyra e regjistrimit të përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara, familjen e ka përkufizuar si "dy apo më shumë persona të lidhur nga lindja, martesa, ose adoptimi të cilët jetojnë së bashku”.

Ndërsa përkufizimi i Merriam-Webster për familjen është: " Njësia themelore në shoqëri e cila tradicionalisht, përbëhet nga dy prindër ,që krijojnë fëmijët e tyre, gjithashtu përfshihen edhe njësi të tjera shoqërore, të ndryshme, që dallojnë, por janë të lidhura dhe të barabarta si familjet tradicionale (familje me vetëm njërin prind).”.

Neni 16:3 i Deklaratës së të Drejtave të Njeriut thotë: "Familja është grupi natyral dhe kryesor në shoqëri dhe ka të drejtë për mbrojtje nga shoqëria dhe shteti.”.

Familja në vetvete, përmban një grup të njerëzve shtëpiakë, zakonisht të bashkuar nga lindja ose martesa, ose nga marrëdhënie të ngjashme – duke përfshirë bashkëjetesën, adoptimin, mbiemrin dhe (në disa raste) pronësia (siç ka ekzistuar në Perandorinë Romake). Familja mund të quhet si bashkësi parësore njerëzore, ku individi, së pari takohet me kushtet e jetës shoqërore, të cilat i përcaktojnë atij kornizën, në të cilën ai mund të zhvillohet si person; kështu që mund të themi se; personaliteti njerëzor formohet në procesin e ndërveprimit shoqëror.

Në shumë shoqëri, familje quhet vetëm ajo e njohur nga ligji ,ose sisteme të ngjashme normative. Edhe pse shumë të tjerë ,duke përfshirë edhe sociologë, marrëdhëniet familjare i kanë konsideruar vetëm lidhjet e gjakut, shumë antropologë kanë kundërshtuar, duke thënë se

njeriu duhet ta kuptojë nocionin e lidhjes së “gjakut” metaforikisht dhe që shoqëritë e ndryshme ,duhet ta kuptojnë familjen nga koncepte të tjera dhe jo nga lidhjet gjenetike.

Ekologjia- (ojkos, vendbanim dhe logos, shkencë ose dije) është degë e Biologjisë e cila meret me studimin e vendbanimit. Themelet e para të ekologjisë i dha Hekeli, mirëpo themeluesi i ekologjisë moderne është Çarls Darvini(ang. Charles Darëin). Qeniet e gjalla, të cilat jetojnë kanë mardhënie shumë të ngushta dhe të përhershme me njëra-tjetrën. Ekologjia cilësohet edhe si shkencë, e cila meret me studimin e strukturës dhe funksionimin e biosferës. Mirëpo, detyra kryesore e kësaj shkence, është studimi i botës së gjallë dhe asaj jo të gjallë.

Eksosistemi është i gjithë kuadri komunitar, në të cilin jeton adoleshenti.Përvec te tjerave, përfshin ekspozimin ndaj lëndëve toksike, ndotjes në të gjitha format e saj. Megjithëse adoleshenti, nuk merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen e eksosistemit, këto vendime kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ,ose jo të drejtpërdrejtë në jetën e tij duke nxitur sjellje të caktuara si agresion fizik, verbal. Ngjarjet që ndodhin dhe vendimet që merren në një mjedis ,në të cilin individi bën pjesë, ndikojnë fuqimisht në zhvillimin e tij. Eksosistemi komprometon lidhjen dhe proceset e ndërmarra, midis dy ose më shumë mjediseve, ku të paktën njëri prej tyre, nuk përmban zhvillimin e personit, por në të cilin shkaktohen ngjarje, që ndikojnë në proceset dhe mjedisin aktual, ku jeton individi që po zhvillohet. Tre ndikimet më të fuqishme zhvillimore të eksosistemit janë: marrëdhënia e vendit të punës së njërit ose të të dy prindërve, rrethi miqësor i prindërve dhe ndikimi i fqinjëve dhe mjedisit natyror në funksionimin e familjes. (Bronfenbrenner, 1993). Eksosistemi mund të forcojë dhe të pasurojë cilësinë e mikro dhe mesosistemit, përmes vendimeve të cilat ndikojnë në atë, se çfarë një adoleshent mundet ose nuk mundet të bëjë. Vërtet adoleshenti nuk është pjesë e mjedisit ku punojnë prindërit, por vendimet që merren në këtë mjedis, ndikojnë në mënyrë indirekte në jetën e adoleshentit.

Ndotje industriale - është ajo formë ndotjeje, e cila vjen nga sektorët industrialë Bronfenbrenner, U (1979).

1.8 Organizmi i studimit

Ky studim është i organizuar në kapituj si më poshtë:

Në kapitullin e parë, të titulluar “Hyrja”, trajtohen prezantimi i problemit, qëllimi i studimit, pyetjet e studimit, rëndësia e studimit, përkufizimi i koncepteve kryesore, kufizimet e studimit dhe organizimi i studimit.

Në kapitullin e dytë shqyrtohet literatura e shfrytëzuar, duke sjellë një analizë të literaturës më të spikatur botërore dhe të autorëve vendas të kësaj fushe.

Në kapitullin e tretë, trajtohen metodologjia e përdorur në studim, kampioni dhe burimi i të dhënave, instrumentet e studimit nga ku përshkruhet, përmbajtja e pyetësorëve dhe analiza e të dhënave.

Në kapitullin e katërt, trajtohen rezultatet e studimit, mbështetur në pyetjet kërkimore të tij.

Në kapitullin e pestë, trajtohen diskutimi i rezultateve të studimit dhe gjetjet e studimit. Në kapitullin e gjashtë dhe të fundit ,jepen përfundimet dhe rekomandimet .

KAPITULLI II: SHQYRTIM LITERATURE

Në këtë kapitull, pasqyrohet një shqyrtim më i plotë i literaturës, në lidhje me problematikat që paraqet periudha e adoleshencës, konceptin e agresivitetit në adoleshencë, mbi teoritë e agresivitetit, faktorëve familjar dhe ekologjik, që ndikojnë në manifestimin e sjelljeve agresive tek adoleshentët, modeli bioekologjik i zhvillimit të adoleshentit etj.

2.1 Korniza konceptuale e zhvillimit në Adoleshencë

Në vitin (1904) ,Stanley Hall e karakterizoi adoleshencën si “koha e turbullimit dhe stresit”(Pettijohn,T. Psikologjia, fq.96). Edhe pse adoleshenca shoqërohet me disa probleme, Conger dhe Peterson (1984) vunë në dukje se ajo nuk është domosdoshmërisht një periudhë kaq stresante, sa ç’është në të shkuarën. Pothuajse gjithsecili në shoqërinë tonë, gjatë adoleshencës ndesh me disa probleme që kanë lidhje me seksin, vetëdijen, kontrollet prindërore, kodet morale ose konformizmin ndaj normave sociale. Adoleshentët duhet gjithashtu, të mendojnë rreth moshës së rritur, rreth asaj se kush janë ata, si dhe rreth nevojës për të marrë vendime në të ardhmen. Standartet sociale, luajnë një rol të madh në jetën e adoleshentit.

Adoleshenca është një periudhë zhvillimi, që gjendet midis fëmijërisë dhe moshës madhore, është një periudhë e ndryshimeve të mëdha ,në aspektin biologjik, psikologjik dhe social.

- Zhvillimi psiko-social dhe kognitiv në adoleshencë

Në adoleshencë zhvillohet sensi i një identiteti personal, i cili përfshin edhe njohjen e një sërë vlerash personale, morale dhe etike, si dhe perceptimin mbi vetveten, ose vetëvlerësimin. Zhvillimi psiko-social dhe njohës i adoleshencës, kuptohet më mirë kur ndahet në tre periudha ,të cilat përfshijnë respektivisht:

- adoleshencën e hershme (11-14 vjeç)
- adoleshencën e mesme (15-17 vjeç)
- adoleshencën e vonë (18-21 vjeç)

Secila prej këtyre periudhave të ndryshme të zhvillimit në adoleshencë, përmban ndryshime të reja në aftësitë njohëse emocionale dhe sociale të vetë adoleshentit në geshtalt .

Adoleshenca shënon, gjithashtu, ndryshime të jashtëzakonshme në aspektin njohës, duke përfshirë përdorimin e aftësive të reja abstrakte, logjike dhe mendimin idealist, sipas Piazhësë

(Piaget). Ai besonte, se ne kalojmë në katër faza të të kuptuarit të botës. Fazën e katërt, në mes të moshës 11 dhe 15, ai e quajti faza e operacioneve formale (The formal operational stage), e cila përbënte edhe fazën përfundimtare të modelit “Katër stadet e zhvillimit konjitiv”. Në këtë fazë, sipas tij, individët shkojnë përtej përvojave konkrete dhe mendojnë në terma abstrakt dhe më shumë logjik. Si pjesë e të menduarit në mënyrë abstrakte, adoleshentët zhvillojnë imazhet e rrethanave ideale, dhe fillojnë të presin mundësitë ,që do t’ju ofrojë e ardhmja. Këto ndryshime, nuk ndodhin në një vakum, theksonte Sullivan (1953), këto ndryshime ndodhin në një kontekst sociokulturor. Erikson (1968) propozoi një teori të rëndësishme në psikologjinë e zhvillimit të quajtur “Tetë stadet e jetëgjatësisë së Eriksonit” (Erikson’s Eight Life-Span Stages), sipas së cilës zhvillimi ndodh gjatë gjithë jetës. Në secilin prej tetë stadeve, individë përjeton një krizë dhe nëse e përballon atë me sukses, kalon në fazën tjetër. Nëse tek individë, në çdonjërin prej stadeve nuk zhvillohet kapaciteti i duhur, atëherë, më vonë ai do të ndeshë probleme të niveleve të ndryshme. Stadi i pestë i zhvillimit, i referohet adoleshencës (Identity versus Identity Confusion) Identiteti kundrejt Konfuzionit dhe zgjat prej afërsisht 11-18 vjeç.. Në këtë stad, adoleshentët kanë mundësi për të eksploruar role të reja, nivel përgjegjësie të rritur ,për të ndërtuar një sens të identitetit personal. Adoleshentët përjetojnë gjithashtu, një luftë dhe konfuzion rreth vetvetes, për të përcaktuar atë, që ata janë dhe përshtatjen e tyre me botën. Prindërit në këtë stad, duhet të lejojnë adoleshentët të eksplorojnë shumë role dhe shtigje të ndryshme, brenda një roli të veçantë. Nëse adoleshenti hulumton role të tilla ,në një mënyrë të shëndetshme dhe mbërrin në një rrugë pozitive, për të ndjekur në jetë, atëherë do të arrijë një identitet pozitiv. Nëse formimi i identitetit në adoleshencë,është shtyrë nga prindërit, adoleshentët nuk kanë mundësi të shqyrtojnë në mënyrë adekuate role të shumta, rruga për një të ardhme pozitive, nuk përcaktohet, dhe në jetën e tyre do të mbretëroj konfuzioni i identitetit. Marcia e përpunoi më tej teorinë e identitetit të Eriksonit, i cili e shikonte identitetin , si një proces dhe zhvilloi një qasje për të matur statusin e identitetit në adoleshencë në çdo moment (Marcia, 1966, 1976). Konceptet e eksplorimit dhe angazhimit, ishin çelësi për të identifikuar kohën, kur adoleshentët ishin në zhvillimin e identitetit të tyre. Sipas Marcia-s, eksplorimi ndodh, kur një adoleshent përfshihet në procesin e zgjedhjes dhe vendimmarrjes mbi çështjet e marrëdhënieve, stilit të jetës, fesë ose punës. Është një proces i kërkimit aktiv dhe zbulimit. Në të kundërt, angazhimi është pranimi i një qëllimi të caktuar, nënkupton një marrje përgjegjësie individuale, për zgjedhjen e jetës dhe veprimeve. Për Marçia-n, prezenca dhe/ose mungesa e dimensioneve thelbësore të eksplorimit dhe angazhimi, jep katër forma të dallueshme të identitetit apo statuse të identitetit: (1) Identitet i përjashtuar, që karakterizohet

nga prezenca e angazhimit dhe mungesa e eksplorimit. Edhe pse adoleshenti, është i kënaqur me sensin e tij/saj të identitetit, tërhiqet nga figurat autoritare, kështu që të rinjtë mund të priren të jenë të ngurtë dhe konformistë. (2) Përhapja e identitetit është një formë, ku përvojat e adoleshentëve, as nuk përbëjnë krizë dhe as angazhim, dhe nuk eksplorojnë në mënyrë aktive ndjenjat e veta. Sipas tij, të rinjtë të cilët janë në gjendjen e përhapjes së identitetit ,janë lehtësisht të ndikueshëm nga bashkëmoshatarët dhe mund të ndryshojnë shpesh opinionin dhe sjelljen, në përputhje me prirjet e grupit ose normat. (3) Në fazën e tretë, përvojat e adoleshentëve janë në krizë rreth identitetit, por nuk angazhohen në një sens të veçantë të vetes së tyre. Përfundimisht ankth dhe dyshim, eksplorojnë dhe provojnë role të reja, pa u zotuar ndaj tyre, eksperimentojnë, zbulojnë vlera dhe norma të reja. (4) Në fazën e arritjes së identitetit, të dyja, si kriza dhe angazhimi janë të pranishme. Adoleshentët përfundimisht angazhohen në një sens të veçantë të vetes, duke pranuar përgjegjësi, për një angazhim të tillë. Të rinjtë në këtë fazë të identitetit, arrijnë të kenë një imazh pozitiv të vetes, të jenë fleksibël dhe të pavarur. Studime empirike, sugjerojnë se; kërkimi i identitetit fillon gjatë adoleshencës, por një identitet koherent, nuk krijohet në mënyrë tipike ,deri në adoleshencën e vonë (Nurmi, Lerner, & Steinberg, 2004; Reis & Youniss, 2004; Waterman, 1999). Adoleshentët fillojnë të përfshihen në një të menduar më të avancuar, por disa aspekte të funksionimit njohës mbeten ende në zhvillim, veçanërisht ato që drejtohen nga korteksi para-frontal i trurit, që mbeten ende në zhvillim, deri në fillim të moshës 20 vjeçare, apo edhe më shumë (Sowell, Thompson, Holmes, Jernigan, & Togw 1999; Sowell, Thompson, Tessner&Toga, 2001).

Carol Gilligam (1983) ka studiuar diferencat gjinore në formimin e identitetit. Ajo hedh idenë ,se meshkujt e formojnë identitetin e tyre si individë të veçuar, ndërsa femrat ka më shumë të ngjarë ta formojnë identitetin e tyre, duke u bazuar më tepër në përgjegjësitë dhe marrëdhëniet sociale, sesa në marrëdhëniet individuale. Këto diferenca gjinore ,shpjegojnë dhe disa nga vështirësitë, që hasin meshkujt dhe femrat gjatë bashkëveprimit.Kur adoleshentët formojnë ndjenjën e identitetit, përfundimisht shumë të fitojnë më tepër pavarësi. Reagimi i prindërve ndaj kësaj pavarësie, përcakton shpesh klimën e marrëdhënieve brenda familjes. Prindërit dhe adoleshentët, duhet të mësojnë të përballojnë shqetësimet lidhur me komunikimin, kontrollin, pavarësinë, përgjegjësitë, autoritetin dhe stilet e bashkëveprimit (Knox, 1985). Disa konflikte brenda familjes, duket se janë të paevitueshme psh. Steinberg (1988) raportoi se periudha e pubertetit, shoqërohet me një autonomi të theksuar të

adoleshentit dhe me konflikte prind-adoleshent. Individët që kanë interesa dhe personalitete të ngjashme, ka të ngjarë të bëhen shokë. Hays (1985) shprehu mendimin ,se shoqëria e meshkujve mund të zhvillohet përmes aktiviteteve të përbashkëta, ndërsa e femrave përmes komunikimeve verbale.

Teoria e të mësuarit social, zhvilluar nga Albert Bandura (Bandura & Ross 1961), nëpërmjet hipotezës ,se të mësuarit merret nga njerëzit nëpërmjet vëzhgimit, imitimit dhe modelimit. Eksperimenti origjinal “Bobo Doll” (Bandura & Ross 1961) studioi modelet e sjelljes agresive ,në fëmijët e moshës parashkollore. Rezultatet e arritura, çuan në përfundimin ,se sjellja agresive mund të mësohet nëpërmjet vëzhgimit.

Katër karakteristika duhet të jenë të pranishëm në arritjen e rezultatit të të mësuarit:

- personi duhet të ndjek stimujt;
- duhet të ruaj informacionin të cilit i ka kushtuar vëmendje;
- të riprodhojë imazhin mendor;
- individi duhet të ketë motivimin dhe një arsye të mirë ,për të imituar ose të tregojë që ka mësuar (Bandura, & Ross, 1961).

Determinizmi reciprok, gjithashtu zhvilluar nga Bandura (1977), teorizoi se sjellja e një personi, është e kushtëzuar nga faktorë personal, që i referohen njohjes dhe mjedisit. Përveç kësaj, ai theksoi ,se televizioni ka vepruar si faktor për modelimin e sjelljes së dhunshme. Prandaj, është e mundur që sjelljet imorale seksuale në adoleshencë, mund të jenë nxitur nga përmbajtja e mediave. Teoria social-konjitive, kjo teori shpjegon sjelljen në aspektin e shkakut reciprok midis individëve, mjedisit të tyre dhe sjelljes (Bandura, 1986, 1989, 1999). Kjo teori, përdoret në psikologji, në arsim dhe komunikim, duke parashtruar faktin ,se pjesë të njohurive të fituara, mund të jenë të lidhura drejtpërdrejtë me vëzhgimin e të tjerëve, në kontekstin e ndërveprimeve sociale, përvojave, dhe jashtë ndikimeve të medias. Pra, njerëzit nuk mësojnë sjellje të reja vetëm duke i provuar nëpërmjet fitimit dhe dështimit, por më tepër që mbijetesa e njerëzimit varet nga replikimi i veprimeve të të tjerëve. Në varësi të faktit, nëse njerëzit shpërblehen ose ndëshkohen për sjelljen e tyre dhe rezultatit të sjelljes, sjellja mund të modelohet prej tyre. Media në këtë rast, mund të ofrojë modele për një grup të madh të njerëzve, të cilët jetojnë në mjedise të ndryshme.

2.1.1 Disa detyra që priten të përmbushen në adoleshencë

Adoleshentët në fazën e mesme (mosha 13-17-vjeçare), përballen me këto qëllime kryesore: formimin e identitetit personal, pavarësinë nga prindërit (Karaj, 2005:189) dhe krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme jashtë familjes, intimitetin dhe seksualitetin (Morris dhe Maisto, 2008), si dhe përparimin e tyre në shkollë (Roeser dhe Eccles, 1998).

Studimi ynë është fokusuar kryesisht në manifestimin e sjelljeve agresive të adoleshentëve në zona industriale, perkundrejt atyre në zona joindustriale, si pasojë e ndikimit të mungesës së ndërveprimit të tyre me anëtarët e familjes, funksionimit të familjes sistem i shëndetshëm dhe ndotjes industriale si faktor negativ në cilesinë e jetës. . Mirëpo, manifestimi i sjelljeve aggressive në adoleshencë, kryesisht në grupmoshën 12-15 vjeç, nxitet dhe nga realizimi me sukses apo jo i detyrave të mëposhtme që priten të përmbushen në adoleshencë:

Pavarësia nga prindërit - lidhet me nocionin e ndarjes dhe individualizimit, një koncept që është përpunuar nga studiuesit Blos (1967) dhe Mahler, Pine dhe Bergman, (1975). Në mënyrë të veçantë ,ndarja individuale së pari, lidhet me stadin e kalimit nga foshnjëria në fëmijërinë e hershme, dhe se dyti ajo shfaqet në adoleshencë/rini. Koncepti i ndarjes së dytë individuale, është vazhdimësi e teorive të Mahler, Pine dhe Bergman (1975) mbi ndarjen individuale të fëmijërisë së hershme, sipas një perspektive psikoanalitike të psikologjisë së zhvillimit të moshave të hershme. Gjatë fazës së parë të ndarjes individuale, fëmija fillon të kuptojë se ai/ajo është një individ më vete, nga nëna dhe babai dhe familja si e tërë, duke zhvilluar kështu konceptin mbi veten. Bazuar mbi këtë koncept, fëmija kalon përmes stadeve, në kërkim të pavarësisë. Pas përfundimit të periudhës së rivendosjes së marrëdhënieve me nënën, babain dhe anëtarët e tjerë të familjes, i riu/e reja gjen së fundmi kuptimin e autonomisë, që mbetet një ndër detyrat kryesore në adoleshencë (Mahler etj, 1975). Teoria e ndarjes individuale, e Mahler dhe kolegëve të tij (1975) në fëmijërinë e hershme, është e lidhur me atë të Blos (1967), i cili përshkruan fazën e dytë të ndarjes dhe individualizimit, që ndodh në adoleshencë. Gjatë kësaj faze të dytë, adoleshenti fillon të bëhet i pavarur nga prindërit dhe sistemi familjar, fillon të stabilizojë sensin e vetvetes, duke rivendosur marrëdhëniet në një bazë të re. Koncepti i ndarjes së dytë individuale, është i ngjashëm me atë të diferencimit të vetes (Bowen, 1978). Kur një individ negocion me sukses në stadin e dytë të individualizimit, rezultati është fitimi i pavarësisë (Blos, 1967). Kur individ dështon në këtë përpjekje dhe arrin të ketë vetëm një shkallë të ulët të ndarjes individuale, kjo është cilësuar si shenjë e mospërshtatjes dhe e mosfunksionimit dhe ndikon drejtëpërdrejtë në vetëvlerësimin e adoleshentit. Personat të cilët dëshmojnë nivel të ulët të ndarjes individuale,

janë konsideruar përgjithësisht si më pak të shëndetshëm nga ana psikologjike dhe funksionale, sesa bashkëmoshatarët e tyre që tregojnë nivel më të lartë të ndarjes individuale pra, të pavarësisë (Blos, 1967). Në fakt studiuesit kanë arritur të argumentojnë se disa rrezeqe, me të cilat përballen adoleshentët përgjatë rrugës së tyre drejt moshës së rritur, sillen rreth vështirësive të kalimit me sukses të procesit të ndarjes individuale për të fituar pavarësinë. Njëri prej problemeve, që përjetojnë adoleshentët është manifestimi i sjelljes agresive, ndërsa rritja e pavarësisë është vlerësuar si faktor mbrojtës në këtë kontekst (Barrera, Blumer, Soenksen, 2010). Kështu p.sh në një studim të realizuar nga Rice dhe kolegët e tij (1990), u hulumtuan marrëdhëniet midis kohezionit familjar dhe procesit të dytë të ndarjes dhe individualizimit (pavarësia), si faktor që parashikonte manifestimin e sjelljes aggressive në adoleshencë.

Përparimi në shkollë apo kompetenca shkollore, është një tjetër detyrim që pritët të përmbushet nga adoleshenti. Ai është përkufizuar jo vetëm si një burim sasior i matshëm, por edhe si një mundësi, dhe aftësi që disponon adoleshenti për t'ia dalë mbanë realizimit të detyrave të zhvillimit, dhe në të njëjtën kohë të përgatitet për një zhvillim pozitiv në të ardhmen. Përgjatë adoleshencës së hershme, i riu ballafaqohet me disa detyra të spikatura të moshës si: vazhdimi i zhvillimit të intelektit dhe i aftësive ndërpersonale në një mjedis të ri shkollor, stabilizimi i marrëdhënieve me seksin e njëjtë dhe të kundërt ndërkohë që bashkëmoshatarët bëhen për të shumë të rëndësishëm si dhe përdorimi i burimeve emocionale midis aspekteve të ndryshimeve të shumta të vetvetes. Mënyra se si adoleshenti i vlerëson këto detyra zhvillimore, rritin mundësinë për të patur efekte dhe pasoja afatshkurtra dhe afatgjata. Për shembull, adoleshenti i cili ndjek qëllimet sociale, në kurriz të shkollës, zhvillon "kompetencën" përmes aktiviteteve antisociale, ose përdor substanca si zgjidhje për të drejtuar emocionet e tij, mund të përjetojë rezultate të tilla si dështimi shkollor, braktisja shkollore, ose lëndime personale që janë të dukshme dhe që kanë pasoja për veten dhe shoqërinë (Roeser dhe Eccles, 1998). Gjatë adoleshencës praktika e takimeve me një person të seksit tjetër, ndihmon individët të zhvillojnë shprehitë e bashkëveprimit.

Kompetenca shkollore përfshin motivimin shkollor, arritjet akademike dhe sjelljen pozitive në bashkimin me shokët, tek të cilët adoleshenti gjen mbështetje sociale. Këto realizohen në mënyrë të tillë, që nuk e venë në rrezik sigurinë dhe shëndetin e adoleshentit, apo përfshirjen në aktivitete prosociale, duke ruajtur mundësinë e adoleshentit për vetëvlërsim të moderuar, pranimin e imazhit personal dhe duke zhvilluar mprehtësinë, për t'u përballur me shumë aspekte të ndryshimit të vetvetes dhe të mjedisit social (Roeser dhe Eccles, 1998). Shumë

adoleshentë kryejnë vetëvrasje, për arsye se ndjehen të depresuar dhe të padobishëm (Colt, 1983). Abuzimi me drogat është një problem i rrezikshëm në adoleshencë. Femrat adoleshente janë më të predispozuar për të qenë anoreksike. Kriminaliteti dhe krimet, janë rritur gjithashtu vitet e fundit nga adoleshentët. Mëgjithatë, sikurse përmendëm dhe mësipër, shumica e adoleshentëve janë në gjendje t'i përballojnë me sukses problemet e kësaj moshe dhe të rriten të shëndetshëm.

2.2 Agresiviteti

2.2.1 Korniza konceptuale e agresivitetit .

Agresiviteti si koncept, është i vështirë për t'u përkufizuar. Ai përdoret dhe keqpërdoret gjerësisht (Scott 1975). Për njeriun e thjeshtë, agresive mund të jetë sjellja e një tregtari që mbyll njëanshmërisht një marrëveshje ose sjellje e një vjedhësi banke, në veprim ose akti i luftës së një kombi. Njerëzit vazhdojnë të debatojnë rreth agresiviteti. Psh dikush mund të vrasë një insekt, një kafshë ose një person tjetër. Me qëllim që ta kuptojnë agresivitetin në kontekst të sjelljes njerëzore, ne do të përqendrohemi në disa përkufizime. Psikologu social Robert Baron (1983), e përkufizoi agresivitetin si një sjellje që synon të dëmtojë një anëtar tjetër të të njëjtit lloj. Ky përkufizim përjashton agresivitetin midis llojeve (gjuetinë), agresivitetin e rastësishëm dhe agresivitetin njerëzor, që do të thotë të studiosh atë sjellje, që synon dëmtimin e një njeriu tjetër. Sjellja agresive mund të marrë formë të shumta. Ajo mund të jetë sjellje fizike, si sulmi me grushta ose me arme, sjellje verbale, e tillë si kërcënimet, ajo mund të jetë një veprim i tërthortë, si shkatërrim i pronës së armikut ose dëmtimi i njerëzve të dashur.

Agresiviteti është sjellje, por ai shoqërohet me emocione (zemërim) dhe ndikohet nga emocionet. Roger Johnson (1972), vuri në dukje se agresiviteti është një koncept me shumë përmasa dhe ku ndikojnë shumë faktorë. Psikologët i kanë studiuar marrëdhëniet midis agresiviteti dhe faktorëve të tillë si; trashëgimia, seksi, territori, studimi, ekologjia, fiziologjia, zhvillimet, të mësuarit dhe organizmi social.

Agresiviteti është një formë më e drejtpërdrejtë e agresionit, si sjellje në vecanti e cila ka për qëllim të shkaktojë, ose rrezikojë tjetrin, duke e dëmtuar fizikisht apo psikologjikisht. (Archer dhe Coyne, 2005). Studimet tregojnë, se djemtë shfaqin probabilitet më të lartë për të shfaqur sjellje aggressive, në krahasim me vajzat. (Barth et al., 2004; Crick & Grotpeter, 1995).

Shumë studime mbështesin tezën, se nuk ka stabilitet të moderuar të agresionit në kohë (Olweus, 1979) dhe se 4/10 % e fëmijëve kryejnë sjellje agresive, në mënyrë kronike nga fëmijëria në adoleshencë (Broidy et al., 2003).

2.2.2 Faktorët e riskut për manifestimin e sjelljeve agresive

Studimet e bëra në këtë fushë ,tregojnë se sjellja agresive në moshat e reja, më saktësisht në fëmijëri dhe adoleshencë, i ka rrënjët në ndërveprimin e faktorëve të niveleve të ndryshme: individual, familja, social dhe mjedisor. Është kjo arsyeja ,që për të studiuar fenomenin e agresivitetit tek të rinjtë, duhet të mbështetemi dhe marrim në konsideratë të gjithë faktorët dhe në të gjitha nivelet që ato veprojnë. Agresiviteti i adoleshenteve është i lidhur me faktorë individualë dhe të jashtëm ,të cilët krijojnë mjedisin për shfaqjen e sjelljes agresive.

Faktorët nxitës të agresivitetit në moshat e reja, duket se janë më shumë me natyrë biologjike, të natyrës individuale dhe familjare. Trashëgimia ndikon mbi ndjeshmërinë e sistemit nervor, ndaj treguesve agresivë. Temperamenti i një individi qëndron dhe pasi vështrohet gjatë fëmijërisë së tij. Kështu, fëmijë me temperament të vështirë dhe impulsiv ,ka rrezik që të kryejë akte dhune gjatë adoleshencës. Me kalimin e viteve, ndikimi gjenetik mbi agresionin rritet, ndërsa ndikimi familjar pakësohet. Kimia e gjakut ndikon në ndjeshmërinë nervore të stimulimit të agresionit.

Kështu njerëzit e dhunshëm kanë prirje:

- të konsumojnë alkool
- të bëhen agresivë, kur marrin lëndë toksike.

Pra ka ndikime biokimike, nervore dhe gjenetike në agresion. Ndikimet biologjike i parashtrojnë disa njerëz ,që të reagojnë me agresion ndaj konfliktit dhe provokimit. Është shkencërisht e gabuar ,të thuhet se lufta ose sjelljet e tjera të dhunshme janë të programuara gjenetikisht, në natyrën tonë njerëzore. Tek adoleshentët, rolin nxitës e marrin faktorët socialë, të grupit ku ata bëjnë pjesë dhe për rrjedhojë shumë nga sjelljet aggressive janë të

fituara / të mësuar. Sidoqoftë, natyra dhe forca kauzale e faktorëve të riskut ,mbetet për t'u vërtetuar dhe asnjë faktor i vetëm, nuk mundet të shpjegojë agresivitetin tek të rinjtë. Në të kundërt, sa më i madh numri i faktorëve të riskut (p.sh. kujdesi i pakët prindëror i gërshtuar me rezultatet e dobëta në mësimet) ,ose sa më e gjërë fusha e veprimit të faktorëve (risku në familje apo në shkollë), aq më e madhe mundësia për t'u përfshirë në sjellje agresive në adoleshencë.

Në moshat e reja (periudha parashkollore dhe mosha e re shkollore) ,faktorët e riskut kanë natyrë individuale dhe familjare. Tregues të veçantë, siç janë agresiviteti ose niveli i lartë i impulsivitetit, ose të kërkuarit e vëmendjes, janë produkte të shumë influencave, që fillojnë nga geni deri tek mjedisi ku rritet fëmija. Adoleshentët me sjellje të dhunshme, shfaqin disa nga sjelljet e mëposhtme:

- kanë probleme të sjelljes që në moshën parashkollore;
- kanë sjellje agresive dhe problematike, si tendeca për të gënjyer dhe vjedhur;
- kanë sjellje hiperaktive dhe impulsive që në moshat e reja (Loeber, 1988).

Përveç sjelljeve të hershme anti-sociale, karakteristikat e familjes janë sinjalizues të rëndësishëm. Numri i faktorëve të riskut brenda familjes dhe koha gjatë të cilës fëmija ekspozohet ndaj këtyre faktorëve, është gjithashtu e rëndësishme. Disa nga karakteristikat e familjes, që mund të kontribuojnë në agresivitetin tek të miturit dhe tek adoleshentët janë si më poshtë:

- prindër me sjellje antisociale
- prindër me eksperiencë të abuzimit të substancave
- prindër me probleme të theksuara të shëndetit mendor
- praktika të varfëra prindërimi që karakterizohen nga mungesa e kujdesit të nevojshëm apo mungesa e përforsimeve pozitive në sjelljen e fëmijës
- ekzistenca e formave të dhunës fizike
- histori të dhunës në familje
- familje me përmasa të mëdha (me shumë anëtarë ku mungon vëmendje për anëtarët e rinj të familjes).

Shumë nga këta faktorë ,të lidhur me familjen, ndërveprojnë me faktorë të sistemeve të tjera, siç janë grupi i bashkëmoshatarëve dhe komuniteti. Pavarësisht këtij fakti, studimet më të

fundit, lidhur me agresivitetin në moshat e reja, theksojnë rolin dhe ndikimin shumë të fuqishëm të faktorëve të lidhur me familjen si: përmasat e saj, mungesa në prindërim dhe prindër antisocialë.

Fëmijët, që kanë prindër ndëshkues, kanë prirje për t'u sjellë agresivisht me të tjerët. Prindërit e tyre zakonisht i dispiplinojnë me britma, të goditura, ose rrahje duke e bërë agresionin, një mënyrë për t'u përballuar me gjërat. Edhe këta të rritur, kanë patur prindër ndëshkues. Megjithëse shumica e fëmijëve të abuzuar, nuk bëhen kriminelë ose prindër abuzivë, 30% abuzojnë më vonë me fëmijët e tyre. Brenda familjes, dhuna con në dhunë. Ndikimi familjar ,vihet re në kultura me shkallë të lartë kriminaliteti ku burri luan një rol minimal. Familjet me dy prindër, dallojnë jo vetëm në përkujdesje më të lartë dhe disiplinë pozitive nga baballarët, por edhe në varfëri më të ulët dhe arritje më të larta në arsimim. Lidhja mes mungesës së prindërve dhe dhunës varet nga raca, të ardhurat, edukimi dhe vendodhja.

Edhe mjedisi shoqëror jashtë shtëpisë, përbën një model. Në komunitetet ku admirohen modelet e trimave, agresioni u transmetohet brezave të ardhshëm. Subkulturat e dhunshme të bandave, krijojnë modele të dhunshme për pjestaret e tyre. Njerëzit ,mësojnë përgjigje agresive ,duke i përjetuar dhe duke i vëzhguar ato. Aktet e dhunshme motivohen nga disa eksperiencia të ashpra (si stresimi, dhembja, fyerja) ,që shfaqen emocionalisht. Agresioni shfaqet më tepër kur nxitemi dhe mendojmë,se është e sigurt të veprohet në mënyrë të tillë.

2.2.3 Teoritë e agresivitetit

Për agresivitetin janë bërë shumë studime, të cilët janë zhvilluar në katër këndvështrime: në këndvështrimin e teorisë së instikteve, të teorisë frustracion-impuls, teorisë së të mësuarit social dhe të teorisë cognitive neosocioniste.

1. Teoria e instikteve

Teorinë e instikteve, e njohim si teorinë më të vjetër për agresivitetin, e cila mbështet mendimin, që njerëzit janë nga natyra agresivë. Sigmund Frojd (1930) , i cili mund të mbahet si mbështetësi më i shquar i kësaj teorie ,argumenton se agresiviteti është rezultat i instiktit të vdekjes Thanatos, më të cilin lindin të gjitha qëniet njerëzore. Ndërsa studiesi Konrad Lorenz (Ylli Pango “Psikologjia Sociale” fq.180),që ishte edhe mbështetësi më i madh i kësaj teorie, e sheh agresionin më shumë si sjellje adaptive, sesa si sjellje vetshkatërruese.

Sipas Lorenz, njerëzit kanë një instikt luftarak, ndaj pjestarëve të së njëjtës specie, i cili në kohë më të hershme, siguronte mbrojtjen e ushqimit dhe zhdukte më të dobët të species.

Kjo teori, synon të zbulojë faktorët biologjik, që fshihen nën sjelljen sociale të çdo qenie të gjallë, që nga kafshët deri tek njeriu. Sipas teorisë së instikteve, kafshët kanë në shumicën e tyre një instikt luftarak ,që e përdorin për arsye esenciale; për shembull ato nëpërmjet agresionit ruajnë territorin ,duke siguruar furnizim të vazhdueshëm me ushqim,po në këtë mënyrë ato zhdukin kafshët e dobëta, duke lejuar të riprodhohen më të fortat dhe duke siguruar një përfitim evolucionar afatgjatë, për specien. Instikti i agresivitetit i kombinuar me zhvillimin e armëve, e ka bërë njeriun kafshën më të rrëzikshme të natyrës. Teoria e instiktit ka një vision mjaft pesimist për agresivitetin njerëzor.

2.Teoria e të mësuarit social.

Teoria e të mësuarit social (Terry F. Pettijohn “Psikologjia, një hyrje konçize” fq 558) thotë ,se agresiviteti është një formë e sjelljes së mësuar sociale,d.m.th. se sjellja aggressive është e fituar nga mjedisi, në të cilin jeton.Përfaqësuesit kryesor ,të kësaj teorie janë; Albert Bandura dhe Robert Baron, të cilët mendojnë që agresiviteti është i mësuar përmes vëzhgimit dhe imitimit të njerëzve të tjerë, përmes përforsimit pozitiv. Pra,një rrugë kryesore për të çuar në aggression ,është vëzhgimi i sjelljeve dhe imitimi i tyre. Bandura dhe koleget e tij, demonstuan në një eksperiment, konceptin e të mësuarit social të agresivitetit.Studiuuesit morën disa fëmijë për të parë një film,ku paraqitet një sulm i të rriturve mbi një kukull të madhe “Bobo”,e cila qëndronte me këmbë. Të rriturit kryenin me kukullen disa veprime të pazakonshme aggressive,pastaj kur iu lejua fëmijëve të luanin me kukullen,shumica e tyre imitonin sjelljet aggressive të të rriturve të filmit.Fëmijët mësuan të jenë agresivë nëpërmjet vëzhgimit të të tjerëve.

3. Teoria e frustracion-impuls.

Teoria e frustracion-impuls u propozua nga psikologët social Dollard,Doob,Miller,Mowrer dhe Sears (1939). Sipas kësaj teorie, frustracioni çon në zgjimin e një impulsi agresiv, për të goditur burimin e frustracionit.P.sh., në qoftë se dëshironi ,që të shkoni në një festë ,por prindërit nuk të lejojnë,frustracioni mund t’iu çojë në frustracion ndaj prindërve tuaj.Kjo teori hodhi idenë ,se agresiviteti ynë vjen si rezultat i frustracionit dhe mënyra për ta kontrulluar është ,që të qëndrojmë në një mjedis, ku mund të eliminojmë frustracionin.Atëherë, kur njeriu ka çdo gjë që i nevojitet dhe në momentin kur e do,bën të mundur zhdukjen frustracionit.

4. Teoria kognitive-neosacioniste.

Berkowitz (1984) ,propozoi teorinë kognitive-neoasosacioniste,e cila e trajton agresivitetin si një reagim ndaj ngjarjeve të pakëndëshme. Sipas kësaj teorie, kur njerëzit përjetojnë ngjarje të pakëndëshme, ato gjithashtu marrin një gjendje emocionale negative. Kjo gjë bën, që njerëzit t'i shmangin ngjarjet, që mund të sjellin veçse sjellje aggressive, kundrejt tyre. Në fakt kjo teori, është propozuar këto kohët e fundit,prandaj akoma nuk është vlerësuar dhe nuk është bërë shumë e njohur. Mëgjithatë kjo teori, bën disa parashikime për sjelljen, të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit. Një shifër alarmanet, përbën sasia e sjelljeve agresive në marrëdhëniet familjare. Starus dhe kolegët e tij (1980) vunë në dukje se rreth 75% e prindërve, përdorin mbi fëmijët disa forma të agresivitetit fizik. Shkaqet e dhunës në familje, kanë ndryshuar dhe përfshijnë dhe faktin, se tani njerëzit rriten në familje me shumë stres dhe frustracion. Meshkujt, janë më të prirur për të manifestuar sjellje agresive fizike ,ndërsa femrat agresivitet verbal (Eagly Steffen,1986).

Agresiviteti është një problem shumë serioz, për qeniet njerëzore. Ne duhet të shtojmë studimet, për shkaqët e agresivitetit dhe të punojmë për pakësimin e tij në shoqëri. J.P.Scott (1975) thekson rëndësinë e studimeve shkencore, në përpjekje për ta bërë botën, një vend më të sigurtë për të jetuar. Ai thotë se pasojat e mospakësimit të agresivitetit, janë shumë të dhimbshme.

2.2.4 Modeli socio-kognitiv

Studiues të ndryshëm kanë arritur në përfundimin, se problematika tek të rinjtë është shpesh herë e lidhur me mungesën e shprehive, për zgjidhjen e problemve sociale. Kur adoleshentët përballen me situata, për të cilat ata janë të papërgatitur nga ana emocionale dhe kognitive, ata reagojnë me agresion dhe dhunë. Shumë specialistë mbrojnë tezën, se mund të përmirësojnë aftësitë e fëmijëve, për të zgjidhur situatat sociale, në mënyrë jo të dhunshme duke nxitur marrëdhëniet e tyre sociale me bashkëmoshatarët, duke i mësuar të interpretojnë replikat/kundërpërgjigjet e sjelljeve dhe duke përmirësuar aftësitë e tyre, për zgjidhjen e konflikteve (Nadel dhe të tjerë, 1996). Ndërhyrja socio-kognitive, synon të pajisë fëmijët me shprehje që ju nevojiten atyre, për të përballuar në mënyrë të efektshme situata të vështira sociale, sic mund të jetë vënia në lojë/ tallja apo të qenit i fundit në radhën e lojtarëve të përzgjedhur për ekipin e futbollit. Modeli i vendos fëmijët në një pozitë, ku ata mund të mësojnë shprehje sociale, duke vëzhguar ose ndërvepruar me prindërit, mësuesit, shokët, miqtë dhe të afërmit si dhe persona të tjerë në komunitet, deri tek përfshirja e modeleve me role mediatike. Ndërhyrjet socio-kognitive, përfshijnë të mësuarit didaktik, modelimin, dhe të mësuarit e roleve me qëllim nxitjen e ndërveprimeve pozitive sociale, të mësuarit e metodave

joviolente për zgjidhje e konflikteve dhe ndërtimin ose fuqizimin e besimit joviolent tek te rinjtë.

Gjithashtu, modeli teorik i dhënies së mundësisë dhe fuqizimit të familjes, na ndihmon të kuptojmë se në bashkëpunimin familje-shkollë, në fund të fundit kemi subjekte të të njëjtës rëndësi. Të dy subjektet, kanë qëllim minimizimin e sjelljes aggressive të nxënësit dhe gjetjes së mënyrave, për t'a bërë këtë bashkëpunim dhe këtë marrëdhënie dy palëshe, të funksionojë (Deslandes, 2001, 2004).

2.3 Korniza teorike e studimit

2.3.1 Nocioni i zhvillimit dhe modeli bioekologjik

Baza e teorike e këtij studimi, fillon me modelin bioekologjik (Bronfenbrenner dhe Morris, 1998), i cili përfshin katër sisteme që ndërveprojnë dhe ndikojnë në zhvillimin e individit: mikrosistemi, mesosistemi, eksosistemi dhe makrosistemi. Ky model ,bën të qartë se zhvillimi i adoleshentit, është i lidhur me mikromjediset ku ai jeton, dhe kryesisht me mikromjedisin familjar dhe atë shkollor, pasi këto dy komponentë, luajnë një rol të rëndësishëm. Bazuar në këtë teori, e cila thekson ndikimin e madh që ka mbi adoleshentin ndërveprimi në mjedisin familjar, si dhe për ta studiuar më thellë ndikim e familjes në manifestimin e sjelljes agresive, u përdor korniza teorike e modelit Circumplex të familjes (Olson, Russell, dhe Sprenkle, 1989) e cila është cilësuar si korniza me e saktë për të studiuar funksionimin e familjes dhe për të kuptuar dinamikat brenda saj (Larnera, 2004). Po kështu, duke u bazuar po në teorinë e Bronfenbrenner (1979), në këtë studim parashtrohen tri këndvështrime teorike, të cilat lidhen me ndikimin e familjes me manifestimin e sjelljes aggressive tek adoleshentët (Epstein 1987, 1997, 2001; Hoover-Dempsey dhe Sandler, 1995, 1997, 2005; Bouchard, 1998; Dunst etj, 1992).

Sipas modelit Circumplex të familjes (Olson, Russell, dhe Sprenkle, 1989), funksionimi i familje është ndërlidhur me tri dimensione të jetës familjare; kohezionin, fleksibilitetin dhe komunikimin.

Koncepti i kohezionit, reflekton lidhjen emocionale ,që kanë pjesëtarët e familjes, e thënë ndryshe, afërsinë ose largësinë e tyre emocionale, kohën që kalojnë bashkërisht, mënyrat që ndjekin në marrjen e vendimeve, interesat, argëtimin e përbashkët. Vlerësimi i faktorëve të mësipërm,ndihmon në përcaktimin e nivelit të kohezionit të familjes.Familjet me nivel të ulët kohezioni, karakterizohen me konceptin “ndarje emocionale”, kurse familjet me nivel të lartë

kohezioni, kanë si cilësi bazë një “lidhje të fortë” (Olson,1993). Fleksibiliteti është aftësia t’u përshtatur, aftësia për ndryshim, që ka sistemi familjar në funksionin e roleve, marrëdhënieve, rregullave të vendosura, për ruajtjen e marrëdhënies në përgjigje të stresit. Është konstatuar se fleksibiliteti i tepërt, çon në një familje kaotike, ndërsa fleksibiliteti i ulët, çon në një marrëdhënie shumë të ngurtë (Olson,1993). Komunikimi familjar, matet duke konsideruar familjen si një grup, në lidhje me aftësinë për të dëgjuar, aftësinë për të biseduar, për të qenë të hapur, të qartë, për respektuar dhe treguar vëmendje ndaj njëri-tjetrit. Lidhur me këtë dimension të jetës familjare Olson (1993), bën më pak përcaktime në karakteristika, duke e konsideruar atë të mirë ose të varfër. Dimensionin i kohezionit dhe fleksibilitetit përcaktojnë tipin e familjes, ndërsa dimensionin i komunikimit konsiderohet si kritik (i rëndësishëm), për të lehtësuar dy dimensionet e para (Olson,1993). Në këtë studim, janë marrë në konsideratë dy nga dimensionet e funksionimit të familjes (kohezioni dhe fleksibiliteti), duke i lidhur këto dy dimensione me manifestimin e sjelljeve aggressive tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç ,në zona industriale kundrejt atyre joindustriale.

Teoria e mbivendosjes së sferave e Epstein (1996, 2001, 2005, 2011), është një mundësi për të krijuar një pamje më të qartë të faktorëve të ndryshëm ,që influencojnë sjelljen aggressive në adoleshencë. Epstein dhe kolegët e saj ,mendojnë se përfshirja prindërore mund të njehsohet me gjashtë lloje, të cilat në korrelacion me njëri-tjetrin ,përmirësojnë sjelljen e adoleshentit si dhe përfshirjen e prindërve në edukim. Ato janë:

Lloji 1 – Aftësitë dhe shprehjet e prindërve.

Lloji 2 – Komunikimi.

Lloji 3 – Vullnetarizmi.

Lloji 4 – Mësimi në shtëpi.

Lloji 5 – Marrja e vendimeve në shkollë.

Lloji 6 – Bashkëpunimi me agjencitë e bashkësisë (Epstein etj, 1997).

Mbështetur në teorinë e modelit bioekologjik të Brofenbrennerit (1976, 1986), por edhe në rezultatet e studimeve psikologjike dhe sociale, studiuesit Hoover-Dempsey dhe Sandler (1995,1997, 2005), prezantuan një teori, ku shpjegojnë në mënyrë të detajuar se çfarë i motivon prindërit për t’u përfshirë në edukim, duke reduktuar manifestimin e sjelljes aggressive nga adoleshentët dhe dinamikave familjare.

Gjithashtu, modeli teorik i dhënies së mundësisë dhe fuqizimit të familjes, na ndihmon të kuptojmë se në bashkëpunimin familje-shkollë, në fund të fundit kemi subjekte të të njëjtës rëndësi. Të dy subjektet kanë qëllim minimizimin e sjelljes aggressive të adoleshentit dhe gjetjes së mënyrave për t'a bërë këtë bashkëpunim dhe këtë marrëdhënie dy palëshe, të funksionojë si një sistem i shëndetshëm (Deslandes, 2001, 2004). Ky model është i bazuar në principet e krijimit të mundësisë, fuqizimit të mbrojtjes së marrëdhënies prind - adoleshent, për të ndarë plotësisht njohuritë, shprehitë dhe përvojat. Dunst, dhe kolegët e tij, përshkruajnë katër kategoritë që forcojnë dhe stabilizojnë këtë marrëdhënie:

1) Predispozicioni dhe qëndrimet emocionale të bazuara mbi besimin, përkushtimin, zemërgjerësinë, empatinë dhe të kuptuarit, si dhe gatishmërinë intelektuale bazuar në ndershmërinë, pasi periodha e adoleshencës përbëhet nga vakume emocionale dhe kërkon mbështetje prindërore.

2) Besimi, respekti i ndërsjellët, fleksibiliteti dhe ndarja e përgjegjësiave pasi si prindërit dhe adoleshentët kanë detyrat e tyre.

3) Komunikimi i hapur dy-drejtues, ku të dëgjuarit është po kaq i rëndësishëm sa dhe të folurit;

4) Veprime që manifestojnë qëndrime dhe besime. Studimet e dekadave të fundit, kanë treguar se sjelljet agresive janë të lidhura ngushtësisht me faktorët ekologjik (Ceballo, McLoyd dhe Toyokaëa 2004; Eamon, 2005; Eitle, 2005; Jeynes, 2001, 2005; Milne dhe Plourd, 2006), funksionimin e familjes, (Annuziata, Hogue, Faw dhe Liddle, 2006; Gonzales, Mohanraj, R., Latha, 2005; Unger, McLeod, Broën, dhe Tressell, 2000) dhe bashkëpunimin prind-adoleshent (Cancio, West, dhe Young, 2004; Eppler dhe Weir, 2009; Henderson dhe Mapp, 2002; Hill dhe Tyson, 2009; McWayne, Hampton, Fantuzzo, Cohen, dhe Sekino, 2004; Sheldon, 2003).

2.3.2 Modeli bioekologjik i zhvillimit të adoleshentit

Modeli i sistemeve bioekologjike (Bronfenbrenner dhe Morris, 1998), që përshkruhet më poshtë, përfshin katër sisteme që ndërveprojnë dhe ndikojnë në zhvillimin e adoleshentëve në rastin e studimit tonë ,por dhe të individit në të gjitha etapat e jetës së tij: mikrosistemi, mesosistemi, eksosistemi, dhe makrosistemi.

Sistemi i parë është mikrosistemi, që konsiston në mjedisin familjar, ku jeton fëmija. Sipas Bronfenbrenner (1993) "mikrosistemi është modeli i veprimtarive, roleve, dhe marrëdhënieve ndërpersonale të përvojës së individit që po zhvillohet, në dhënien e tipareve të duhura fizike,

e sociale të cilat ftojnë, lejojnë ose pengojnë mbështetjen për t'u ndjerë i lidhur, për veprim dhe ndërveprim, në mjedisin ku ndodhet" dhe përcakton funksionimin e familjes ,si sistem i shëndetshëm. Ilustrimet specifike, për mikromjedisin përfshijnë së pari, shtëpinë dhe familjen, ku një rol të rëndësishëm në zhvillimin e adoleshentit, luan dhe ndërveprimi me motrat dhe vëllezërit, përveç ndërveprimit me prindërit, dhe më pas shkollën, bashkëmoshatarët e seksit të njehtë dhe të kundërt etj. Për shumë adoleshentë, familja është mikrosistemi parësor, i ndjekur nga grupet e bashkëmoshatarëve në shkollë, grupe sportive, apo grupe të tjera sociale. Një adoleshent i caktuar, u përket një numri të ndryshëm mikrosistemesh ,që formon sunbsistemet në sistemin familjar. Një person mund të ketë ndërveprim me adoleshentin, në më shumë se një mikromjedis, në varësi të marrëdhënieve që krijon me mikromjediset e adoleshentit.

Mesosistemi është i kompozuar nga marrëdhëniet midis disa mikrosistemeve, që ndërveprojnë duke u mbivendosur mbi njëri-tjetrin, pra nga ndërveprimi i mjedisit të brendshëm familjar dhe mjedisit të jashtëm, siç mund të jenë mikromjedisi shkollor, apo shokët dhe anëtarët e mjediseve të tjera sociale. Më konkretisht, përfshin marrëdhëniet me familjarët në sinkrom me shokët, shoqet. Mesosistemi përmban lidhjet dhe proceset, të cilat shtrihen midis dy ose më shumë mikromjediseve dhe që ndikojnë në zhvillimin e individit p.sh lidhja e shtëpisë me shkollën, lidhja e shkollës me klubet sportive etj. Një vëmendje e veçantë i kushtohet energjisë së krijuar nga ndërveprimi i forcave nxitëse dhe frenuese, që bëjnë pjesë në këtë ndërveprim. Mesosistemi përfaqëson mjedisin, ku adoleshenti merr njëkohësisht disa role njëherësh, p.sh ;biri apo bija e dikujt, shoku i bandës muzikore apo skuadrës, punëtori me kohë të pjesshme apo vullnetari i veprimtarive humanitare. Këto role, të mbivendosura të mikrosistemeve ndërtojnë edhe mesositemin dhe ndërveprimin e tij. Ideja që njerëzit luajnë role të ndryshme në kohë dhe kontekste të ndryshme, është jashtëzakonisht e rëndësishme për teorinë e Bronfenbrennerit. Individët luajnë role të ndryshme kur marrin pjesë në mikromjedise të ndryshme. Carl Jungu, marrjen e roleve në kohë dhe kontekste të ndryshme, e përkufizoi si arketipi i maskës. Rolet sociale janë përkufizuar si sjellje të pritshme ,të lidhura me marrëdhënie të ndryshme ndërpersonale. Rolet kanë një fuqi të madhe, për të shndërruar mënyrën ,se si një person trajtohet, sillet, çfarë dëshiron, apo çfarë mendon dhe ndjen. Këto role kanë efekte transformuese dhe zhvilluese për adoleshentin dhe për të gjithë të tjerët, me të cilët ai/ajo ndërvepron. Pasuria apo varfëria e mesosistemit, varet nga sasia dhe cilësia e marrëdhënieve dhe vlerat që ndahen, ose nuk ndahen në këto marrëdhënie (Bronfenbrenner, 1993).Mesositemi analizon cilësinë, shpeshtësinë dhe

ndikimin e ndërveprimit të përvojave familjare, në përshtatjen me mjedisin social. Eksosistemi është i gjithë kuadri komunitar, në të cilin jeton adoleshenti dhe përfshin ekspozimin ndaj lëndëve toksike, ndotjes në të gjitha format e saj. Megjithatë adoleshenti ,nuk merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen e ekosistemit, këto vendime kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ,ose jo të drejtpërdrejtë në jetën e tij duke nxitur sjellje të caktuara si agresion fizik, verbal. Ngjarjet që ndodhin dhe vendimet që merren në një mjedis, në të cilin individi bën pjesë, ndikojnë fuqimisht në zhvillimin e tij. Eksosistemi komprometon lidhjen dhe proceset e ndërmarra midis dy ose më shumë mjediseve, ku të paktën njëri prej tyre nuk përmban zhvillimin e personit, por në të cilin shkaktohen ngjarje, që ndikojnë në proceset dhe mjedisin aktual ku jeton individi që po zhvillohet. Tre ndikimet më të fuqishme zhvillimore të ekosistemit janë: marrëdhënia e vendit të punës së njërit ose të të dy prindërve, rrethi miqësor i prindërve dhe ndikimi i fqinjëve dhe mjedisit natyror në funksionimin e familjes. (Bronfenbrenner, 1993). Eksosistemi mund të forcojë dhe të pasurojë cilësinë e mikro dhe mesosistemit, përmes vendimeve të cilat ndikojnë, në atë se çfarë një adoleshent mundet ose nuk mundet të bëjë. Vërtet adoleshenti nuk është pjesë e mjedisit ku punojnë prindërit, por vendimet që merren në këtë mjedis, ndikojnë në mënyrë indirekte në jetën e adoleshentit.

2.3.3 Ndikimi i familjes, si faktor risku në sjelljen agresive fizike te adoleshentët

Mosha e adoleshencës karakterizohet nga ndryshime të shumta, jo vetëm në aspektin fizik, emocional, por edhe në kontekstin shkollor dhe marrëdhëniet familjare ,ndaj njihet dhe si periudha e tranzicionit nga fëmijëria në moshën e rritur (Arnold Van Genep, 1909). Adoleshentët përjetojnë një boshllëk të brendshëm, ndjenja pazotësie si dhe ndjesinë se janë jo të kompletuar. Njëkohësisht, adoleshenti ndihet i dobët nga ana psikologjike ,për t'u përballuar me presionin e përditshëm (Karaj,Th. Psikologjia e zhvillimit të fëmijës 2005:315).

Familja vazhdon që të ndikojë mbi adoleshentin, por lidhjet mes adoleshentit dhe familjes ,mund të bëhen të tendosura. Lindin konflikte, shumica e të cilave kanë të bëjnë me punët e përditshme, me shoqërinë e adoleshentit, sidomos me seksin tjetër, me përparimin në mësim, me pamjen e jashtme etj. Në përgjithësi, adoleshencia e hershme, ka më tepër konflikte me familjen, sesa adoleshencia e vonë. Stili i prindërimit, ndikon shumë në moshën e adoleshencës. Ngrohtësia prindërore, rrit besimin tek vetja tek shumica e adoleshentëve.

Egziston një mendim mjaft i përhapur , se adoleshentët përdorin konfliktin dhe rebelimin, si mjete për të arritur pavarësinë prej prindërve të tyre. Shumica e studimeve vënë në dukje, se kjo është e ekzagjeruar. Megjithatë, është fakt se distanca midis adoleshentëve dhe prindërve të tyre, rritet sidomos gjatë adoleshencës së hershme. Shpesh adoleshentët janë kritikë ndaj të gjitha situatave socialedukative, përfshirë të gjithë familjen. Grindjet bëhen më të shpeshta, gjatë adoleshencës së hershme 11- 14 vjeç. Sipas studiuesve Fuchs, Midgett, Ryan dhe Adams, (2000) këto grindje kanë një funksion pozitiv, sepse e lejojnë adoleshentin të testojë independencën e tij, në kushtet e sigurta të jetës së familjes. Sipas studiuesve Gonzales, Cauce, Friedman, dhe Mason, (1996) adoleshenca është një kohë, ku prindërit dhe fëmijët e tyre duhet të negociojnë . Adoleshenti duhet të fitojë më shumë pavarësi; prindërit duhet të fillojnë të shohin atë si më shumë të barabartë me veten, si një individ që ka të drejtë të ketë opinione të ndryshme. Nëse do ti referohemi fabulës personale në adoleshencë, si një ndër komponentët e egocentrizmit konfliktet e vazhdueshme adoleshent-prind, do ti shpjegojmë me faktin, se adoleshentët binden se prindërit e tyre kanë shumë dobësi dhe se ata janë perfekt. Fatmirësisht egocentrizmi fillon të eliminohet nga moshë 15-16 vjeç.

Këto ndryshime ndikojnë në raportet e adoleshenteve me prindërit e tyre dhe shpesh, shoqërohen me rënie të arritjeve akademike (Barber dhe Olsen, 2004; Eccles, 2004; Gutman dhe Midgley, 2000). Funksionimi i familjes dhe roli që ajo luan për të mbështetur adoleshentin në këtë periudhë ndryshimesh, është vlerësuar nga studiuesit e shkencave të edukimit si faktor tepër i rëndësishëm, jo vetëm për një zhvillim të shëndetshëm, por edhe për manifestimin e sjelljeve aggressive nga ata (Annuziata, Hogue, Faw dhe Liddle, 2006; Floyd, 1997; Martini, 1995; Mohanraj, R., Latha, 2005; Ramsey, 2008; Unger, McLeod, Brown, dhe Tressell, 2000).

Studimet e fokusuara tek ndikimi i familjes në manifestimin e sjelljes aggressive nga adoleshentët ,arrijnë në konkluzionet se konfliktet e vazhdueshme në familje, një klimë jo e qetë në mjedisin familjar, ndëshkimi i vazhdueshëm fizik, mbi fëmijën nga prindi,mosfunksionimi i familjes, si system i shëndetshëm ,i nxisin adoleshentët në të qenit agresive ndaj të tjerëve. (Alink, Mesman, Zeijl, Stolk, Juffer, Bakermans-Kranenburg, & Ijzendoorn, 2009; Tanaka, Raishevich, & Scarpa, 2010; Weiss, Dodge, Bates, & Pettit, 1992).

Ndaj ,si faktorë risku përse i përket mjedisit familjar, që ka ndikim mbi manifestimin e sjelljes agresive tek adoleshentët shqyrtojmë si mëposhtë:

I. Struktura e familjes

Struktura i referohet numrit të anëtarëve të familjes dhe të pozicioneve siç janë; nëna, babai, fëmijët, gjyshërit xhaxhallarët, tezet, kushërinjtë dhe të afërmit e tjerë që përbëjnë sistemin familjar. Studimet tregojnë, se familja shqiptare dominohet kryesisht nga tri tipologji: familja nukleare, familja e zgjeruar dhe familja me një prind (Kera, Hemming dhe Pandelejmoni, 2009).

Familja nukleare, që është e formuar nga dy gjenerata, prindërit dhe fëmijët. Kjo është karakteristike në shoqëritë e sotme industriale. Struktura e familjes dhe funksionimi i saj ,kanë në thelb cilësi vetjake dhe jo kolektive. Që në vitin 1949 sociologu Parsons, e konsideroi familjen nukleare, rrjedhojë të zhvillimeve teknologjike dhe ndryshimeve sociale, që ato shkaktojnë. Përveç familjes nukleare, një tip tjetër është edhe familja e zgjeruar që përbëhet nga tri gjenerata: gjyshërit nga të dyja anët e prindërve, grua/nënë, burri/baba, dhe fëmijët e tyre, xhaxhallarët/dajat, hallat/tezet, nipërit, mbesat, kushërinjtë dhe të afërm të tjerë si nga ana e gruas ashtu edhe e burrit. Familja e zgjeruar gjendet në shoqëritë jo të industrializuara, kryesisht të lidhura me agrikulturën. Mbizotërimi i këtij tipi të familjes shpjegohet nga kushtet ekonomike dhe

sociale, nga nevoja që të gjithë anëtarët e familjes të ndihmojnë në përballimin e problemeve ekonomike. Një nga tiparet kryesore të familjes së zgjeruar, është bashkëpunimi i anëtarve të familjes dhe edukimi i fëmijëve me vlerën shoqërore të bindjes dhe përgjegjësisë. Babai është figura kryesore e familjes, dhe marrëdhëniet e bashkëshortëve karakterizohen nga mirëkuptimi reciprok dhe jo nga dashuria reciproke. Çdo anëtar i familjes, sakrifikon dëshirat e tij private, në funksion të nevojave të familjes (Kera, Hemming dhe Pandelejmoni, 2009). Familja me një prind , ka tipar kryesor mohimin e jetës bashkëshortore dhe pranimin e rolit të prindit. Në shumicën e rasteve, kreu i familjes është grua dhe më rrallë burri. Divorci, tendenca e grave për të qenë të pavarura, por edhe rritja e numrit të nënave të pa martuara, kanë kontribuar në rritjen e numrit të familjeve me një prind. Familjet me një prind, përballen me probleme të ndryshme të natyrës ekonomike dhe praktike, pasi shpesh konsiderohen si të pa dëshirueshme dhe i kushtohen me shumë vëmendje fëmijëve dhe jo prindit (King dhe Master, 2000). Studimet e fundit, tregojnë se struktura e familjes shqiptare është në tranzicion, domethënë familja e zgjeruar karakteristikë e viteve më parë, ia lë vendin familjes nukleare. Megjithatë, familja nukleare shqiptare mbështetet në vlerat tradicionale të lidhjes me prindërit dhe fisin (Kera, Hemming dhe Pandelejmoni, 2009). Mbi bazën e studimeve të mëparshme, ka rezultuar se marrëdhëniet mes gjeneratave në familjet shqiptare,

karakterizohet nga harmonia, ndërvarësia emocionale dhe materiale dhe ruajtja e hierarkisë, mes anëtarëve të familjes (Antoniou, Dalla, Kashahu, Karaj, Georgiadhi dhe Mihailidhis, 2013). Gjithashtu, tipi i familjes, domethënë, e zgjeruar ose nukleare, nuk dobëson kohezionin dhe fleksibilitetin mes anëtarëve të familjes (Antoniou etj., 2013).

Ndryshimet specifike ,në mënyrën se si funksionon familja, mund të kontribuojnë negativisht në manifestimin e sjelljeve aggressive nga adoleshentët.

II. Karakteristikat e personit

Shumë përpjekje kërkimore, kanë qenë të përkushtuar për të studiuar trajektoret e zhvillimit të agresionit, nga fëmijëria e hershme në adoleshencë (Tremblay & Nagin, 2005). Sipas një studimi të kryer në Kanada, Zelanda e Re, Shtetet e Bashkuara i cili shqyrtoi marrëdhëniet midis agresivitetit dhe moshës së fëmijërisë deri në adoleshencë, rezultoi se manifestimi i sjelljeve aggressive ishte më i lartë tek individët e gjinisë mashkullore nga mosha 6 – 15 vjeç Broidy et al. (2003). I njëjti studim ,u krye nga studiuesit kineze të cilët shqyrtuan trajektoren e zhvillimit të sjelljes agresive, nga ku pjesëmarrës ishin 1618 nxënës të shkollave kineze MIDDLE , mes moshës 9 deri në 12, (Chen, Zhang, Ji, Chen Wei, dhe Chang, 2011). Ky studim arriti në rezultatet se 68.7% e individëve të grupmoshës 9-15 vjec kryenin sjellje aggressive në nivele të larta, 26.8% e individëve të grupmoshës 9-15 vjec kryenin sjellje aggressive në nivele të moderuara dhe vetëm 4.5% e individëve kryenin sjellje aggressive në nivele të ulta. Djemtë shfaqnin një nivel më të lartë të sjelljeve fizike aggressive, në krahasim me vajzat në fillim të adoleshencës. (Barth et al, 2004;. Card, Stucky, Sawalani 2008;Mott, Levy, 2000;).

Dallimi gjinor,i atribuohet shkaqeve sociale të manifestimit të sjelljes aggressive ,pasi edhe në shoqëri agresiviteti i vishet si tipar personaliteti gjinisë mashkullore (Keenan, dhe Shaë, 1997).

III.Faktorët e Microsystemit në mjedisin familjar ,që lidhen me agresivitetin

- Etnia /origjina e prindërve

Shqyrtimi i literaturës, duke iu referuar etnisë së prindërve, tregon se ndëshkimi fizik është më i zakonshëm te prindërit Afrikan, Amerikan, se tek prindërit Europiane (Deater-Deckard, Dodge, Bates, dhe Pettit, 1996; Straus dhe Steëart 1999). Hulumtimi gjithashtu tregon ,se ndëshkimi fizik I prindërve parashikon sjellje aggressive të adoleshentëve, kundrejt

bashkëmoshatarve të tyre (Erath, Bierman, Research Group, 2006; Taylor, Manganello, Lee, dhe Rajs, 2010). Kështu, etnia e kujdestarit primar do të mund të ndikojë në sjelljen agresive të fëmijës në mënyrë të tërthortë përmes ndëshkimi fizik.

- Arsimitimi i nënës

Niveli i ulët arsimor i nënës, përbën një faktor risku, për zhvillimin e sjelljeve aggressive në fëmijërinë e hershme (Benzies, Keown, dhe Magill-Evans 2009; Côté et al., 2007). Formimi i ulët arsimor i nënës, rrit gjasat që fëmijët të kryejnë sjellje aggressive fizike (Côté et al, 2006; Harachi, Fleming, White, Ensminger, Abbott, Catalano, & Haggerty, 2006).

- Ngrohtësia prindërore

Ka disa mospërputhjet në literature, përsa i përket ndikimit të ngrohtësi prindërore në zhvillimin e sjelljeve aggressive. Ka studime, që mbështesin tezën se ngrohtësia prindërore nxit sjelljen aggressive tek fëmijët e moshës 6 – 12 vjec (Alink et al., 2009); ndërsa hulumtimi tjetër konstaton se ngrohtësia prindërore është dukshëm e lidhur negativisht me sjelljen aggressive (White & Renk 2012; Chen, Wu, Chen, Wang, dhe Cen, 2001).

- Klima në familje

Sipas hulumtimeve, klima e qetë në familje dhe rritja e fëmijës në një mjedis të qetë deri në adoleshencë dhe më vonë, përbën një faktor mbrojtës përsa i përket zhvillimit të agresionit (O'Neal, Brotman, Huang, Gouley, Kamboukos, Calzada, dhe Pine, 2010). Ekspozimi i adoleshentit ndaj një klime jo të qetë në familje, dhe skenave të dhunës përbën faktor risku, për manifestimin e sjelljeve aggressive të tyre (Erath, Bierman, Research Group, 2006).

- Ndëshkimi fizik.

Sipas studimeve të realizuara në Shtetet e Bashkuara, rezultoi se ndëshkimi fizik i prindërve ndaj fëmijëve përbën një faktor risku nxitës për zhvillimin e sjelljeve aggressive tek adoleshentët. Kjo lidhet me mekanizmin mbrojtës të Zhvendosjes nga ku adoleshentët ndëshkimin fizik prindëror e zhvendosin ndaj bashkëmoshatarve të tyre ose ndaj fëmijëve më të vegjël (Straus & Steeart, 1999). Straus dhe Kantor (1994, p.543) përcaktuan, se ndëshkimin fizik përbën probabilitet të lartë të manifestimit të dhunës në marrëdhëniet intime në një moshë të vonë.

Disa studime treguan, se ndëshkimi fizik mund të bashkëveprojë me karakteristika të tjera të prindërve, të tilla si ndjeshmëria ndaj nënës dhe mbështetja emocionale. Këto dy minifaktorë

rezultojnë të jenë moderatorët midis ndëshkimit fizik prindëror dhe zhvillimit të agresionit nga fëmijët (et Alink al 2009. McLoyd & Smith, 2002).

- Ekspozimi ndaj dhunës.

Ekspozimi ndaj dhunës, është një fenomen i përhapur ,sipas një studimi të një mostre në Shtetet e Bashkuara, i cili tregon se rreth një e treta e të gjithë fëmijëve janë viktimë e disa formave të dhunës, dhe rreth 90 për qind e dëshmitarëve janë viktimë e saj, të paktën një herë gjatë jetës së tyre (Richterët & Martinez, 1993). Shumë studimet retrospektive, tregojnë se ekspozimi ndaj dhunës gjatë fëmijërisë, parashikon sjelljen agresive në adoleshencë (Henning, Leitenberg, Coffey, Bennett & Jankowski,1997; Millettich, Kelley, Doane, dhe Pearson, 2010; Bailey & Coore-Desai, 2011).

Në një studim shqyrtim meta-analitik,është demonstruar një lidhje e rëndësishme mes ekspozimit të individëve ndaj skenave aggressive, nga fëmijëria ,në adoleshencë (Gaylord, Holt,& Kenny, 2003). Kjo meta-analizë, tregoi gjithashtu, se ekspozimi ndaj skenave të dhunës ,nxit zhvillimin e saj tek vetë individët e ekspozuar. Kjo tezë u mbështet edhe nga një studim i thellë i mëvonshëm (Guerra, Huesmann & Spindler, 2003). Për më tepër, u arritën konkluzionet ,se (1) dhuna është një mënyrë e përshtatshme për të zgjidhur konfliktet; (2) dhuna është pjesë e marrëdhënieve në familje; (3) Dhuna është një mënyrë për të kontrolluar njerëzit e tjerë "(Osofsky, 2003, f. 165). Hughes, Parkinson, dhe Vargo (1989) kanë treguar, se ekspozimi i individëve ndaj skenave të dhunës ka efekte kumulative.

- Dinamikat familjare dhe disfunkcionimi i familjes, si sistem i shëndetshëm

Konfliktet në familje dhe dinamikat familjare ,përbëjnë një factor risku, përsa i përket zhvillimit të agresivitetit nga pjestarët e familjes (Andreas & Watson 2009 page: 21,;. Tanaka et al, 2010; Cummings, Goeke-Morey, dhe Papp, 2004; Li et al, 2011). Konfliktet në familje, janë të lidhura direct me agresionin e fëmijëve, në studimet me fëmijë të fëmijërisë së mesme (Cummings et al., 2004; Li et al., 2011). Tanaka et al. (2010) 's.

Studimet konfirmojnë ,se konfliktet në familje u shoqëruan me rritjen e zhvillimit të sjelljeve aggressive, tek fëmijët dhe adoleshentët. Përveç kësaj, një mjedisi pozitiv familjar, redukton sjelljet agresive të fëmijëve dhe adoleshentëve (Andreas & Watson, 2009 page: 189-205).

Duke iu referuar të gjithë studimeve të literatures së marrë nën shqyrtim, rezulton se mjedisi pozitiv familjar, redukton agresivitetin e fëmijëve dhe adoleshentëve , ndërsa mjedisi negative familjar, rrit sjelljen agresive të fëmijëve dhe adoleshentëve.

2.3.4 Ndikimi ekologjik specifikisht ndotja industriale si faktor risku në sjelljen agresive fizike te adoleshentët.

Ekologjia (ojkos, vendbanim dhe logos, shkencë ose dije) është degë e Biologjisë, e cila meret me studimin e vendbanimit. Qeniet e gjalla, të cilat jetojnë, kanë marrdhënie shumë të ngushta dhe të përhershme me njëra-tjetrën. Këto marrëdhënie, si dhe faktorët që ndikojnë në këta organizma, i studion shkencat e Biologjisë, Ekologjia. Ekologjia cilësohet edhe si shkencë, e cila meret me studimin e strukturës dhe funksionimit të biosferës. Ajri, toka, ujrat e lumenjve, liqeneve, deteve e oqeanëve, ujrat nëntokësorë dhe gjithçka ku jetojnë dhe ndikojnë tek njeriu, përbëjnë mjedisin rrethues. Ekspozimi ndaj ndotjes së mjedisit, përbën një problem madhor në të gjithë botën, përse i përket ndikimit negativ dhe pasoja që ka mbi shëndetin (Briigs, D, 2003). Sot zhvillimi i vullshëm ekonomik i botës dhe civilizimi i saj, krahas progresit të madh që kanë sjellë, kanë ndërhyrë edhe në dëmtimin, ku më shumë e ku më pak, të mjedisit tonë rrethues.

Sot, mjedisi ku zhvillohet aktiviteti i botës së gjallë, është shumë i ndotur me produkte e mbeturina të shumëllojshme, ndër to vendin kryesorë e zënë mbetjet kimike apo siç i njohim ndryshe, kimikatet dhe mbetjet radioaktive. Të gjitha këto dëmtojnë dhe shkatërrojnë pa dallim bimët, kafshët edhe vetë njeriun.

Natyra me anë të proceseve dekompozuese, që shkaktoheshin ose përshpejtoheshin nga dukuritë natyrore, si ato atmosferike, tokësore, diellore etj., bëjnë të mundur eliminimin e këtyre mbeturinave ndotëse. Por ky ekuilibër, është i pamjaftueshëm dhe në mbrojtjen e natyrës sot, është shumë e domosdoshme ndihma e njeriut. Plehurat dhe hedhja e tyre vend e pa vend, dëmtojnë rëndë mjedisin rrethues, dëmtojnë rëndë shëndetin e vetë fajtorit, njeriut.

Ndryshe nga sa ndodh në botë, ndotja akustike është një nga problemet më të mëdha në botë. Mirëpo, ndërsa para viteve '90 njiheshin zhurmat e prodhimit në industrinë tekstile, minerale, mekanike, etj., aktualisht ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve tregojnë që ato janë të pranishme gjatë ditës dhe natës, krijohen dhe nga aktivitete private, qofshin këto lokale nate, apo sallone të ndryshme.

Shqetësimet e banorëve lidhen me linjat e prodhimit të bukës, klinikat dentare në godina banimi, apo zhurmat e makinave e trafikut të rënduar. Inspektorët e mjedisit ndërmarrin herë pas here aksione për zbatimin e ligjit të zhurmave, ndërsa kanë marrë masat përkatëse në çdo rast konstatimi të shkeljes së ligjit.

Megjithatë, zhurma me burim të ndryshëm është prezente. Banorët ngrenë shqetësime edhe për rënien papushim sinjalet e alarmit , që sipas tyre, "kur fillojnë të bien nuk dinë të mbarojnë". Por, burime zhurmash, të cilët na qëllon ta dëgjojmë rëndom, janë edhe pompat e ujit nëpër pallate, apo aktivitete të ndryshme pranë godinave të banimit, etj.

Rreziqet në shëndet nëse ndokush mund të shfaqë zemërim, apo pakënaqësi, shkak mund të kenë qenë dhe zhurmat e larta. Perceptimi i zhurmave në jetën e përditshme ka një rëndësi të madhe për mirëqënien e shëndetit të popullatës, shprehen specialistët e shëndetit publik.

Në qoftë se ka një ‘bombardim’ nga zhurma, të përditshëm, me kalimin e kohës, kjo ndikon edhe në shëndet. Në radhë të parë, zhurmat ndikojnë, duke shkaktuar një traumë të strukturave kokleare të veshit të brendshëm që çojnë deri në një humbje të dëgjimit të pakthyeshme. Por, edhe në sëmundjet e hipertensionit, pasi duke çliruar më tepër adrenalinë në gjak, rritet tensioni i këtyre njerëzve, që marrin nivel zhurmash më të madh se norma, në sëmundjet ishemike të zemrës, në çrregullime të gjumit, por edhe në performancën e përditshme të njerëzve të ekspozuar ndaj zhurmave, sqarojnë specialistët.

Ndërkohë, ka evidenca të pjesshme, që vijnë nga perëndimi, të cilat i japin dhe dëmtime në sistemin imunitar dhe defekte në lindje. Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në vlera komuniteti, ndotja akustike ul produktivitetin, aftësinë për të mësuar, rrit aksidentet, rrit asenteizmin dhe kontribon në përdorimin e barnave narkotike.

Njeriu duhet të jetojë në harmoni me natyrën, duhet të kujdeset për atë, dhe të zhfrytëzojë me efikasitet të mirat e saj, përndryshe ,natyra e ndëshkon atë dhe brezat që do të vijnë.

Shumë popullata janë të ekspozuara ndaj shume fenomeneve të ndryshme ekologjike, të tilla si ndotja e ajrit, ndotja e ujit, çlirimit të plumbit në mjedis nga operacionet e bojës dhe minierave dhe shkrirjes, ndotja akustike etj. Të gjitha këto ndotje janë toksike për njerëzit..

Sipas një studimi të publikuar në revistën Societies,(Bronfenbrenner, U. (2004). Making Human Beings Human: Bioecological Perspectives on Human Development),nëse një adoleshent godet të tjerët dhe nuk shkon mirë me shokët e tij, përveç faktorëve social si disiplina në familje duhet fajësuar edhe zona ku jeton.Studimi që ka vëzhguar 1293 familje nga nëntë vende (Kina, Kolumbia, Italia, Jordania, Kenia, Filipinet, Suedia, Tajlanda dhe SHBA) tregon, se fëmijët shfaqin sjellje agresive, nëse jetojnë pranë zonave industriale.

Në një studim të bërë në Amerikë, për ekspozimin e kimikateve ,ndaj ujit dhe çrregullimit të hiperaktivitetit dhe agresivitetit në mesin e fëmijëve dhe adoleshentëve në Shtetet e Bashkuara, i bërë nga një shoqatë ekologjike, doli në rezultate se në vitin 2002, 2003 dhe

2007, kishte një rritje të konsiderueshme të agresivitetit tek adoleshentët. Kjo e konfirmuar edhe pas një analize të statusit socio-ekonomik të familjeve, që morën pjesë në studim. Nëse në vitin 1992 kishin 67.000 fëmijë, të diagnostifikuar me crregullim sjellje dhe agresivitet, nga viti 2003 e deri në 2011, u diagnostifikuan 131.000 adoleshentë.

Përbërës që mund të cojnë në uljen e IQ, sic është ekspozimi ndaj plumbit, gazit, bojërave të dëmshme, bakteret, rezultojnë se mund të ndikojnë dhe në sjelljen e papërqëndruar, hiperaktivitetit, sjellja impulsive dhe e pakontrolluar mirë, anti-social dhe agresivitet. Këtë e demostroi në fillim bindshëm Needleman et al si një komponent në studimin e tij klasik të toksicitetit të plumbit tek fëmijët e shkollës në Boston. Ai gjeti se fëmijët e ekspozuar ndaj plumbit ishin më të papërqëndruar, të varur, hiperaktiv, impulsiv, më pak të aftë për të ndjekur udhëzimet e thjeshta dhe kishin performancë të ulët. Ekspozimi në mjedise toksike është tepër i rrezikshëm për jetën e njeriut ndaj i duhet kushtuar rëndësia e duhur . Përsa i përket nivelit të ekspozimit ndaj ndotjes industriale, në shumë vende të botës, kjo mbetet një çështje e paspecifikuar, si rezultat i mungesës së monitorimit të vazhdueshëm nga strukturat shëndetësore. 8-9% e sëmundjeve i atribuohen ndikimit ekologjik më konkretisht ndotjes industriale , kimikateve në ujë, ajër etj. Ndotja industriale (Taubes G,1995), merr forma të ndryshme ,duke përfshirë jo vetëm kimikate, por dhe organizma e material të tjera biologjike si për shembull zhurma, rrezatimi etj. Përsa i përket kimikateve që përbëjnë burim ndotës në mjedis, nuk dihet me saktësi numri i tyre, por përlllogaritet me përafërsi 30.000 kimikate (Royal Commission on Environmental Pollution, 2003). Më pak se 1% e tyre, janë studiuar përsa i përket risikut që mbartin dhe toksicitetit. Shpërndarja e kimikateve në ujë , tokë i ngjason një reaksioni zinxhir, ndaj dhe shmangia ndaj ekspozimit të tyre është e pamundur (Colville R, Briggs DJ.2000).Studime epidemiologjike kanë shqyrtuar në mënyrë specifike ndikimin ekologjik, me konkretisht ndotjen industriale në anamalitë kongjenitale (Dolk, H. and Vrijheid M., 2003). Anomali të kongjenitale janë diagnostikuar në 2-4% të lindjeve ,në zonat industriale.

Metalet e rënda, nitratet, plumbi, tretës të kloruar dhe aromatike, vendbanimi afër deponive të mbeturinave dhe toksve të kontaminuara, ekspozimi ndaj pesticideve në zonat bujqësore, ndotja e ajrit dhe burimet e tjara të ndotjes industriale, përbëjnë faktorë risku për zhvillimin e anomalive kongjenitale.

2.3.5 Një vështrim i përgjithshëm i marrëdhënies mjedis – individ – shëndet

Mjedisi dhe njeriu ndërveprojnë në mënyrë intensive, duke shkaktuar efekte të ndërsjella tek njëri-tjetri. Kjo gjë vihet re më shumë në ditët e sotme falë zhvillimit industrial, teknologjik, infrastrukturor, urbanizimit masiv, etj. Aktualisht, shumica e vendeve po përballen me një sërë problematikash të reja sociale e mbi të gjitha shëndetësore të shkaktuara nga dëmtimi i mjedisit pasojat e të cilave i vuan vetë individi. Kjo pasi vetë veprimtaritë dhe aktivitetet që njerëzit kryejnë për të siguruar jetesën e përditshme në mënyrë të pashmangshme ndikojnë drejtpërdrejtë në shëndetin e tyre. Njeriu mund të shkaktojë ndotjen përmes prodhimit, apo përmes konsumit, kur përdor energji, lëndë djegëse, kur prodhon mbeturina apo keqpërdor burimet e tjera natyrore. Aktivitetet ekonomike, kanë gjithashtu ndikime të konsiderueshme në mjedis. Ato përdorin energjinë për makineritë, lëndët djegëse për transport, apo lëndën e parë për prodhim. Në përfundim të ciklit prodhues, krijojnë mbetjet të cilat duhet të përpunohen. Kështu pra, aktiviteti human (individual apo ekonomik) përveç se rrit mirëqenien tonë, sjell efekte të dëmshme që nuk mbeten vetëm tek mjedisi. Këto efekte reflektohen në probleme shëndetësore (deri në vdekje të parakohshme), në probleme sociale si dhe në vetë cilësinë e jetës së njerëzve.

Qeniet njerëzore, janë krejtësisht të varura nga burimet natyrore për plotësimin e nevojave të tyre bazë, gjë e cila në mënyrë të paevitueshme do të çojë në kriza dhe kolaps shoqëror (Dobson, 1991; Martell, 1994). Ky ndikim mund të sjellë dëmtime në botën natyrore, por nga ana tjetër mbart kosto sociale, të cilat duhet të përballohen nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë, duke ndikuar më tej aktivitetin e tyre (Huby, 1998). Ky cikël është përshkruar me termat e një marrëdhënieje “presion - gjendje - reagim”. Aktiviteti njerëzor, ushtron presion mbi mjedisin dhe ndryshon gjendjen e tij, përse i përket cilësisë dhe rezervave natyrore. Shoqëria reagon ndaj këtyre ndryshimeve përmes politikave mjedisore, ekonomike dhe sektoriale si dhe përmes ndryshimit të sjelljes, duke ndikuar kështu, mbi presionin që ushtrojnë aktivitetet njerëzore. Përmbushja e këtij cikli kërkon impenjim shumëfaktorial e mbi të gjitha ka një kosto të caktuar (Department of the Environment, 1996). Megjithatë, mund të thuhet se ka një rritje të ndërgjegjësimit dhe rritje të interesit të publikut për këto ndryshime dhe ndikime, edhe pse ka ende për të bërë. Pikë së pari, kjo lidhet me mungesën e konsensusit rreth mënyrës më të mirë për mbrojtjen e mjedisit, duke na lejuar në vazhdimësi zhvillimin ekonomik dhe social në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare. Barra për degradimin mjedisor, nuk bie gjithmonë mbi ato pjesë të shoqërisë që janë përgjegjësit dhe shkaktarët kryesor. Shpesh, njerëzit që vuajnë më shumë nga problemet mjedisore, janë të

ndryshëm nga ata të cilët korrin përfitimet e aktiviteteve përkatëse. Problemi i dytë lidhet me faktin se, veprime të izoluara të individëve, shoqërive apo vendeve, jo gjithmonë kanë efekt mbi dëmet e shkaktuara. Problemi i tretë lidhet me faktin se, strukturat sociale të shoqërisë dhe organizimet e saj, i vendosin disa individë në pozita, ku nuk mund të ndërmarrin veprime, që do të çonin në kufizime të dëmtimit të mjedisit, edhe pse do të donin të kontribuonin në këtë çështje (Huby, Owen, Cinderby, 2007). Faktorët primar që ndikojnë shëndetin, lidhen me aksesin ndaj ujit të pijshëm dhe të shëndetshëm, cilësinë e ajrit, sigurinë në punë dhe aksidentet. Mjedisi llogaritet se shkakton një të tretën e totalit të sëmundshmërisë, për moshat 0-19 vjeç. Pështja e sëmundshmërisë e shkaktuar nga faktorë të njohur mjedisor, varion sipas vendeve (WHO, 2010). Sipas raportit të OBSH-së në mbarë botën çdo vit shkaktohen rreth 3.1 milion vdekje të parakohshme, si rezultat i ndotjes së ajrit e shkaktuar më së shumti nga djegia e karburanteve apo nga ndotës të tjerë, të krijuar kryesisht nga zhvillimi industrial (WHO, 2009). Po sipas OBSH-së, rreth 3.2% e sëmundjeve në shkallë globale shkaktohen nga ndotja e ajrit (WHO, 2009). Rreth gjysma e sëmundjeve në nivel global të shkaktuara nga ndotja e ajrit, i përket vendeve në zhvillim. Ndotësit e ajrit, shkaktojnë një sërë efektesh negative në shëndetin e njeriut, duke përfshirë infeksionet respiratore (në rrugët e frymëmarrjes), kancer të mushkërive dhe sëmundje të zemrës. Reduktimi i nivelit të ndotjes së ajrit, do të ulë barrën globale shëndetësore në lidhje me këto sëmundje (WHO, 2009).

Mjedisi po kthehet në një mbartës të kërcënimeve për shëndetin e njeriut dhe mirëqenies së tij. Është e qartë se efektet e ndotjes së mjedisit, nuk prekin të gjithë individët dhe shoqëritë njëjloj. Ndryshimet i referohen një shumësie faktorësh, që lidhen me vendosjen pranë burimeve ndotëse, punësimin, nivelin socio-ekonomik e kulturor, ndërgjegjësimin apo nivelin e informacionit. Studiues të ndryshëm, i kanë kushtuar rëndësi rolit të madh që mund të kenë praktikuesit e fushës sociale, në çështje që lidhen me katastrofa mjedisore të shkaktuara nga incidentet industriale, konfliktet njerëzore apo ndryshimet klimaterike. Autorë të ndryshëm eksplorojnë konceptin “puna sociale e gjelbër” dhe rolin e saj në përdorimin e krizave mjedisore, për të adresuar varfërinë dhe format e tjera të pabarazisë mes shtresave shoqërore, në mënyrë që të sigurojnë një shpërndarje më të drejtë, të burimeve të kufizuara natyrore si edhe për të përballuar forcat socio-politike në nivel global, që kanë një ndikim negativ mbi cilësinë e jetës së grupeve të varfëra dhe të marginalizuara të shoqërisë në nivel lokal. (Dominelli, 2012). Problemet e drejtësisë sociale, gjithnjë e më shumë po ndikojnë në dimensionet e mjedisit. Lidhja midis pabarazive në ekspozimin e risqeve mjedisore dhe

pabarazive në shëndet, janë një temë që tashmë ka nisur të studiohet në detaje. Një numër i caktuar njerëzish, priren të paguajnë më së shumti koston për prodhimin përsa i përket ndotjes (WHO, 2009). Po kështu është e vërtetë së aksesit në përfitimet mjedisore, varet thelbësisht nga të ardhurat (Sir John Harman, Chairman of the Environment Agency, 2000). Problemet mjedisore janë serioze dhe kanë ndikim kryesisht në grupet më të ndjeshëm dhe të rrezikuar të shoqërisë, si të moshuarit, fëmijët dhe të varfërit (Michael Meacher, Ministër i Mjedisit në Mbretërinë e Bashkuar). Studime të ndryshme kanë përforcuar të dhënat, se njerëzit e varfër dhe me nivel socio- ekonomik të ulët, janë të vendosur në banesa jo cilësore dhe kushtet jo mjedisore ndikojnë jo vetëm në shëndetin fizik, por edhe në mirëqenien mendore të tyre (Fairburnl & Braubach, 2009). Në përgjithësi ka një lidhje të qartë mes cilësisë së ajrit dhe statusit ekonomik, sa më i varfër të jesh, aq më shumë priret të thithësh ajër më të ndotur (Fairburnl & Braubach, 2009). Vendbanimi pranë burimeve ndotëse, gjithashtu po i vendos individët në situata të vështira. Shumë shpesh konsumimi i ushqimeve, përdorimi i ujit apo i tokës apo i prodhimeve bujqësore e blegtorale, po shkon drejt minimizimit për shkak të ndotjes, gjë e cila rrit koston e jetesës për këta individë. Për shkak të çmimeve të ulta të banesave, përreth burimeve të shkarkimit, fabrikave, centraleve elektrike (ku substancat ndotëse janë më të larta) individët me nivel të ulët të ardhurash, zgjedhin të ndërtojnë vendbanimet e tyre, por nga ana tjetër do të kenë mundësi të limituara të zhvendosjes prej tyre. Ndërsa individët me nivel të lartë të ardhurash, do të kenë mundësinë e zgjedhjes dhe të qëndrimit larg tyre. Natyrisht, që ka raste ku zgjedhje të tilla nuk janë të mundura, megjithatë paratë ofrojnë pushtet, kështu që ata që i posedojnë mund të kontrollojnë cilësinë e ajrit ku jetojnë, nivelin e zhurmave brenda zonës së banimit, apo mund të konsumojnë ushqime me më pak mundësi ndotjeje, siç mund të jetë uji i ambalazhuar (OECD, 2006). OBSH ka zhvilluar një model strukturor për të identifikuar rrugët (mënyrat) potenciale, përmes të cilave pabarazitë sociale mund të influencojnë ekspozimin dhe treguesit shëndetësor, ndaj rreziqeve mjedisore (WHO, 2009).

- Mënyra e parë. Ekziston një lidhje midis përcaktuesve socialë dhe kushteve mjedisore. Grupet e pafavorizuara mund të jetojnë, të punojnë ose të jenë të rrethuar nga kushte mjedisore, më pak të favorshme, sesa popullata e përgjithshme.

- Mënyra e dytë. Faktorët që i atribuohen pabarazive sociale, (të tilla si njohuritë dhe kujdesi për shëndetin) lidhen me ekspozimin. Në kushte të njëjta mjedisore, grupet e pafavorizuara (në disfavor) mund të jenë më të ekspozuar, se sa popullata e përgjithshme.

- Mënyra e tretë. Faktorët që i atribuohen pabarazive sociale (të tilla si gjendja shëndetësore dhe ndjeshmëria biologjike), influencojnë funksionin ekspozim-reagim. Ndaj të njëjtit ekspozim, grupet e pafavorizuara mund të jenë më të ndjeshme, përsa i përket efekteve

negative shëndetësore krahasuar me popullsinë e përgjithshme. - Mënyra e katërt. Pabarazitë sociale, kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet shëndetësore, të cilat mund të operojnë nëpërmjet mekanizmave të shumtë - disa faktorë mjedisor, disa faktorë jo mjedisor. Megjithatë, duke pasur të njëjtën situatë ekspozim-reagim, grupet e pafavorizuara, mund të jenë gjithashtu më të ndjeshme ndaj efekteve negative shëndetësore, se sa popullata e përgjithshme (p.sh. sigurimi i pamjaftueshëm, përdorimi i ulët i shërbimeve shëndetësore, mungesa e aksesit ndaj shërbimeve, etj). Shumë studime, fokusohen në lidhjen e rreziqeve mjedisore me faktorë të tjerë rreziku, veçanërisht ato me vendin e punës. Sipas tyre, konkludohet se shumë punonjës (individë të punësuar pranë aktiviteteve prodhuese, që rezultojnë se janë burime të ndotjes), nuk mund të kenë asnjë zgjedhje alternative, përveç se të përballen me ekspozimin e vazhdueshëm ndaj rreziqeve mjedisore, gjatë kryerjes së punës. Në rast të kundërt ata duhet të zgjedhin papunësinë, apo punën me pagë më të ulët (ESRC, 2001). Edhe pse duket një zgjedhje individuale, tregon në fakt situatën në të cilën ndodhen vendet më pak të zhvilluara. Studimet mbi cilësinë e ajrit në Britani, Gjermani dhe Skoci, tregojnë se, zonat e varfëra përballen me ajër të ndotur. Po kështu, përsa i përket lokalizimit të impianteve industriale në këto shtete, raporti i OSH tregon se përsëri ka një lidhje të fortë midis nivelit social dhe lokalizimit të tyre, ku rezulton se në lagjet më të varfëra të banuara kryesisht nga emigrantë, këto impiante janë më të shumta (WHO, 2009). Fabrikat ndotëse janë të përqëndruara në zonat me të ardhura të ulëta. Megjithatë, përsa i përket studimit të elementëve sociale në ndërthurje me ata mjedisor, ka të dhëna të pakta për shumë vende, përfshirë edhe ato europiane (WHO, 2009). Edhe pse vendet e varfëra dhe shtresat e pambrojtura do të jenë më të prekurit, nuk mund të thuhet se kufijtë do të mbeten të pakapërcyeshëm, përkundrazi efektet që këta faktorë shkaktajnë kanë filluar të ndjehen edhe në vendet e zhvilluara (thithja e ajrit nuk mund të jetë selektive). Nëse shekuj më parë, pronarët e fabrikave mund të kishin mundësi zgjedhjeje për vendbanimin e tyre larg ndotjes, sot këto mundësi duket të jenë reduktuar ndjeshëm (OECD, 2006). Vendet në zhvillim po përballen edhe me koston ekonomike të produktivitetit të ulët, barrën mbi sektorin e shëndetit, degradimin e burimeve dhe pasojat afatgjata sociale. Përkundrejt këtyre realiteteve, politikëbërësit në vendet në zhvillim përballen edhe me një normë të shpejtë të ndryshimit dhe modernizimit. Ata përballen me vendime kritike të zhvillimit të cilat, kërkojnë një konsideratë të lartë të ndikimit mbi zhvillimin dhe shëndetin (OECD, 2006). Mjedisi urban, ndikon shëndetin përmes mënyrës në të cilën ndihmon apo pengon aksesin ndaj të mirave, shërbimeve dhe mjedisit natyror dhe promovon kohezionin social, mirëqenien fizike dhe mendore. Problemet e ndotjes mjedisore, me të cilat bota po përballlet kohët e fundit, janë

duke u kthyer në një shqetësim real dhe të prekshëm për vendet e zhvilluara, por edhe për ato me ekonomi në zhvillim, duke përbërë një kërcënim jo vetëm për jetën e individëve dhe shëndetin e tyre, por edhe për kostot ekonomike në trajtimin e tyre apo për cilësinë e jetës. Për këtë arsye, zgjidhja apo minimizimi i problemeve tashmë ekzistuese, kërkon pjesëmarrjen e shumë aktorëve në nivel qendror dhe lokal. Duke qënë se problematikat mjedisore janë të ndryshme e niveli i ndikimit tek njerëzit gjithashtu, trajtimi i tyre nuk kërkon thjesht pastrimin e territorit, reduktimin apo eliminimin e ndotjes, por ai duhet parë në nivel politikash shumëplanëshe të lidhura me mjedisin, shëndetin apo politikat sociale.

-Ndërgjegjësimi mbi lidhjen mjedis-shëndet

Ka një rritje të ndërgjegjësimit dhe interesit të publikut, lidhur me problemet mjedisore dhe efektet që kanë ato mbi shëndetin e njeriut. Për këtë arsye, lidhja midis mjedisit dhe shëndetit është intensifikuar dhe përfshirë në politikën, dokumentet dhe agjendën europiane. OBSH lancoi në vitin 1987 programin “Qytetet e shëndetshme”, si një mjet që do të sillte strategjinë e shëndetit për të gjithë në nivelin lokal të qeverisjes. Që prej fillimit ,projekti i qyteteve të shëndetshme njohu faktin, se shëndeti përcaktohet nga një sërë faktorësh që variojnë nga ata personal, social, ekonomik dhe mjedisor. Sipas këtij projekti, i ndjekur nga më shumë se 30 shtete europiane, qeverisja vendore siguron një lidhshmëri esenciale të shëndetit publik dhe gjithashtu impenjohet të krijojë parakushte, për një jetesë të shëndetshme dhe qeverisje pjesëmarrëse, si dhe të krijojë lehtësira për veprimet ndërsektoriale, për të arritur shëndet më të mirë dhe barazi në shëndet. Shëndeti në të gjitha politikat, adreson politika si ato që influencojnë transportin, strehimin dhe zhvillimin urban, mjedisin, edukimin, bujqësinë, financat, taksat dhe zhvillimin ekonomik. Vetë Europa, njihet si lider në promovimin e politikave të forta mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, të cilat mbrojnë shëndetin publik dhe mjedisin. Megjithatë, problemet e lidhura me mjedisin kanë filluar të jenë më shqetësuese edhe për shtetasit europianë, të cilët janë tashmë të shqetësuar rreth ndikimit potencial, që ka mjedisi në shëndetin e tyre. Për këtë arsye, presin që politikëbërësit të reagojnë (Eurobarometri, European Commission, 2005). Sipas Eurobarometrit, 89% e të pyeturve pohuan se ishin të shqetësuar rreth ndikimit potencial, që mjedisi ka mbi shëndetin e tyre dhe se besojnë se institucionet europiane, mund të bëjnë më shumë për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Po sipas këtij studimi, 9 në 10 (88%) qytetarë europianë pohojnë se çështjet mjedisore duhet të konsiderohen kur ndërmerren politika në fushën ekonomike apo atë të punësimit. Ndërsa për 72% të tyre, gjendja e mjedisit influencon në cilësinë e jetës së tyre, po ashtu si faktorët social dhe ekonomik. Si individë ne mund të

zgjedhim stilin e jetës, por nga ana tjetër presim që autoritetet përkatëse të na informojnë vazhdimisht, në mënyrë që të mund të bazojmë vendimet tona, apo të na mbrojnë nga kërcënimet e shëndetit dhe mirëqenies të cilat nuk mund ti kontrollojmë. Të tjera studime, në nivel evropian dhe më gjerë, kanë përmirësuar njohuritë dhe informacionin rreth lidhjeve midis stresorëve mjedisorë dhe shëndetit duke na lejuar marrjen e ndërveprimeve të organizuara, të tilla si eliminimi i plumbit nga karburantet. Studimet ndihmojnë edhe për përcaktimin e njohurive bazë dhe marrjen e masave konkrete, përmes të cilave rezultatet mbi mjedisin dhe shëndetin në Europë, të përfshihen në politikëbërje, për të analizuar dhe evituar hendeqet në aktivitetet që lidhen me këto. Gjatë dekadave të fundit, janë arritur të nënshkruhen shumë marrëveshje dhe konventa në nivel ndërkombëtar, të cilat kanë në fokus shëndetin dhe mbrojtjen e tij. Integrimi i elementit shëndet, në politikat mjedisore është përforcuar edhe nga OBSH (Prüss-Üstün & Corvalán, 2006) përmes procesit të Mjedisit dhe Shëndetit, i cili u formalizua në 1989. Plani i parë i veprimit (2004-2010) ia atribuon një pjesë të mirë të të dhënave, njohjes nga publiku të rolit të rëndësishëm që ka mjedisi në përgjithësi për shëndetin publik (kjo strategji do të shpjegohet në vijim). Po kështu, publikimi i raportit të Komisionit mbi Faktorët Social me Ndikim në Shëndet i OBSH-së në 2008, ishte një pikë thelbësore për rritjen e vëmendjes ndërkombëtare, për çështjet që lidhen me rëndësinë e faktorëve social në gjendjen shëndetësore (WHO, 2008). Kjo gjë ishte e rëndësishme sidomos për politikëbërësit evropian. Pabarazitë në shëndet, përgjithësisht kanë marrë vëmendje nga politika europiane vitet e fundit. Pikërisht, lufta ndaj pabarazive është një nga prioritetet bazë të strategjisë së shëndetit të Komisionit Evropian: “Së bashku për shëndetin: një strategji e Bashkimit Evropian 2008-2013”. Raporti evropian mbi shëndetin 2009 citon, se tregues të gjendjes shëndetësore të tillë si vdekshmëria, vazhdojnë të përmirësohen në Europë, por ka sërish diferenca të mëdha në shëndet midis rajoneve dhe grupeve brenda vendeve, të cilat lidhen me përkeqësimin e disavantazheve sociale, si ato që lidhen me probleme të shëndetit mjedisor, të shkaktuara nga ndotja e ajrit në zonat qendrore apo industriale. Ka një debat të hapur midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Politika mjedisore, mund të konsiderohet nga vendet që luftojnë për të dalë nga gjendja e varfërisë si luks, të cilin nuk mund t’ja lejojnë vetes. Ndërkohë që këto vende, insistojnë në faktin, se prodhimi më i madh i ndotjes vjen nga vendet e zhvilluara (OECD, 2006). Ky konflikt, nxjerr në dritë një realitet. Shumë prej tyre, luftojnë kundër ndotjes mjedisore dhe kërkojnë të gjejnë mënyra specifike trajtimi, për të eliminuar substancat ndotëse që i prodhojnë proceset ekonomike në mënyrë të pashmangshme, apo të bonifikojnë mjedisin nga substancat e lëshuara (WHO, 2009). Lidhur me politikat mjedisore, interesat shtrihen përtej

individëve apo dhe vendeve të veçanta. Ato kontribuojnë, në njohjen e dimensionit ndërkombëtar të problemit të ndotjes. Katastrofat ekologjike që kanë përfshirë shumë vende, (mjaft të kujtojmë shpërthimin nuklear të Cernobil, 1986 apo Fukushima, Japoni 2011), përforcojnë pikërisht globalizimin e fenomenit. Në tridhjetë vitet e ardhshme, rritja më e madhe e popullsisë, do të ndodhë në zonat urbane të vendeve të varfëra (OECD, 2006). Ndryshimi i shpejtë, i paplanifikuar dhe i paqëndrueshëm i zhvillimit urban me të cilin po përballen qytetet në zhvillim, përbëjnë pikat kryesore për përhapjen e rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore. Ajo që karakterizon politikën mjedisore të kohëve të sotme, është ndërgjegjësimi mbi natyrën endemike të problemeve të ndotjes, pasi ato janë pasojë e shumë aktiviteteve që i kanë lejuar vendeve të industrializuara, të rrisin dhe ruajnë nivelin e arritur të mirëqenies materiale. Pamjaftueshmëria e të ardhurave, nevojat lidhur me shëndetin, papunësia dhe shumë probleme të tjera sociale, shumë shpesh janë konsideruar si çështje private të shteteve, ku në fakt në realitet, transferimet dhe rishpërndarja e burimeve publike përmes të cilave kërkohet t'u jepet zgjidhje problemeve, bazohen mbi konsideratat e një natyre të përgjithshme (OECD, 2006). Analizimi i aspekteve kolektive, kombëtare dhe globale që paraqet politika mjedisore, në mënyrë të pashmangshme, mund të na ndihmojnë të zgjerojmë informacionin dhe t'u japim përgjigje pyetjeve mbi politikat sociale.

2.3.6 Ndikimi i kimikateve dhe metaleve në shëndet

Ekspozimi ndaj grimcave, përfshirë metalet, sjell një sërë rezultatesh negative shëndetësore, duke përfshirë edhe raste të ndryshimeve në traktin respirator, dëmtime në funksionin pulmonar, kancer të mushkërive, rritje të rrezikut të simptomave që kërkojnë trajtim spitalor. Grimcat vlerësohet se shkaktojnë rreth 8% të vdekjeve të kancerit të mushkërive, 5% të vdekjeve nga sëmundjet kardiale dhe rreth 3% të vdekjeve nga infeksionet respiratore (WHO, 2009). Në vitin 2004, ndotja e ajrit në zonat urbane ishte shkaktare për vdekjen e 1.2 milion vetëve (2% e të gjithë vdekjeve) (WHO, 2004). Ndotja e ajrit e lidhur me transportin, i cili është dhe një prej kontribuesve kryesor të ndotjes urbane, çon në rritjen e rrezikut të vdekjeve, që lidhen me problemet kardiopulmonare, si dhe të sëmundjeve të mushkërive me natyrë joalergjike. Disa të dhëna mbështesin lidhjen midis ndotjes së shkaktuar nga transporti dhe rritjen e rrezikut të kancerit të mushkrive, infarktit e miokardit, probleme me frymëmarrjen apo dhe probleme të shtatëzanisë (Krzyzanowski, 2005). Ekspozimi

afatshkurtër ndaj dioksidit të nitrogjenit (nitrogen dioxide), çon në probleme të funksionimit pulmonar, rritje të alergjisë nga reagentë ajror, shtrime në spitale dhe vdekshmëri. Reduktimi i funksionimit të mushkërive dhe rritja e probabilitetit të simptomave respiratore, janë të lidhura me ekspozimin afatgjatë ndaj këtij kimikati (ëHO, 2004). Plumbi klasifikohet si një element toksik kronik ose akumulues, efektet e menjëhershme të të cilit vihen re menjëherë, pas ekspozimit afatshkurtër ndaj përqendrimeve të larta. Plumbi në organizmin e njeriut përqendrohet në tru, mëlçi, veshka dhe kocka. Ai ruhet në dhëmbë dhe kocka dhe mbetet aty për shumë kohë. Prania e tij në organizmin human mund të vlerësohet përmes analizave të gjakut, analizave të kockave dhe dhëmbëve. Është vlerësuar se, ekspozimi ndaj plumbit (në 2004) ishte përgjegjës për vdekjen e 143.000 vetëve dhe për 0.6 % të nivelit global të sëmundshmërisë duke konsideruar vonesat e lehta mendore dhe problemet kardiovaskulare që rezultojnë nga ekspozimi. Sipas raportit të OBSH-së (World Health Report, 2006), në mënyrë të veçantë duhet të konsiderohen faktorët mjedisor “të modifikueshëm”, të përshtatshëm për të ndryshuar duke përdorur teknologjitë ekzistuese, politika si edhe masa parandaluese të shëndetit publik. Këta faktorë përfshijnë rrezikun fizik, kimik dhe biologjik që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë shëndetin dhe shton sjelljet jo të shëndetshme, të tilla si pasiviteti fizik. Në sëmundjet me barrën më të madhe, që i atribuohet faktorëve mjedisor “të modifikueshëm” janë dhe infeksionet e rrugëve të frymëmarrjes. Këto shkaktohen kryesisht nga ndotja e brendshme dhe e jashtme e ajrit. Në vendet në zhvillim vlerësohet se 42% e këtyre infeksioneve i referohen shkaktarëve mjedisor, ndërsa në vendet e zhvilluara 20% (World Health Report, 2006). Sa domethënës është ndikimi i mjedisit në shëndet? Sipas statistikave të OBSH-së është konkluduar se 24% e sëmundjeve në shkallë globale dhe 23% e numrit total të vdekjeve (vdekje e parakohshme), i atribuohen faktorëve mjedisor. Tek fëmijët 0-14 vjeç, përqindja e vdekjeve, referuar mjedisit është rreth 36%. Megjithatë ka një diferencë të ndjeshme në kontributin e mjedisit tek sëmundjet në rajone të ndryshme, kjo për shkak të shkallës së ekspozimit ndaj mjedisit, apo aksesit në sistemin shëndetësor. Në shumë raste është komplekse lidhja shkaktare, midis rrezikut mjedisor dhe sëmundjes. Për shembull, barra e sëmundjeve të lidhura me ndryshimin, dëmtimin apo varfërimin e ekosistemeve në përgjithësi është e pamatshme. Përpjekjet për të reduktuar ndjeshëm përqendrimet e ndotësve të ajrit gjithashtu do të ndihmojnë për të ulur emetimet e gazit dhe për të zbutur efektet e ngrohjes globale (WHO, 2008). Siç shihet, çështjet mjedisore janë një shqetësim i përbashkët dhe në rritje kudo, sidomos në Europë dhe vendet e zhvilluara. Çështja e kontrollit mjedisor, duhet të konsiderohet një çështje që duhet të përballohet përmes politikave publike. Shembuj të tyre mund të përmenden “Akti i Ajrit të Pastër” (SHBA dhe Kanada) apo “Ajër i pastër për

Europën”, ku secili prej tyre vendos standarde për cilësinë e ajrit. Këto dokumente strategjike, vendosin përcaktime në një sërë legjislacioneesh të lidhura specifikisht, me fushën siç janë ato që kanë të bëjnë me energjinë, transportin, industrinë, strehimin. Në vendet OECD, ndërhyrja përmes politikave në çështjet që lidhen me ndotjen e ajrit është rritur ndjeshëm veçanërisht 10-15 vitet e fundit. Për fat të keq, në vendet jo pjesëmarrëse të OECD, ka më pak shembuj të programeve të tilla, lidhur me kontrollin e ajrit dhe ndotjen e tij (përfshirë edhe vendin tonë). Mund të thuhet, se ajo që ka kontribuar në përfshirjen e politikave mjedisore në agjendat e politikave sociale, është pikërisht ndërgjegjësimi i elitës (pjesa e popullsisë që posedon pushtetin financiar dhe social) mbi vështirësitë e mëdha që kufizojnë efikasitetin e përpjekjeve të tyre për t’iu larguar ndotjes (OECD, 2006). Për këtë arsye, një kuptueshmëri më e madhe e shkallës së ndikimit në sëmundshmëri të faktorëve mjedisor, mund ti ndihmojë politikëbërësit në hartimin e masave parandaluese lidhur me shëndetin, të cilat jo vetëm do të reduktonin sëmundjet, por gjithashtu do të ulnin kostot e sistemit shëndetësor (OECD, 2006).

Ekziston një numër i lartë kimikatesh dhe metalesh si plumbi, arseniku, asbesti, benzeni, kadmiumi apo mërkuri (por jo vetëm këta) ,që shkaktojnë një sërë sëmundjesh që lidhen me kancerin, zhvillimin neurologjik, disfunktionin e veshkave apo komplikacione të tjera, në rast të ekspozimit ndaj tyre. Për një kuptueshmëri më të qartë të kontaktit, përbërjes dhe kujdesit që duhet të tregojmë ndaj tyre, në vijim prezantohen secili prej këtyre elementëve të rrezikshëm.

Plumbi është një metal toksik, i cili për shkak të përdorimit të gjerë, ka sjell probleme të mëdha mjedisore dhe shëndetësore në shumë rajone të botës (WHO, 2010). Plumbi është një element rezistent dhe i qëndrueshëm në mjedis (IPCS, 1995), për këtë arsye falë lëvizjeve atmosferike globale, lëshimet në atmosferë prekin edhe vendet me të largëta të botës (WHO, 2007). Ekspozimi akut çon në shqetësime të gastritit (anoreksi, të vjella, përzierje, dhimbje abdominale), dëmtim të hepatitit dhe të veshkave, hipertension dhe efekte neurologjike (rraskapitje, përgjumje, encefalopati) (IPCS, 1995). Efekte të ndjeshme në koeficientin e inteligjencës (IQ), priten nga niveli i plumbit në gjak, të paktën më pak se 5 µg/dl (50 µg/l) dhe efektet rriten gradualisht me rritjen e nivelit të plumbit në gjak (Feätrell, Kaufmann, Prüss-Üstün, 2003). Ndërsa, përsa i përket ekspozimit kronik, ai shkakton efekte hematologjike si anemia, shqetësime neurologjike, dhimbje koke, irritim, letargji, konvulsione, dhimbje muskujsh, ataksi, dridhje dhe paraliza (WHO, 2010). Përsa i përket prekjës së dy grupeve vulnerabël siç janë gratë dhe fëmijët 4 , raportohet se, fëmijët e vegjël

thithin rreth 4-5 herë më shumë plumb se të rriturit (WHO, 2007). Ekspozimi i grave shtatzëna ndaj niveleve të larta të plumbit mund të shkaktojë tek ato abort, lindjen e fëmijës së vdekur, lindje të parakohshme dhe në peshë të ulët apo keqformime të tjera (ICPS, 1995). Tek meshkujt vihen re probleme të riprodhimit, që lidhen me dëmtimin e spermës apo rritjen e sasisë së spermës anormale. Zonat e nxehta industriale, që nuk janë pastruar ende, paraqesin rrezik veçanërisht për fëmijët, të cilët mund të gëlltisnin dhë apo pluhur si rezultat i futjes së duarve në gojë (WHO, 2010). Studimi i Reyes në vitin 2007 tregon se ekspozimi i fëmijëve ndaj plumbit, mund të rris tendencat për sjelljet violente dhe kriminale me rritjen e tyre. Sipas studimit konkludohet se Akti i Ajrit të Pastër, si një rregullore mjedisore e përdorur në SHBA, solli përfitime të mëdha sociale (Reyes, 2007). Për këto arsye, po bëhen përpjekje të vazhdueshme për reduktimin dhe përhapjen e këtij elementi si dhe kontaktet me të. Duke qënë se ai akumulohet në organizëm dhe prek një pjesë të mirë të sistemeve jetike si atë neurologjik, hematologjik, gastrointestinal, kardiovaskular dhe atë renal, klasifikohet si një ndër elementët më të rrezikshëm për shëndetin e njeriut (WHO 2010).

Uji i pijshëm, mund të jetë një tjetër element konsumi me përqindje akumulimi të plumbit, si rezultat i përdorimit të tubacioneve apo pajisjeve të tjera që përdoren për të (WHO 2003). Drithërat, gjithashtu mund të përmbajnë nivele të larta të plumbit. Përdorimi i ushqimeve të paketuara apo i kanaçeve të pijeve, mund të çojë në rritjen e përmbajtjes së plumbit në ushqime apo pije. Burime të tjera ndotjeje me plumb, mund të lidhen me përdorimin e lëndëve djegëse me përmbajtje plumbi, për një kohë të gjatë. Kjo gjë është e vështirë duke konsideruar, se përdorimi i tij është shumë i larmishëm, ku më kryesoret mund të jenë fonderitë e shkrirjes, minierat, industria e rafinimit, prodhimi i baterive apo riciklimi i tyre, industrinë e bojrave, tubacionet e ndryshme apo edhe pajisjet elektronike e si rezultat edhe mbetjet e tyre (UNEP 2008), etj. Me një përdorim kaq të gjerë edhe kontaktet me këtë lloj elementi toksik, jo gjithmonë janë të evitueshme apo të kontrollueshme.

Arseniku inorganik i tretshëm është mjaft toksik. Efektet mund të kërkojnë vite të zhvillohen, në varësi të nivelit të ekspozimit, duke përfshirë probleme me lëkurën, neuropati periferike, simptoma gastrointestinale, diabet, probleme me funksionimin e veshkave, sëmundje të zemrës apo kancer. Ekspozimi human, ndaj niveleve të larta të arsenikut inorganik, ndodh kryesisht për shkak të konsumimit të ujit, që e përmban apo të përgatitjes së ushqimeve me këtë ujë të ndotur (WHO 2010).

Asbesti, është një tjetër kimikat i rrezikshëm, që shkakton kancer të mëlçisë, kancer të laringut dhe asbestosis (fibrozë e mëlçisë). Ekspozimi ndaj asbestit, ndodh përmes thithjes së

fibrave në ajër në mjediset e punës, përreth fabrikave që punojnë me këtë lëndë, apo përmes materialeve të ndërtimit të përdorur në banesa. Eliminimi i sëmundjeve të lidhura me të duhet të përfshihet në iniciativat publike të shëndetit, diagnostikimin e hershëm, trajtimin, rehabilitimin social dhe mjeksor, duke përpiluar regjistrin e njerëzve që kanë qenë ekspozuar apo janë tani të ekspozuar ndaj asbestit (WHO, 2010).

Benzeni shkakton tek njerëzit, një sërë shqetësimesh në shëndet, ku më tipikët janë kanceri dhe anemia. Ekspozimi mund të ndodhë gjatë proceseve të punës, apo në shtëpi si dhe gjatë përdorimit të benzenit, që gjendet në produktet e naftës apo solventët. Ndërhyrjet në reduktimin e ekspozimit të popullsisë, si në vendet e punës dhe jashtë saj, përfshijnë promovimin e solventëve të tjerë, të prodhuar përmes proceseve industriale, duke zhvilluar dhe implementuar politika dhe ligje, për heqjen e tij nga produktet e konsumit, duke përpiluar kode të ndërtimit të objekteve dhe godinave (WHO, 2010).

Kadmiumi shkakton efekte toksike në veshka, sistemin skeletor dhe respirator dhe klasifikohet si lëndë kancerogjene. Kontakti me të ndodh për shkak të konsumimit të ushqimeve të ndotura, përmes thithjes pasive dhe aktive të duhanit, apo thithjes gjatë procesit të punës në industri. Përpjekjet për uljen e tij në nivele globale përfshijnë, minimizimin e emetimeve dhe të aktiviteteve që e prodhojnë si minierat apo menaxhimi i mbetjeve, sigurimi i kushteve të punës (WHO, 2010).

Mërkuri është lëndë toksike për shëndetin e njeriut dhe përbën një rrezik për zhvillimin e fëmijëve, gjatë zhvillimit embrional, por edhe në vitet e para të jetës.

2.4 Një vështrim i përgjithshëm mbi legjislacionin europian dhe legjislacioni shqiptar për çështjet mjedisore

E drejta për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, është një e drejtë e natyrshme dhe themelore e çdo shoqërie. Ndërgjegjësimi mbi lidhjen mjedis-shëndet, ka ardhur në rritje në shoqërinë shqiptare. Që prej vitit 1970, Europa i është përkushtuar mbrojtjes së cilësisë së ajrit dhe ujit, ruajtjes së burimeve dhe biodiversitetit, menaxhimit të kontrolluar mbetjet . Një nga objektivat kryesor të legjislacionit mjedisor europian është përmirësimi i cilësisë së ajrit, ndotja e të cilit sjell dëme të pariparueshme veçanërisht tek shëndeti i njerëzve, madje ka studime që mbështesin tezën se një mjedis me komponentë ndotës sjell rritjen e manifestimit të sjelljeve agresive tek fëmijët (European Environment Agency , 1999). Legjislacioni europian bën të qartë mënyrën e vlerësimit dhe monitorimit, përcakton pragun dhe nivelin e

ndotjes dhe mbi të gjitha, përcakton si të domosdoshme, ndërhyrjen përmes planeve të caktuara kur rrezikohet shëndeti I individëve . Shtetet detyrohen që në rast të tejkalimit të nivelit të ndotjes, ato duhet të procedojnë menjëherë në minimizimin e rrezikut, dhe procedimi realizohet përmes ndërhyrjes imediate. Në përgjithësi kjo ndërhyrje lidhet me ndërprerjen e veprimtarisë. Më tej këto veprime mund të përfshijnë masa specifike që synojnë mbrojtjen e grupeve sensitive dhe në mënyrë të veçantë të fëmijëve. Ndër të tjera, rëndësi të madhe ka informacioni që duhet të përqëndrohet në pjesën e popullsisë që preket, efektet e mundshme në shëndet dhe sjellja apo veprimet që rekomandohen. Bashkimi European në ndryshim nga politikat sociale dhe mjedisore të vendit tonë përcakton një strategji të Komunitetit për të integruar çështjet mjedisore në politikat ekonomike duke përdorur instrumente të ndryshëm si mekanizmat e tregut, raportet vjetore të Shteteve Anëtare dhe Udhëzimet Politike të Zgjerimit të Ekonomisë. Në kuadër të kësaj strategjie, duhet që masat për të integruar politikat ekonomike dhe ato mjedisore në mënyrë domethënëse të reduktojnë ndotjen dhe përmirësojnë funksionimin e ekonomisë. Akti paraqet një sërë zgjidhjesh, për të përmirësuar funksionimin e produkteve mjedisore në treg, të tilla si: fiksimi i çmimeve (në formë takse apo pagese) për ndotjen, vendosja e një skeme fond – depozitë për të inkurajuar riciklimin, ofrimi i subvencionimeve për të mirat dhe shërbimet që gjenerojnë efekte pozitive mjedisore, negociimi me industrinë, etj. (COM 2000/ 576). Një tjetër akt i Bashkimit European “Një Europë e qëndrueshme për një botë më të mirë: strategji për zhvillimin e qëndrueshëm, mbështetet në katër shtylla të veçanta – ekonomike, sociale, mjedisore dhe qeverisja globale, të cilat duhet të përforcojnë njëra-tjetrën. Pasojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të të gjitha politikave, duhet të analizohen në mënyrë të koordinuar dhe të konsiderojnë adoptimin dhe zbatimin e tyre.

Analizimi i legjislacionit shqiptar, lidhet në mënyrë direkte me faktin se sa ligjet e mjedisit në vendin tonë marrin në konsideratë dhe parashikojnë problemet sociale, që shkaktohen nga ndotja dhe degradimi mjedisor. Një problem sikurse është manifestimi I sjelljeve agresive nga adoleshentët, që trajton ky studimi. Për të vlerësuar nevojat dhe kërkesat e komuniteteve lidhur me mbështetjen sociale, shëndetësore, etj., është i rëndësishëm edhe shqyrtimi i legjislacionit mjedisor në fuqi 13. Kuadri ligjor, që trajton çështjet mjedisore është pasuruar mjaft sidomos pas vitit 2000 e deri më sot, duke I ndryshuar politikat socio-mjedisore . Por në këndvështrimin social dhe njerëzor, ky kuadër ligjor mbetet ende shumë pak i zhvilluar praktikisht . Pavarësisht hartimit të shumë ligjeve dhe strategjive që përpiqen të mbajnë në kontroll fenomenet degraduese, të mbrojnë dhe kujdesen për të si dhe të promovojnë politika

për zhvillimin e mëtejshëm të mjedisit, apo përpjekjeve për të intensifikuar veprimet në mbrojtje të mjedisit, përmes nënshkrimit dhe ratifikimit të shumë konventave, apo përmes përpilimit të strategjive e planeve të veprimit, përsëri mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim (MMPAU, 2005). Të gjitha veprimtaritë që ndikojnë në mjedis, duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procesit të marrjes së lejes mjedisore. Referuar Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", vihen re tre momente shumë të rëndësishme për t'u konsideruar në këtë studim. Momenti i parë lidhet me përcaktimin që i bëhet termit ndotje. Sipas këtij ligji "Ndotja është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit".

Momenti i dytë lidhet me përcaktimet që paraqiten në Nenin 14, "Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit", ku në bazë të tij përcaktohet se autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre: a) nxitin veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit, që parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e tij, si dhe projekte, që ulin përdorimin e substancave të caktuara, të lëndëve të para e të energjisë, apo që e ndotin më pak mjedisin; b) mund të lidhin marrëveshje me subjektet ndotëse dhe shoqatat e tyre, për masat vullnetare që ato mund të ndërmarrin, me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit në mjedis. Momenti i tretë lidhet me përcaktimet në Nenin 50 "Përgjegjësia për dëmin në mjedis", ku përcaktohet se "Qëllimi i përgjegjësisë për dëmin në mjedis, mbështetur në parimin "Ndotësi paguan", është parandalimi dhe zhdëmtimi i të gjithë dëmit, që i shkaktohet mjedisit prezantimi i masave dhe i praktikave për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të mjedisit. Po në këtë nen përcaktohet se operatori, që kryen veprimtaritë e parashikuara në shkronjën "a" të pikës 3 të këtij neni, i cili ka shkaktuar një dëm, apo paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për dëme në mjedis, është përgjegjës për këtë dëm. Ndërsa, bazuar në Konventën e Aarhus, çdo individ apo organizatë ka të drejtë të informohet, pa dhënë arsytë përkatëse, për çështjet që lidhen me mjedisin, përbërësit e tij, masat dhe mënyrën e administrimit të mjedisit nga organet kompetente, ligjet, plane e projektet mjedisore, shkarkimet në mjedis dhe çdo aspekt tjetër informues që nuk ndalohet me ligj (Aarhus, 1998). Zyrtarët dhe autoritetet ndihmojnë dhe udhëheqin publikun, kur kërkojnë të informohen për mjedisin, kur kërkojnë lehtësimin e pjesëmarrjes në marrjen e vendimeve mjedisore dhe kur kërkojnë t'i drejtohen gjykatës për çështjet e mjedisit.

KAPITULLI III: METODOLOGJIA

Në këtë kapitull, është pasqyruar mënyra se si është realizuar studimi, me të gjithë elementët e tij dhe me mënyrën e kombinimit të tyre, për të përftuar rezultatet e duhura. Këtu tregohet metoda kërkimore, që është përdorur për realizimin e studimit dhe shpjegohet përshtatshmëria e kësaj metode me temën kërkimore.

Në këtë kapitull është paraqitur plani i studimit; mënyra e marrjes së informacionit të nevojshëm; është përshkruar metoda e mbledhjes së të dhënave; janë paraqitur problemet që kanë dalë në këtë fazë; janë përshkruar procedurat dhe instrumentet e përdorur; kriteret e përzgjedhjes së pjesëmarrësve në studim; procedurat e përdorura për të siguruar besueshmërinë e rezultateve dhe kufizimet e metodologjisë së përdorur.

Në këtë studim është përdorur metoda sasiore e kërkimit. Zgjedhja e metodës, është bërë në varësi të çështjeve dhe pyetjeve të kërkimit dhe në bazë të mënyrës ,se si janë përkufizuar konceptet dhe se si është bërë përcaktimi i variablave.

3.1 Kampioni dhe kampionimi

Për realizimin e këtij studimi ,përzgjedhëm qasjen e kampionimit të qëllimshëm. Kjo qasje ,lidhet me studime të thelluara në shkallë të vogël ,ku modelet e hulumtimit fokusohen në eksplorimin dhe interpretimin e përvojave dhe perceptimeve (MattheWs,B; Ross, L 2010). Në këtë qasje kampionimi, synimi nuk është që të krijohet një kampion që të jetë statistikisht përfaqësues i një popullate, dhe i japin mundësi hulumtuesit që të eksplorojnë pyetjet e hulumtimit. Subjektet e marra në studim ,janë ato që mund të zbulojnë dhe të hedhin sa më shumë dritë mbi fushën e studimit (Richie and Lewis, 2003). Qëllimet e përzgjedhjes së kampionit të studimit tonë ishin:

- 1) Individët të jenë të grupomoshës 12-15 vjeç dhe të frekuentojnë arsimin 9- vjeçar dhe kryesisht të jenë banues në zona industriale Bradashesh, Vidhas, Letan dhe Katund i Ri (grupi i parë i marrë në studim)

2) Individët të jenë të grupomoshës 12-15 vjeç dhe të frekuentojnë arsimin 9 -vjeçar dhe kryesisht të jenë banues në zona larg zonave industriale, por që të bëjnë pjesë në qarkun Elbasan si Sericë, Labinot Fushë, Labinot Mal, Shpat dhe Xibrakë.

Kampioni i përzgjedhur për këtë studim, përbëhet nga 600 adoleshentë të moshës 12-15 vjeç, nxënës të shkollave publike, kampion ky i ndarë në dy kategori/grupe duke u mbështetur në bazë të vendbanimit (zonë industriale përkundrejt zonës jo-industriale):

Grupi i parë përbëhëj nga 300 adoleshentë të grupmoshës 12-15 vjeç, banues në zona industriale. Këtu nxënësit i përkasin të shkollave 9- vjeçare publike: “A.Lleshanaku”; shkolla 9 vjeçare “Europa” në Katund të Ri; shkolla 9 -vjeçare “Jorgji Dilo”; shkolla 9 vjeçare “Kozan”; shkolla 9 vjeçare “Petresh” në zonat industriale Bradashesh, Vidhas, Katund i Ri dhe Letan.

Grupi i dytë , përbëhëj nga 300 adoleshentë të grupmoshës 12-15 vjeç, banues në zona joindustriale. Këtu nxënësit i përkasin shkollave 9 vjeçare publike: shkolla 9 -vjeçare në Labinot Fushë; shkolla 9 vjeçare në Labinot Mal; shkolla 9- vjeçare “Zenel Leci” në Sericë; shkolla 9 vjeçare në Shpat dhe shkolla 9 vjeçare në Xibrak ” dhe banues në Labinot Fushë, Labinot Mal, Shpati, Sericë dhe Xibrakë, zona këto jo-industriale sipas vlerësimit nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit .

Strategjia e përzgjedhjes së kampionit në këtë studim ka qenë e qëllimshme. U përzgjodhën 300 nxënës nga Labinot Fushë, Labinot Mal, Sericë, Xibrakë dhe Shpati, pasi këto zona nuk janë industriale dhe shquhen për një klimë të mirë dhe të shëndetshme, larg ndotjes industriale. Si dhe u përzgjodhën dhe 300 nxënës banues në zonat Bradashesh, Vidhas , Katund i Ri dhe Letan pasi në këto zona ndodhen dhe objektet industriale duke filluar që nga Kurum International i cili ka Fabrike Gelqereje, Uzina e Çelikut, Linja e Skrapit dhe Uzina e Petezimit, Fabrika “Darfo” e Ferrokromit; Fabrika e tullave; Fabrika e Përpunimit të Plerave.

Kampioni i studimit tonë, në raport me popullatën, konsiston në faktin se shifra prej 600 adoleshentësh nuk përfaqëson të gjithë popullatën në zona industriale dhe joindustriale, por vetëm një pjesë të saj, pasi ka adoleshentë të kësaj grupmoshe, që mund të frekuentojnë shkollat jopublike, ka dhe të tjerë që mund të mos shkojnë në shkollë.

Tabela 1. Shpërndarja e gjinisë në frekuenca dhe përqindje për nxënësit që banojnë në zona industriale

Gjinia	Frekuenca	Përqindja
Femra	159	54.4
Meshkuj	141	45.6
Total	300	100.0%

Nga tabela e statistikave totale e mësipërme, vëmë re se kampioni ynë për grupin e nxënësve që jetojnë në zonat industriale Bradashesh, Vidhas , Katund I Ri dhe Letan përbëhet nga 159 femra që përbëjnë 54.4 % të kampionit dhe 141 meshkuj që përbëjnë 45.6 % të kampionit për këtë grup.

Tabela 2. Shpërndarja e gjinisë në frekuenca dhe përqindjes për nxënësit që banojnë në zona joindustriale

Gjinia	Frekuenca	Përqindja
Femra	167	55.6%
Meshkuj	133	44.4
Total	300	100.0%

Nga tabela e statistikave totale e mësipërme, vëmë re se kampioni ynë i grupit të nxënësve që jetojnë në Labinot Fushë, Labinot Mal, Sericë, Shpat dhe Xibrakë zona larg industrisë , përbëhet nga 167 femra, që përbëjnë 55.6 % të kampionit dhe 133 meshkuj ,që përbëjnë 44.4 % të kampionit për këtë grup.

Tabela 3. Rezultatet statistikore totale për adoleshentët banues në zona industriale .

Grupmosha	Frekuenca	Përqindja
12-13 vjeç	148	49.3%
14-15 vjeç	152	50.7%
Total	300	100.0%

Nga tabela e statistikave totale e mësipërme, vëmë re se 49.3 % e kampionit tonë janë subjekte të grupmoshës 12-13 vjeç dhe 50.7 %, të grupmoshës 14-15 vjeç banues në zonat industriale Bradashesh, Vidhas , Katund I Ri dhe Letan.

Tabela . 4 Rezultatet statistikore totale për adoleshentët banues në zona joindustriale .

Grupmosha	Frekuenca	Përqindja
12-13 vjeç	151	50.3%
14-15 vjeç	149	49.7%
Total	300	100.0%

Nga tabela e statistikave totale e mësipërme, vëmë re se 50.3 % e kampionit të marre në studim, janë individë të grupmoshës 12-13 vjeç dhe 49.7 % të grupmoshës 14-15 vjeç ,banues në zonat joindustriale si Labinot Fushë, Labinot Mal, Shpat, Sericë dhe Xibrakë .

Në këtë studim, u përfshinë nxënës nga 10 shkolla publike 9 vjeçare: Shkolla 9 vjeçare “A.Lleshanaku”; Shkolla 9 vjeçare “Europa” në Katund të Ri; Shkolla 9 vjeçare “Jorgji Dilo”; Shkolla 9 vjeçare “Kozan”; Shkolla 9 vjeçare “Petresh” (shkolla këto që frekuentoheshin nga 300 nxënës të grupmoshës 12-15 vjec banues në zonat industriale Elbasan) Shkolla 9 vjecare në Labinot Fushë; Shkolla 9 vjecare në Labinot Mal; Shkolla 9 vjecare “Zenel Leci” në Sericë; Shkolla 9 vjecare në Shpat dhe Shkolla 9 vjecare në Xibrakë ” (shkolla këto që frekuentoheshin nga 300 nxënës të grupmoshës 12-15 vjec banues në këto zona joindustriale). Individët të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme për secilin grup, sikurse është përmendur mësipër, fillimisht u informuan për studimin dhe pasi pranuan pjesëmarrjen në parim, u informuan në mënyrë të detajuar në lidhje me qëllimin, kushtet dhe metodën e studimit, që do të përdorej si dhe ku konsistonte ndihma e tyre. Pjesëmarrësve që në fillim, i është bërë e qartë natyra vullnetare e pjesëmarrjes në studim dhe se mund të tërhiqeshin nga studimi, nëse nuk kishin dëshirë të merrnin pjesë në të, pa administruar ende instrumentat me ta. Nuk kishte asnjë rast, që nuk pranoi të ishte pjesë e studimit.

3.2 Instrumentat matës të studimit

Në funksion të mbledhjes së të dhënave, sipas pyetjeve kërkimore të këtij studimi, u aplikuan instrumentet e kërkimit si më poshtë. Në këtë studim për mbledhjen e të dhënave u analizuan dy komponentë ;ai mjedisor familjar dhe ekologjik ,duke u bazuar në Modelin Bioelogjik të Bronfenbrenner (Bronfenbrenner & Morris, 2006), sipas të cilit zhvillimi njerëzor ndikohet nga faktorë familjar dhe ekologjik.

Instrumentat e aplikuar me kampionin e përzgjedhur ishin: 1) Shkalla e mjedisit familjar (Family Environment Scale: Short Version, Moos, R. H., & Moos, B. S) dhe 2)Pyetësori i Agresionit (Buss Perry Aggression Questionnaire)

3.2.1 Hartimi i pyetësorëve dhe përmbajtja e tyre

Instrumenti i parë : Shkalla e mjedisit familjar (Family Environment Scale: Short Version, Moos, R. H., & Moos, B. S)

Shkalla e Mjedisit Familjar është krijuar në vitin 1974 nga Rudolf H.Moos dhe ka për qëllim të vlerësojë karakteristika të përgjithshme të mjedisit familjar (Moos, R. & Moos, B.1994).

Shkalla e mjedisit familjar është një instrument i përdorur gjërësisht në mjediset klinike kryesisht në Psikoterapi , Terapi familjare. FES është i përbërë nga dhjetë subscale/nënshkallë matëse të tre dimensioneve themelore të mjedisit familjar :

-Marrëdhënia familjare

-Rritja personale

-Përkujdesi për familjen si sistem i shëndetshëm

Këto tre subshkallë, përcaktojnë shkallën e angazhimit dhe të mbështetjes së anëtarëve të familjes me njëri-tjetrin, inkurajimin e tyre, për të shprehur ndjenjat dhe konfliktet mes tyre.Në këtë studim është përdorur forma e shkurtuar e Shkallës së Mjedisit familjar e cila përbëhet nga 27 pyetje, që kërkojnë përgjigje përmes opsioneve: E vërtetë (Tru) / E gabuar (False) që pikëzohen me 0 dhe 1. Kjo formë mat pyetje nga tre nënshkallë (kohezioni , ekspresivitetin dhe konfliktin në mjedisin familjar.Kohezioni konsiston në shkallën e angazhimit, për të ndihmuar dhe mbështetur anëtarët e familjes. Ekspresiviteti konsiston në

lirshmërinë e shprehjeve të ndjenjave dhe mendimeve në mjedisin familjar dhe konfliktet konsistojnë në shprehjen e zemërimit dhe debateve mes anëtarëve. Secila nga tre nënshkallët, përmban nga nëntë pohime./pyetje. Rezultatet e këtij instrumenti, na japin një tablo mbi marrëdhënien në mjedisin familjar, përsa i përket bashkëpunimit, mbështetjes dhe një klime të qetë, apo jo në familje. Kjo formë e shkurtuar e instrumentit, është e përshtatshme të përdoret për individët e moshës mbi 11 vjeç. Shkalla e mjedisit familjar ,është përkthyer në disa gjuhë të ndryshme si: Anglisht, Arabisht, Gjermansisht, Greqisht, Frengjisht.Italisht, Portugalisht, Suedisht, Spanjisht etj. Është instrument vetëraportues. Koha e administrimit të këtij instrumenti është 15 minuta .

Si instrument, është përdorur për herë të parë në vlerësimin e familjes si sitem I shëndetshëm në Terapi familjare (Minuchin 1974, Satir 1967). Sipas Moos (1974), në mosfunksionimin e familjes ,si system i shëndetshëm ,ndikon edhe mjedisi ekologjik. James and Hesselbrock (1976) e administruan FES, në 24 fëmijë me prindër skizofrenë dhe në 26 fëmijë me prindër të shëndetshëm. Scoresby and Christensen (1976) e administroi FES, në 31 familje që merrnin shërbimin e këshillimit . Rosenthal (1975) e përdori FES për vlerësimin e prindërve ,që kishin marrëdhënie problematike në familje Në 1976 Eetzal, testoi hipotezën, që një individ është I predispozuar për tu bërë depresiv ,nëse nuk ka mbështetje në mjedisin familjar. Bader (1976) e trajtoi në një workshop për Terapinë familjare , shkallën e mjedisit familjar, si një ndër instrumentat primarë në vlerësimin klinik.Shkalla e mjedisit familjar, është përdorur në shumë studime ku përmend:

- Barajas-Gonzalez, R. Gabriela, Brooks-Gunn, Jeanne (2014). Income, neighborhood stressors, and harsh parenting: Test of moderation by ethnicity, age, and gender. Journal of Family Psychology.
- Barajas-Gonzalez, R. Gabriela, Brooks-Gunn, Jeanne (2014). Substance use differences among U.S.- versus foreign-born adolescents: Testing pathways through family and peer influences. Hispanic Journal of Behavioral Sciences.
- Wareham, Jennifer, Boots, Denise P(2012). The link between mental health problems and youth violence in adolescence: A multilevel test of DSM-oriented problems. Criminal Justice and Behavior.
- Edwards, Renee Clare(2011) . The Role of Infant Temperament, Family Processes, and Ethnicity in the Development of Early Childhood Internalizing Behaviors. Dissertation, University of Chicago.

- Skeer, Margie R., McCormick, Marie C., Normand, Sharon-Lise T., Mimiaga, Matthew J., Buka, Stephen L., Gilman, Stephen E (2011). Gender differences in the association between family conflict and adolescent substance use disorders. *Journal of Adolescent Health*.
- Gibson, Chris L., Sullivan, Christopher J., Jones, Shayne, Piquero, Alex R (2010). 'Does it take a village?' Assessing neighborhood influences on children's self-control. *Journal of Research in Crime and Delinquency*.
- Ozdemir, Metin (2009). Predictors and Outcomes of Adolescent Self-Efficacy Beliefs: An Analysis of Individual, Peer, Family, and Neighborhood Level Variables. Dissertation, University of Maryland, Baltimore County.
- Zimmerman, Gregory M (2009). Impulsivity, Offending, and the Neighborhood: Investigating the Person-Context Nexus. Dissertation, State University of New York, Albany.
- Wodarski, John, Mapson, Andridia V.(2008). A differential analysis of criminal behavior among African-American and Caucasian female juvenile delinquents. *Journal of Human Behavior in the Social Environment*.
- Counts, J., Buffington, J., Chang-Rios, K., Rasmussen, H., & Preacher, K. (2010). The development and validation of the protective factors survey: A self-report measure of protective factors against child maltreatment. *Child Abuse and Neglect*.
- Galea, M. (2010). Does child maltreatment mediate family environment and psychological well-being? *Psychology*, 1, 143-150.

Pikëzimi:

Sa më i lartë numri i pikëve, aq më disfunktionale është familja (Friese & Davenport , 2005)

- Marrëdhënie disfunktionale në nivel të ulët < 10 pikë
- Marrëdhënie disfunktionale në nivel mesatar 11 pikë -19 pikë
- Marrëdhënie disfunktionale në nivel të lartë 20-27 pikë

Ky instrument ,u gjet online në gjuhën angleze në formën e sample. Ky instrument ,nuk është përdorur asnjëherë në gjuhën shqipe.

Ndaj në këtë studim shkencor së pari, është përkthyer në gjuhën shqipe nga ku u përpoqa maksimalisht të kryej përshtatjen konceptuale e tij. Në pyetjet që është hasur vështirësi për t'u kuptuar në shqip gjatë përkthimeve, ato pyetje janë përshtatur. Më pas është zhvilluar një

rishikim , për të parë nëse ka ende pyetje të paqarta dhe që shfaqin dykuptimësi dhe hapi i tretë ,është aplikimi i një studimi pilot me një grup prej 10 nxënësish.

Nga rezultatet e marra në këto tre hapa do të merren të dhëna për:

- Kohëzgjatjen e pyetësorit
- Qartësinë e pyetjeve (Nëse lënë vend për dykuptimësi ose pakuptimësi)
- Neologjizma(fjalë të reja)

Pas modifikimeve të bëra në këto tre hapa, u ndërtua versioni përfundimtar i cili u administrua në kampionin e përfshirë në studim.

Koha e shkurtër e administrimit të këtij instrumenti, mund të jetë një lehtësim për individët që i frikësohen një vlerësimi psikologjik të zgjatur në kohë.

Pyetësori i dytë : Pyetësori i Agresionit (Buss Perry Aggression Questionnaire)

Pyetësori i Agresivitetit(shtojca nr.2) është krijuar në vitin 1992 nga Buss Perry duke u bazuar në Buss-Durkee Hostility Inventory të vitit 1957. Ky pyetësor paqyron një tablo të plotë të faktorëve demografikë, psikologjikë, dhe kriminologjikë të riskut dhe e kategorizon agresivitetin në bazë të tipologjisë së tij.

Ky instrument vetëraportues përmban 29 pohime të cilat masin 4 kategori / shkallë të agresivitetit :

- Agresivitetin fizik – konsiston në shprehjen e zemërimit përmes forcës fizike, pra manifestimi i sjelljeve fizike, që dëmtojnë tjetrin ose veten në bazë të kontekstit. Pyetësori Buss Perry Aggression mat agresivitetin fizik përmes pohimeve:1,2,3,4,5,6,7,8,9.
- Agresivitetin verbal- konsiston në dëmtimin e tjetrit përmes verbalizimit, fjalës, sharjeve , ofendimeve, fyerjeve. Pyetësori Buss Perry Aggression mat agresivitetin verbal përmes pohimeve:10,11,12,13,14.
- Zemërimin- matet përmes pohimeve:15,16,17,18,19,20,21.
- Inatin/Armiqësi – matet përmes pohimeve:22,23,24,25,26,27,28,29.

AQ Manual (WPS Product No. W-371B) Pikëzimi dhe përcaktimi i nivelit të agresivitetit:

Për secilin pohim ka pese opsione të cilat kanë pikët e tyre shuma e të cilave përcakton nivelin e agresivitetit:

1)Ekstremisht jo karakteristikë e imja = 1 pikë

2) Në përgjithësi nuk është karakteristikë e imja =2 pikë

3) Nuk e di =3 pikë

4) Në përgjithësi është karakteristikë e imja=4 pikë

5)Ekstremisht karakteristikë e imja =5 pikë

Niveli i agresivitetit:

Shumë i ulët : <=29 pikë

- I ulët : 30-39 pikë
- Mesatarisht I ulët/ Nën mesatare: 40-44 pikë
- Mesatar: 45-55 pikë
- Mesatarisht I lartë/ Mbi mesatare : 56-59 pikë
- I lartë: 60-69 pikë
- Shumë I lartë: >=70 pikë

Pyetësi i agresivitetit i Buss Perry ,është përdorur gjërësisht në studimet klinike me target grupe adoleshentët .Është përkthyer në shumë gjuhë të botës si: Italisht, Spanjisht, Greqisht, Turqisht etj.Ndër studimet ku është përdorur ky instrument përmend: Kelly, J. & Egan, V. (2012). A case-control study of alcohol-related violent offending among Irish probation clients; Psychogiou, L., Daley, D., Thompson, M. & Sonuga-Barke, E. (2007). Testing the interactive effect of parent and child ADHD on parenting in mothers and fathers; Smith, P. & Waterman, M. (2006). Self-reported aggression and impulsivity in forensic and nonforensic populations: The role of gender and experience; Paul Smith, Mitch Waterman(2004) Role of experience in processing bias for aggressive words in forensic and non-forensic populations; Daryl B. O'Connor, John Archer, Frederick W.C. Wu (2001) Measuring aggression: Self-reports, partner reports, and responses to provoking scenarios etj.

Ky instrument u gjet online në gjuhën angleze në formën e sample. Ky instrument nuk është përdorur asnjëherë në gjuhën shqipe .

Ndaj në këtë studim shkencor së pari, është përkthyer në gjuhën shqipe ,nga ku u krye maksimalisht përshtatje konceptuale e tij. Në pyetjet që është hasur vështirësi për t'u kuptuar në shqip gjatë përkthimeve, është bërë përshtatja e tyre. Më pas, është zhvilluar një rishikim , për të parë nëse ka ende pyetje të paqarta dhe që shfaqin dykuptimësi dhe hapi i tretë është aplikimi i një studimi pilot, me një grup prej 10 nxënësish.

Nga rezultatet e marra në këto tre hapa do të merren të dhëna për:

- Kohëzgjatjen e pyetësorit
- Qartësinë e pyetjeve (Nëse lënë vend për dykuptimësi ose pakuptimësi)
- Neologjizma(fjalë të reja)

Pas modifikimeve të bëra në këto tre hapa ,u ndërtua versioni përfundimtar i cili u administrua në kampionin e përfshirë në studim.

Ky instrument administrohet për 10-15 minuta. Koha e shkurtër e administrimit të këtij instrumenti ,mund të jetë një lehtësim për individët që i frikësohen një vlerësimi psikologjik të zgjatur në kohë.

3.2.2 Besueshmëria e instrumentit

Në këtë rubrikë, do të trajtohen analizat, të cilat janë bërë me qëllim të matjes së besueshmërisë së shkallëve, të cilat janë përdorur në instrument. Në këtë aspekt, për matjen e besueshmërisë, është përdorur koeficienti i Alfës së Kronbahut, duke përfshirë të dy pyetësorët.

Më poshtë po paraqesim tabelën e besueshmërisë të këtij testi, dhe duke ditur që me një nivel 0.5 një pyetësor, fillon të quhet i besueshëm. Pyetësori i parë, Shkalla e mjedisit familjar (Family Environment Scale: Short Version Moos, R. H., & Moos, B. S), që vlerëson ndikimin e mjedisit familjar në manifestimin e sjelljes agresive te adoleshentët ka dalë Cronbach Alpha me një vlerë 0.67, çfarë tregon besueshmëri të moderuar:

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	N of Items
.673	27

Tab.5. Shkalla e mjedisit familjar (Family Environment Scale: Short Version, Moos, R. H., & Moos, B. S)

Pyetësi i dytë që mat agresitetin, Pyetësi i Agresionit (Buss Perry Aggression Questionnaire), si faktor që ndikon në manifestimin e sjelljes agresive të adoleshentëve ka dalë me një vlerë 0.71, çfarë tregon besueshmëri të moderuar:

Reliability Statistics

Cronbach's Alpha	N of Items
.711	29

Tab.6 Pyetësi i Agresionit (Buss Perry Aggression Questionnaire)

Pranimi i rezultateve të studimit bëhet nëse plotësohen dy kritere bazë: besueshmëria dhe vlefshmëria.

Besueshmëria: Ky kriter ka të bëjë me mosndryshimin e rezultateve të matjeve të përsëritura, kur ato bëhen ndaj të njëjtave njësi, në të njëjtat rrethana, pavarësisht se kush i kryen këto matje. Pra, një matje është e besueshme ,kur përsëritja e saj ndaj të njëjtave njësi dhe në të njëjtat rrethana sjell të njëjtën klasifikim të njësive, sipas kategorive të variablave. Përndryshe, ajo quhet e pabesueshme.


3.3 Dizajni i hulumtimit

Ky dizajn i hulumtimit, është mjaft i pranishëm në hulumtimet që bëhen në fushën e edukimit. (Gav, Mills & Airasian 2006). Ky studim është bazuar në modelin Bioelogjik të Bronfenbrenner (Bronfenbrenner & Morris, 2006). Sipas modelit Bioekologji, zhvillimi njerëzor ndikohet nga faktorë social dhe ekologjik. Ky hulumtim është kryer sipas qasjes së hulumtimeve descriptive. Fig.2 Në këtë hulumtim janë vlerësuar 600 nxënës të grupmoshës

12-15 vjeç, banues në zona industriale dhe joinindustriale të qarkut të Elbasanit. Qëllimi i studimit është të krahasojë nivelin e agresivitetit tek adoleshentët ,banues në zona industriale ,kundrejt atyre banues në zona joinindustriale.

Zhvillimi njerëzor ndikohet nga faktorë social, familjar dhe ekologjik (Bronfenbrenner and Morris, 2006)

Fig. 2 Modeli i hulumtimit



3.4 Procedura për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore të studimit

Të dhënat sasiore për këtë studim, janë mbledhur në muajin tetor 2015 - maj 2016.

Theksoj sërish, se përpara realizimit të studimit ,fillimisht është marrë leje nga Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan, ku i është shpjeguar parimisht në vija të përgjithshme qëllimi i realizimit të këtij studimi ,për të proceduar më pas me përzgjedhjen e kampionit dhe aplikimin e instrumentave. DAR Elbasan, na ka mundësuar informacionin e nevojshëm në lidhje me nxënësit që frekuentonin shkollat 9 vjeçare publike dhe që banonin në zonat industriale Bradashesh, Vidhas, Letan dhe Katund të Ri ,si dhe për nxënësit që frekuentonin shkollat 9 vjeçare publike dhe që banonin në zonat Labinot Fushë, Labinot Mal, Sericë, Shpat, Xibrakë, zona këto të cilat dallohen për një klimë të pastër e të shëndetshme ,larg ndotjes industriale. Pas krijimit të një database me të dhënat e përfuara, u përzgjodhën në mënyrë të qëllimshme 600 nxënës të grupmoshës 12-15 vjec, që frekuentonin 10 shkolla publike 9 vjeçare: Shkolla 9 vjeçare “A.Lleshanaku”; Shkolla 9 vjeçare “Europa” në Katund të Ri; Shkolla 9 vjeçare “Jorgji Dilo”; Shkolla 9 vjeçare “Kozan”; Shkolla 9 vjeçare “Petresh” ,shkolla këto në zona industriale dhe Shkolla 9 vjecare në Labinot Fushë; Shkolla 9 vjecare në Labinot Mal, Shkolla 9 vjecare në Shpat, Shkolla 9 vjecare në Xibrakë dhe Shkolla 9

vjecare në Sericë shkolla këto në zona larg ndotjes industriale . Më pas, u kontaktua me drejtuesit e institucioneve të përzgjedhura dhe u realizua një takim informues me nxënësit e përzgjedhur në cdo shkollë. Nxënësit e grupmoshës 12-15 vjeç për secilin grup ata që banonin në zona industriale dhe ata që banonin larg këtyre zonave .Fillimisht u informuan për studimin dhe pasi pranuan pjesëmarrjen në parim, u informuan në mënyrë të detajuar në lidhje me qëllimin, kushtet dhe metodën e studimit që do të përdorej si dhe ku konsistonte ndihma e tyre. Pjesëmarrësve që në fillim i është bërë i qartë natyra vullnetare e pjesëmarrjes në studim dhe se mund të tërhiqeshin nga studimi ,nëse nuk kishin dëshirë të merrnin pjesë në të, pa administruar ende instrumentat me ta. Nuk kishte asnjë rast që nuk pranonte të ishte pjesë e studimit. Në këtë studim u përdorën instrumentat: : 1) Shkalla e mjedisit familjar (Family environment scale, Moos, R. H., & Moos, B. S) instrument I cili mat ndikimin e familjas në agresivitetin e adoleshentëve duke na paraqitur një tablo përshkruese të mjedist të tyre familjar, klimën në familje , ndëshkimit nga prindërit, dinamikave familjare etj.

2) Pyetësi i Agresionit (Buss Perry Aggression Questionnaire) i përdorur në këtë studim për të matur nivelin e agresivitetit tek adoleshentët.

Pilotimi: Instrumentet që janë përdorur ,për të marrë të dhënat e nevojshme për testimin e hipotezave të ngritura për këtë studim dhe pyetjeve kërkimore , janë pilotur fillimisht përpara aplikimit të tyre në fazën përfundimtare. U përzgjedhën 10 nxënës, me të cilët u aplikuan të dy instrumentet, pas përkthimit nga gjuha angleze në atë shqipe. Pilotimi u realizua për këto arsye:

- Për të testuar kuptueshmërinë e termave dhe logjikën e fjalive të pyetësorëve të përkthyer nga anglishtja
- Për të matur kohën ,që duhet për të administruar këto pyetësorë

Pas pilotimit, u rishikua mënyra e të shprehurit në shqip të disa prej pohimeve tek instrumentet , duke u bazuar në pyetjet që bënë nxënësit për kuptimin e tyre gjatë plotësimit,rishikime të cilat u morën në konsideratë për aplikimin e instrumentave në fazën përfundimtare.

Nga pjesëmarrësit u kërkua, që për pyetjet e instrumenteve ,të jepnin përgjigje sa më të vërteta. Duhet të theksohet ,se gjatë procesit të plotësimit të instrumentit nga ana e pjesëmarrësve, nuk pati ndonjë shqetësim apo ngacmues të jashtëm ,që mund të ndikonin në këtë proces. Gjithashtu, plotësimi i instrumentit nga ana e pjesëmarrësve u krye në mënyrë të pavarur , ku secili pjesëmarrës plotësoi në mënyrë individuale instrumentat.

Pas përfundimit të fazes së aplikimit të pyetësorëve ,me gjithë kampionin e përzgjedhur , u falenderuan pjesëmarrësit për kontributin e tyre .

- Të dhënat, përsa i përket variablit natyror -ndotje industrial, i përftuam pasi kontaktuam me Agjensinë e Mbrojtjes së Mjedisit, strukturë institucionale përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin e objekteve industriale në Shqipëri. Agjensia e Mbrojtjes së Mjedisit, më konkretisht sektori SAI -Subjektet e Aktiviteteve Industriale na mundësuan statistkat descriptive të ndotjes industriale në qarkun e Elbasanit në zonat e përzgjedhura në këtë studim përgjatë vitit 2014-2015 ku ishin monitoruar dhe vlerësuar objektet industriale: duke filluar qe nga Kurum International ,i cili disponon Fabrike Gelqereje, Uzina e Çelikut, Linja e Skrapit dhe Uzina e Petezimit, nwnwtw leje mjedisi, per kompanine "Limak Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi Age Insaat Ve Ticaret Anonim Sirketi Adi Ortakligi" ,Dege e Shoqerise se Huaj, funksionim hidrocentrali grumbullim skrapi grumbullim i mbetjeve. Agjensia e Mbrojtjes së Mjedisit, na mundësoi raportin e vlerësimit të vitit 2014-2015, pasi raporti i vlerësimit për vitin 2015-2016 ,nuk kishte mbaruar ende, pasi kishte ende objekte që po vlerësoheshin.

Fig.3 Ndotja industriale në qarkun Elbasan në vitin 2014,2015





Fig.4 Rezultatet statistikore totale, për nivelin e ndotjes, në zonat industrial, kundrejt atyre jo industriale në studim, sipas AKM (Agjensia Kombëtare e Mjedisit)



Pas vlerësimit nga Agjensia Kombëtare e Mjedisit , për vitin 2015 për zonat industriale Bradashesh , Letan, Vidhas dhe Katund I Ri ,rezulton se niveli I ndotjes arrin në 35 % në Bradashesh ; 15 % në Letan; 15 % në Vidhas dhe 25 % në Katund të Ri .

Përsa I përket ndotjes industrial, në zonat Labinot Fushë, Labinot Mal, Sericë, Shpat dhe Xibrakë niveli i ndotjes është 2 % për secilën zonë, nivel statistikisht jo i rëndësishëm, ndaj dhe këto zona shquhen për klimë të pastër e të shëndetshme dhe shpeshherë frekuentohen për turizëm.

3.5 Metodatat e analizës së të dhënave statistikore

Duke qenë se struktura e studimit është sasiore, për kryerjen e analizave janë përdorur metodatat statistikore. Fillimisht pas mbledhjes së të dhënave, është realizuar kodimi i tyre dhe më pas është ndërtuar baza e të dhënave, e krijuar në një nga faqet e programit SPSS, versioni 20. Ashtu siç u tha më sipër, fillimisht u analizua besueshmëria e pyetësorëve përmes koeficientit të alfës së Kronbahut. Më pas, u testua normaliteti dhe homogjeniteti i shpërndarjes së të dhënave. Gjithashtu, është kryer analizimi i variablilit Mjedis Familjar dhe Agresivitet, përmes statistikave descriptive, mbi të dhënat e pëftuara nga aplikimi i pyetësorëve në kampionin e përzgjedhur për këtë studim.

Të dhënat statistikore, përsa i përket ndotjes industrial, u siguruan të dhëna pas kontaktimit me Agjensinë e Mbrojtjes së Mjedisit, strukturë institucionale përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin e objekteve industriale në Shqipëri. Agjensia e Mbrojtjes së Mjedisit, më konkretisht sektori SAI -Subjektet e Aktiviteteve Industriale , na mundësuan statistikat descriptive të ndotjes industrial në qarkun e Elbasanit, përgjatë vitit 2014-2015, ku ishin

monitoruar dhe vlerësuar objektet industriale: duke filluar qe nga Kurum International, i cili ka Fabrike Gelqereje, Uzina e Çelikut, Linja e Skrapit dhe Uzina e Petezimit, nëntë leje mjedisi per kompanine "Limak Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi Age Insaat Ve Ticaret Anonim Sirketi Adi Ortakligi" Dege e Shoqerise se Huaj, funksionim hidrocentrali grumbullim skrap grumbullim i mbetjeve. Agjensia e Mbrojtjes së Mjedisit na mundësoi raportin e vlerësimit të vitit 2014-2015 pasi raporti i vlerësimit për vitin 2015-2016 nuk kishte mbaruar ende pasi kishte ende objekte që po vlerësoheshin.

Për të evidentuar marrëdhënien që ekziston ndërmjet faktorëve të Mikrosistemit(mjedis familjar) dhe Ekosistemit (ndotje industriale) në manifestimin e sjelljeve agresive tek adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec. Për të qartësuar këtë marrëdhënie u përdor analiza e korrelacionit Pearson r.


KAPITULLI IV: REZULTATET

Në këtë kapitull bëhet shqyrtimi i vërtetësisë së hipotezës së ngritur, sipas pyetjeve kërkimore.

Hipotezat e studimit : Manifestimi i sjelljeve agresive, te adoleshentët e moshës 12-15 vjeç ,që jetojnë në e zonën industriale , përfshire këtu edhe faktorin familjar, është me i larte, ne krahasim me adoleshentet , që jetojnë në zona joindustriale në prefekturën e Elbasanit.

4.1 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit fizik te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona industriale në Elbasan .


Grafiku 1. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për agresivitetin fizik në zona industriale .



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 39 adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 13 % të kampionit të studimit, shfaqin agresivitet fizik në nivel shume të ulët.
- 140 adoleshente, banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 46.6% të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet fizik në nivel të ulët
- 90 adoleshente banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 30 % të kampionit nw studim , shfaqin agresivitet fizik në nivel mesatar .
- 31 adoleshentë, banues në zona industriale ,që përbëjnë 10.4 % të kampionit , shfaqin agresivitet në nivel të lartë.

Grafiku 1.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për agresivitetin fizik në zona industriale e specifikuar ne gjini.



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 120 vajza adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 40 % të kampionit të studimit, shfaqin agresivitet fizik në nivel të ulët.
- 29 vajza adoleshente, banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 9.66 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet fizik në nivel shumë të ulët
- 10 vajza adoleshente banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 3.33 % të kampionit nw studim , shfaqin agresivitet fizik në nivel mesatar .
- 31 adoleshentë, të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale ,që përbëjnë 10.33 % të kampionit , shfaqin agresivitet në nivel të lartë.
- 80 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale që përbëjnë 26.66 % të kampionit ,shfaqin agresivitet në nivel mesatar .


20 adoleshentë të gjinisë mashkullore, të cilët janë banues në zona industriale, që përbëjnë 6.66 % të kampionit të marrë në studim, shfaqin agresivitet në nivel të ulët.

10 adoleshentë të gjinisë mashkullore ,banues në zona industriale, që përbëjnë 3.33 % të kampionit të marrë në studim, shfaqin agresivitet në nivel shumë të ulët .

Nga analiza e mësipërme statistikore , rezulton se adoleshentët e gjinisë mashkullore banues në zona industriale ,janë më të predispozuar për të manifestuar sjellje agresive ,në një nivel më të lartë në krahasim më gjininë femërore .

4.1.1 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit verbal te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona industriale në Elbasan .


Grafiku 2. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin Verbal në zona industriale .



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 25 adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 8.33 % të kampionit të studimit, shfaqin agresivitet verbal në nivel shume të ulët.
- 60 adoleshente, banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 20% të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet verbal në nivel të ulët
- 119 adoleshente banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 39.7 % të kampionit nw studim , shfaqin agresivitet verbal në nivel mesatar .
- 96 adoleshentë, banues në zona industriale ,që përbëjnë 32 % të kampionit , shfaqin agresivitet verbal në nivel të lartë.

Grafiku 2.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin Verbal në zona industriale I specifikuar ne gjini .




Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 50 vajza adoleshente banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 16.66 % të kampionit të marrë në studim, shfaqin agresivitet verbal në nivel të ulët .
- 25 vajza adoleshente banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 8.33 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet verbal në nivel shumë të ulët .
- 69 vajza adoleshente ,banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 23 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet verbal në nivel mesatar .
- 15 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale që përbëjnë 5% të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet verbal në nivel të lartë .
- 50 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale ,që përbëjnë 16.66 % të kampionit tonë, shfaqin agresivitet verbal në nivel mesatar .
- 10 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale që përbëjnë 3.33% të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet verbal në nivel të ulët .
- 81 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale që përbëjnë 27 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet verbal në nivel të lartë .
-

Nga analizat e mësipërme e rezultateve statistikore të kampionit të studimit rezulton ,se adoleshentët e gjinisë mashkullore banues në zona industriale, shfaqen më tepër agresivë verbalisht ,në krahasim me gjininë femërore.


4.1.2 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e zemërimit të adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona industriale në Elbasan .Grafiku 3. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Zemërimin në zona industriale .



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 11 adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 3.6 % të kampionit të studimit, shfaqin zemerim në nivel shume të ulët.
- 38 adoleshente, banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 12.6 % të kampionit tonë ,shfaqin zemerim në nivel të ulët
- 181 adoleshente banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 60.4 % të kampionit nw studim , shfaqin zemerim në nivel mesatar .
- 70 adoleshentë, banues në zona industriale ,që përbëjnë 23.4 % të kampionit , shfaqin zemerim në nivel të lartë.

Grafiku 3.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Zemërimin në zona industriale e specifikuar ne gjini .




Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 18 vajza adoleshente banuese në zona industriale, që përbëjnë dhe 6 % të kampionit tonë shfaqin zemërim në nivel të ulët .
- 11 vajza adoleshente banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 3.66 % të kampionit tonë ,shfaqin zemërim në nivel shumë të ulët .
- 90 vajza adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 30 % të kampionit tonë, shfaqin zemërim në nivel mesatar .
- 40 vajza adoleshente, banuese në zona industriale që përbëjnë 13.33 % të kampionit tonë , shfaqin zemërim në nivel të lartë .
- 30 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale që përbëjnë 10 % të kampionit tonë ,shfaqin zemërim në nivel të lartë.
- 91 adoleshentë të gjinisë mashkullore ,banues në zona industriale ,që përbëjnë 30.33 % të kampionit tonë, shfaqin zemërim në nivel mesatar .
- 20 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale ,që përbëjnë 6.66 % të kampionit tonë ,shfaqin zemërim në nivel të ulët .


4.1.3 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e inatit, armiqësisë të adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjeç banues në zona industriale në Elbasan .

Grafiku 4. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Inatin /Armiqësinë në zona industriale .



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 10 adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 3.33% të kampionit të studimit, shfaqin inat në nivel shume të ulët.
- 30 adoleshente, banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 10 % të kampionit tonë ,shfaqin inat në nivel të ulët
- 180 adoleshente banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 60 % të kampionit nw studim , shfaqin inat në nivel mesatar .
- 80 adoleshentë, banues në zona industriale ,që përbëjnë 26.7 % të kampionit , shfaqin inat në nivel të lartë.
- **Grafiku 4.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Inatin /Armiqësinë në zona industriale e specifikuar ne gjini .**




Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 18 vajza adoleshente, banuese në zona industriale, që përbëjnë dhe 6 % të kampionit tonë, shfaqin armiqtësi në nivel të ulët .
- 11 vajza adoleshente adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 3.66 % të kampionit tonë ,shfaqin armiqtësi në nivel shumë të ulët .
- 90 vajza adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 30 % të kampionit tonë, shfaqin armiqtësi në nivel mesatar .
- 40 vajza adoleshente, banuese në zona industriale, që përbëjnë 13.33 % të kampionit tonë, shfaqin armiqtësi në nivel të lartë .
- 30 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale që përbëjnë 10 % të kampionit tonë, shfaqin armiqtësi në nivel të lartë .
- 91 adoleshentë të gjinisë mashkullore banues në zona industriale që përbëjnë 30.33 % të kampionit tonë shfaqin armiqtësi në nivel mesatar .
- 20 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona industriale ,që përbëjnë 6.66 % të kampionit tonë ,shfaqin armiqtësi në nivel të ulët .

4.2 Rezultatet statistikore totale mbi nivelin e agresivitetit tek adoleshentët banues në zona industriale.


Grafiku 5. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nivelin e agresivitetit në zona industriale.



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 17 adoleshente, banuese në zona industriale ,që përbëjnë dhe 5.6 % të kampionit të studimit, shfaqin agresivitet në nivel shume të ulët.
- 64 adoleshente, banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 21.4 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet në nivel të ulët
- 150 adoleshente banuese në zona industriale që përbëjnë dhe 50 % të kampionit nw studim , shfaqin agresivitet në nivel mesatar .
- 169 adoleshentë, banues në zona industriale ,që përbëjnë 56.4 % të kampionit , shfaqin agresivitet në nivel të lartë.

Grafiku 5.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për nivelin e agresivitetit në zona industriale e specifikuar ne gjini.



Nga grafiku i mësipërm, ku janë pasqyruar rezultatet statistikore , të dhënat flasin qartë ,për një shfaqje të agresivitetit në nivel mesatar dhe më të lartë tek adoleshentët e gjinisë mashkullore, banues në zona industriale, në krahasim me ata të gjinisë femërore, në të njëjtin target grup.

Më konkretisht:

7 meshkuj ,që përbëjnë 2.33 % të kampionit tonë dhe 10 femra, që përbëjnë 3.33 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet ,në nivel shumë të ulët


14 meshkuj ,që përbëjnë 4.66 % të kampionit tonë dhe 50 femra, që përbëjnë 16.66% të kampionit tonë, shfaqin agresivitet në nivel të ulët .

80 meshkuj ,që përbëjnë 26.66 % të kampionit tonë dhe 70 femra ,që përbëjnë 23.33 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet në nivel mesatar.

40 meshkuj, që përbëjnë 13.33 % të kampionit tonë dhe 29 femra, që përbëjnë 9.66 % të kampionit tonë, shfaqin agresivitet në nivel të lartë.

4.3 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit fizik te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona jo industriale në Elbasan .


Grafiku 6. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin fizik në zona joindustriale .



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 100 adoleshente, banuese në zona joindustriale ,që përbëjnë dhe 33.3 % të kampionit të studimit, shfaqin agresivitet fizik në nivel shume të ulët.
- 90 adoleshente, banuese në zona joindustriale që përbëjnë dhe 30 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet fizik në nivel të ulët
- 101 adoleshente banuese në zona joindustriale që përbëjnë dhe 33.6 % të kampionit nw studim , shfaqin agresivitet fizik në nivel mesatar .
- 9 adoleshentë, banues në zona joindustriale ,që përbëjnë 3 % të kampionit , shfaqin agresivitet fizik në nivel të lartë.

Grafiku 6.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin fizik në zona joindustriale e specifikuar ne gjini .



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

87 vajza adoleshente, banuese në zona joindustriale ,që përbëjnë dhe 29 % të kampionit tonë, shfaqin agresivitet fizik në nivel shumë të ulët .

50 vajza adoleshente, banuese në zona joindustriale, që përbëjnë dhe 16.66% të kampionit tonë, shfaqin agresivitet fizik në nivel të ulët .

30 vajza adoleshente, banuese në zona joindustriale ,që përbëjnë dhe 10 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet fizik në nivel mesatar .

23 adoleshentë të gjinisë mashkullore, që përbëjnë 7.66 % të kampionit tonë, shfaqin agresivitet në nivel shumë të ulët .


40 adoleshentë të gjinisë mashkullore ,që përbëjnë 13.33 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet në nivel të ulët .

60 adoleshentë të gjinisë mashkullore, që përbëjnë 20 % të kampionit tonë, shfaqin agresivitet në nivel mesatar .

10 adoleshentë të gjinisë mashkullore ,që përbëjnë 3.33 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet në nivel të lartë .

4.3.1 Rezultatet statistikore totale në lidhje me nivelin e agresivitetit verbal te adoleshentët e grupmoshës 12-15 vjec banues në zona jo industriale në Elbasan .


Grafiku 7. Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin verbal në zona joindustriale .



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

- 38 adoleshente, banuese në zona joindustriale ,që përbëjnë dhe 12.6% të kampionit të studimit, shfaqin agresivitet verbal në nivel shume të ulët.
- 97 adoleshente, banuese në zona joindustriale që përbëjnë dhe 32.3 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet verbal në nivel të ulët
- 112 adoleshente banuese në zona joindustriale që përbëjnë dhe 37.3 % të kampionit ne studim , shfaqin agresivitet verbal në nivel mesatar .
- 43 adoleshentë, banues në zona joindustriale ,që përbëjnë 14.3 % të kampionit , shfaqin agresivitet verbal në nivel të lartë.

Grafiku 7.1 Rezultatet statistikore totale të kampionit të studimit për Agresivitetin verbal në zona joindustriale I specifikuar ne gjini.



Nga analiza e rezultateve statistikore të grafikut të mësipërm rezulton :

35 vajza adoleshente, banuese në zona joindustriale, që përbëjnë dhe 11.66 % të kampionit tonë, shfaqin agresivitet verbal në nivel shumë të ulët .

82 vajza adoleshente, banuese në zona joindustriale, që përbëjnë dhe 27.33 % të kampionit tonë ,shfaqin agresivitet verbal në nivel të ulët .

37 vajza adoleshente banuese në zona joindustriale që përbëjnë dhe 12.33 % të kampionit tonë shfaqin agresivitet verbal në nivel mesatar .

13 vajza adoleshente, banuese në zona joindustriale ,që përbëjnë dhe 4.33 % të kampionit tonë, shfaqin agresivitet verbal në nivel të lartë .


3 adoleshentë të gjinisë mashkullore, banues në zona joindustriale, që përbëjnë 1 % të kampionit tonë, shfaqin agresivitet verbal, në nivel shumë të ulët .

